



Udhëzuesi për ndjekjen e procesit të negociatave për aderim në BE



Mbështetur nga ana e Bashkimit Evropian në
kuadër të programit „Evropa për qytetarët”

Udhëzuesi për ndjekjen e procesit të negociatave për aderim në BE



IMPRESSUM

BOTUES:

Shkolla e Hapur e Beogradit
rr. Masarikova 5/16, 11000 Beograd
Telefon: +381 11 3061 372
Fax: +381 11 36 13 112
Ueb: www.bos.rs

NË EMËR TË BOTUESIT:

Vesna Gjukiq

REDAKTORE:

Danijella Bozhoviq

AUTORË:

Danijella Bozhoviq, Jellena Babiq, Mirko Popoviq, Vlladimir M. Pavlloviq

RECENSUES:

Millica Saraçeviq, Katarina Golluboviq

KORREKTORE:

Ivana Andriq

PËRKTHIM NË GJUHËN SHQIPE:

Sandra Nedimoviq

Udhëzuesi për ndjekjen e procesit të negociatave për aderim në BE



Mbështetur nga ana e Bashkimit Evropian në kuadër të programit „Evropa për qytetarët“

Mbështetja e Komisionit Evropian për përpilimin e këtij publikimi nuk përfaqëson pranimin e përmbajtjes e cila reflekton pikëpamjet e vetë autorëve, dhe Komisioni nuk mund të jetë përgjegjës për çfarëdo lloj përdorimi që mund të bëhet nga informacionet e përmbajtura këtu.

Beograd, 2015

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE	6
---------------------	---

PARATHËNIE	8
------------	---

I HYRJE – PROCESI I INTEGRIMEVE EVROPIANE

1.1. Procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA)	13
1.2. Negociatat për aderim në Bashkimin Evropian	15

II PROCESI I NEGOCIATAVE PËR ADERIM NË BASHKIMIN EVROPIAN

2.1. Fazat në procesin e negociatave për aderim	20
2.1.1. Shqyrtimi analitik i legjislacionit (skrining)	20
2.1.2. Faza përmbajtëse e negociatave	22
2.1.3. Lidhja e marrëveshjes për aderim	23
2.2. Aktorët në procesin e negociatave për aderim	24
2.2.1. Struktura negociuese e Bashkimit Evropian	25
2.2.2. Struktura negociuese e shtetit kandidat për anëtarësim	26

III SHQYRTIMI DHE ANALIZA E STRUKTURËS SË DOKUMENTEVE TË CILAT SHFAQEN NË PROCESIN E NEGOCIATAVE

3.1. Skrining	30
3.1.1. Raporti për skrining	31
3.1.2. Rezultati i skrining-ut	33
3.1.3. Plani i veprimit	34
3.1.4. Raporti për realizimin e planit të veprimit	36
3.2. Faza përmbajtëse e negociatave	36
3.2.1. Pozita negociuese e shtetit kandidat	39
3.2.2. Pozita e përbashkët e Bashkimit Evropian	41
3.2.3. Raporti për plotësimin e detyrimeve për kapitullin negociues	42

IV NDJEKJA E NEGOCIATAVE ADERUESE ME BASHKIMIN EVROPIAN

4.1. Matrica për ndjekjen e negociatave për aderim në Bashkimin Evropian	44
--	----

V TRANSPARENCA DHE QASJA NË DOKUMENTE NË PROCESIN

E NEGOCIATAVE PËR ADERIM NË BE

5.1. E drejta për qasje në dokumente në posedimin e organeve të Bashkimit Evropian	63
5.1.1. E drejta e publikut për qasje në dokumentet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit – Rregullorja 1049/2001	65
5.1.1.1. Kufizimet e qasjes në dokumente	68
5.1.1.2. Si paraqitet dhe procedohet kërkesa për qasje në dokumentet e BE	69
5.1.1.3. Trajtimi i dokumenteve konfidenciale	70

SHTOJCA 1.

Zhvillimi i negociatave – Pesë skenarë të mundshëm	72
--	----

SHTOJCA 2.

Shqyrtimi i dokumenteve të BE-së dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor të rëndësishëm për ndjekjen e procesit të integrimeve evropiane	75
---	----

LITERATURA	84
-------------------	-----------

LISTA E SHKURTIMEVE

CEFTA – Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë

(ang. The Central European Free Trade Agreement)

COELA – Trupi punues i Këshillit të BE-së për zgjerim dhe shtete të cilat udhëheqin negociatat për aderim

(ang. Working Party on Enlargement and Countries Negotiating Accession to the EU)

COREPER – Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm (fr.: Comité des représentants permanents)

CEEA – Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit

KE – Komisioni Evropian

PE – Parlamenti Evropian

BE – Bashkimi Evropian

KE – Komuniteti Evropian

KNQ – Konferenca Ndërqeveritare

NPAA – Programi kombëtar për miratimin e trashëgimisë juridike të Bashkimit Evropian

NPI – Programi kombëtar i integritimit të Republikës së Serbisë në BE-në për periudhën 2008–2012

OBAR – Raporti për vlerësimin e plotësimit të kritereve për hapjen e negociatave (ang. Opening Benchmark Assessment Report)

OSHC – Organizata e shoqërisë civile

PSA – Procesi i Stabilizim-Asociimit

MPT – Marrëveshja e Përkohshme Tregtare

RS – Republika e Serbisë

Këshilli – Këshilli i Bashkimit Evropian

MSA – Marrëveshja për Stabilizim-Asociim

MBE – Marrëveshja për Bashkimin Evropian

MFBE – Marrëveshja për funksionimin e Bashkimit Evropian

PARATHËNIE

Shtetet e Ballkanit Perëndimor janë përcaktuar, por edhe bindur fortë se e ardhmja e tyre është në Bashkimin Evropian (BE), çfarë është konfirmuar njëzëri disa herë në samitet e liderëve të BE-së dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor, që nga viti 2003 deri sot. Megjithatë, Ballkani Perëndimor, edhe pranë përparimit të rëndësishëm i cili është realizuar me zbatimin e reformave ekonomike dhe politike, është duke u ballafaquar me sfida të mëdha në lidhje me sundimin e ligjit, reformën e administratës publike dhe të gjyqësisë, luftën kundër korrupsionit dhe kriminalit të organizuar dhe qëndrueshmërinë e modelit ekonomik të zhvillimit. Kjo ndikon mbi plotësimin e kushteve të BE-së, çfarë e përcakton ritmin e integritimeve evropiane të shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Të tërë procesin e integritimeve evropiane të shteteve të Ballkanit Perëndimor duhet vështruar përmes të tërë procesit të evropianizimit të shoqërisë, i cili nënkupton vendosjen dhe zbatimin e reformave gjithëpërfshirëse dhe pranimin e standardeve dhe vlerave evropiane të cilat janë duke i kontribuar përmirësimit të cilësisë së jetës së të gjithë qytetarëve. Për atë arsye është jashtëzakonisht e rëndësishme që procesi i integritimeve evropiane t'u afrohet qytetarëve, me qëllim që të gjithë se bashku të marrin pjesë në të, t'i kontribuojnë dhe më tej ta përparojnë duke e mbajtur në atë mënyrë në pronësinë e qytetarëve dhe jo të elitave politike.

Njëri nga hapat më të rëndësishëm në rrugën e çdo shteti kandidat për anëtarësim në BE-në janë negociata për aderim, të cilat nënkuptojnë ndërmarrjen e hapave të qartë kah plotësimi i të gjitha detyrimeve të cilat dalin nga trashëgimia juridike e BE-së, dhe të cilat kanë të bëjnë me vëllimin e gjerë të reformave në të gjitha politikat dhe fushat publike që janë nga rëndësia për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të shteteve candidate për anëtarësim në BE-në.

Ekipi i Shkollës së Hapur të Beogradit, se bashku me një grup të ekspertëve, e përpiloi këtë udhëzues, në të cilin u prezantuan informacionet më të rëndësishme për procesin e negociatave për aderim në BE-në, çfarë është hapi i parë i nevojshëm në kuptimin e të tërë procesit. Udhëzuesi është krijuar në kuadër të iniciativës „Fillo të flasësh për negociata“ të cilën në vitin 2013 e lëvizi Shkolla e Hapur të Beogradit me mbështetjen e Fondacionit për Shoqërinë e Hapur të Serbisë.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është që përfaqësuesve të shoqërisë civile nga shtetet e Ballkanit Perëndimor t’ua ofron dijeni dhe informacione të cilat do t’u mundësojnë që në mënyrë adekuate të ndjekin procesin e negociatave për aderim në BE-në dhe të njohin në të cilën mënyrë mund ta bëjnë këtë proces në pronësinë e qytetarëve. Heterogjeniteti, interesimet e ndryshme, fushat e ndryshme të veprimit dhe instrumentet e komunikimit janë veçori të shoqërisë civile. Roli i shoqërisë civile në demokraci moderne është që proceset e vendimmarrjes t’ua afrojnë qytetarëve dhe të mundësojë që interesat e grupeve të veçanta shoqërore dhe të komuniteteve lokale të përfaqësohen dhe mbrohen në mënyrë të kënaqshme para vendimmarrësve. Roli i shoqërisë civile është që përmes ndjekjes së procesit të integriteteve të BE-së të ndikojë mbi zmadhimin e përgjegjësisë dhe transparencës së punës së organeve të autoriteteve publike dhe në atë mënyrë t’i kontribuojë zbatimit të reformave demokratike. Me këtë udhëzues përforcojmë kapacitetin e organizatave të shoqërisë civile me qëllim që të jenë përfaqësues e vërtetë të interesave të qytetarëve, anëtarëve dhe komuniteteve të tyre nga të cilat vijnë. Vetëm administrata transparente mund t’u mundësojë të gjithë aktorëve të interesuar në shoqëri të jenë pjesëmarrës në procesin e evropianizimit. Nga ana tjetër, ajo çfarë sot mbulon termin „qeverisje e mirë“ (good governance) është e paimagjinueshme nëse proceset e vendimmarrjes nuk janë bazuar mbi qasjen e lirë në informacione përkatëse dhe pjesëmarrjen qytetare.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile duhet të njohin mirë aspektet e procesit të negociatave me BE-në, por edhe instrumentet e komunikimit që të jenë në gjendje ta bëjnë procesin e negociatave transparent. Prandaj në fillim të udhëzuesit mund të gjeten informacionet për vet zhvillimin e procesit të negociatave për aderim në BE-në, me përshkrim të detajuar të çdo hapi, të aktorëve kyçë dhe të institucioneve. Pranë asaj janë përfaqësuar edhe dokumentet e analizuara të cilat vijnë nga procesi i negociatave në çdo prej fazave të saj të posaçme. Teksti i cili i takon ndjekjes së negociatave për aderim në BE-në hap një kapitull të ri, i cili ka të bëjë me vetë skemën e monitorimit, d.m.th. me atë sesi shoqëria civile dhe anët e tjera të interesuara mund t’i ndjekin në mënyrë konkrete negociatat e aderimit dhe t’ia japin procesit kontributin e vet varësisht nga faza e negociatave. Pjesa e fundit të udhëzuesit ka të bëjë me transparencën e procesit të negociatave për anëtarësim në BE-në, me theks të veçantë mbi kuadrin ligjor për qasje në dokumente që rezultojnë nga puna e organeve të BE-së. Krejt në fund prezantohen shqyrtimi i dokumenteve të rëndësishme për ndjekjen e procesit të integriteteve evropiane dhe i skenarëve të mundshme të rrjedhjes së negociatave.

Autorët ishin duke u përpjekur që lexuesve në mënyrë sa më praktike dhe të thjeshtë ta përfaqësojnë procesin e negociatave për aderim në BE-në dhe të tërheqin vëmendje për aspektet më të rëndësishme të këtij procesi. Shpresojmë se ky udhëzues do të jetë i dobishëm në punë dhe do t’i kontribuojë krijimit të procesit transparent dhe përgjegjës në udhëheqjen e negociatave për aderim në BE-në të shteteve të Ballkanit Perëndimor, të themeluar mbi dialogun dhe bashkëpunimin e partneritetit të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike.



**HYRJE –
PROCESI I
INTEGRIMEVE
EVROPIANE**



Rruga e një shteti nga besnikëria e theksuar e shoqërisë së saj vlerave evropiane deri tek anëtarësimi formal në Bashkimin Evropian (BE) përfaqëson një proces të ndërlikuar juridiko-politik. Ky proces më shpesh ndahet në dy faza të njëpasnjëshme dhe të kushtëzuar në mënyrë reciproke: asociim dhe aderim. Çdo prej këtyre fazave përbëhet nga seria e nënfazave ku kalimi në fazën tjetër varet nga plotësimi i kriterëve dhe setet e hapave në çdo prej pjesëve të procesit të cilat ia afrojnë shtetin anëtarësimin në BE-në.

Publiku i interesuar duhet të jetë i njohur me hapa në këtë proces me qëllim që në mënyrë efektive t'i drejtojë veprimet e vet. Në çdo moment, qoftë se jemi pjesëmarrësit ose vëzhguesit e procesit, duhet të përcaktojmë në cilin hap jemi. Prandaj këtë udhëzues e fillojmë me skemën e hapave në proces, sepse shpesh i referohemi kur fillojmë çdo veprim të ri si rezultat i dëshirës për pjesëmarrje në proces.

HAPAT KAH ANËTARËSIMI NË BE-NË

(I) ASOCIIMI nënkupton:

(1) Procesin e Stabilizim-Asociimit (PSA)

- Faza përgatitëse për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA)
- Studimi i fizibilitetit
- Negociatat për lidhjen e MSA-së, duke përfshirë edhe Marrëveshje e Përkohshme mbi Tregtinë;
- Nënshkrimi dhe zbatimi i MSA-së

(II) ADERIMI nënkupton:

(2) Kandidaturën për anëtarësim

- Paraqitja e kërkesës për pranim në anëtarësim në BE-në
- Pyetëtori i Komisionit Evropian për gatishmërinë e shtetit kandidat që t'i ndërmarrë detyrimet nga anëtarësimi
- Mendimi i Komisionit Evropian (avis)
- Vendimi i Këshillit Evropian për dhënien e statusit të kandidatit për anëtarësim në BE-në (dhe për fillim të negociatave)

(3) Hapjen e negociatave të aderimit

- Negociatat e aderimit (në 35 kapituj negociues)
- Mbyllja e negociatave aderuese dhe nënshkrimi i Marrëveshjes për aderim në BE-në

(4) Ratifikimin e Marrëveshjes për aderim në BE-në

(5) Hyrjen në anëtarësim në BE-në

1.1. Procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA)

Procesi i Stabilizim-Asociimit u lëviz në qershorin e vitit 1999 si lloj i ri i aderimit rajonal në Bashkimin Evropian në kuadër të politikës së zgjerimit për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i strategjisë së BE-së, në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit, ishte stabilizimi i rajonit, ndërsa si qëllim afatgjatë u theksua asociimi në Union. Si edhe në rastin e procesit të asociimit të shteteve të Evropës qendrore dhe lindore, BE-ja në kuadër të PSA-së për shtetet e Ballkanit Perëndimor i ka theksuar kriteret e njëjta për anëtarësim, të përcaktuara në samitin e Këshillit Evropian në Kopenhagën në vitin 1993, të cilat janë:

- **kriteret politike**, të cilat pasqyrohen në ekzistimin e institucioneve të qëndrueshme të cilat garantojnë demokraci, sundimin e ligjit, të drejtat njerëzore dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave;
- **kriteret ekonomike**, të cilat pasqyrohen në ekzistimin e ekonomisë aktive të tregut e cila është e aftë që t'u ballafaqohet presionit të konkurrencës dhe veprimit të ligjit të tregut brenda Unionit;
- **kriteret juridike**, të cilat pasqyrohen në aftësi për ndërmarrjen e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi, do më thotë në miratimin e trashëgimisë juridike të BE-së (acquis).

Në kryesimin e Këshillit Evropian në Madrid në dhjetorin e vitit 1995 u përfundua që zbatimin e plotë të kriterëve nga Kopenhaga duhet ta ndjekë struktura e përshtatshme administrative. Kështu kriterëve të përmendur më lartë u shtua edhe një kriter i katërt, **kriteri i Madridit**, i cili ka të bëjë me përshtatjen e strukturës administrative me qëllim që të sigurohen kushtet për integrim gradual. Kjo në radhë të parë ka të bëjë me përforsimin e aftësisë administrative, krijimin e sistemit efikas të administratës shtetërore me qëllim që të sigurohet procesi efikas i miratimit dhe zbatimit të trashëgimisë juridike të BE-së.

Një nga hapat më të rëndësishëm në procesin e stabilizimit dhe asociimit është nënshkrimi i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim (MSA), e cila përfaqëson një lloj të ri të marrëdhënies së kontraktuar mes BE-së, nga një anë, dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor, nga ana tjetër. Me nënshkrimin e marrëveshjes për stabilizim-asociim shteti fiton edhe statusin e kandidatit potencial për anëtarësim në BE-në. Rruga nga nënshkrimi i MSA-së deri tek hyrja në anëtarësim me BE-në përbëhet nga disa faza. Kohëzgjatja e çdo faze të posaçme varet kryesisht nga përparimi i shtetit në zbatimin e reformave dhe nga suksesi në zbatimin e detyrimeve të ndërmarra me nënshkrimin e MSA-së.

PROCESIN E STABILIZIM-ASOCIIMIT E KARAKTERIZOJNË:

1. kushtet e barabarta për të gjitha shtetet në kuadër të procesit – të gjitha shtetet duhet patjetër t'i plotësojnë kushtet e njëjta nëse dëshirojnë t'i afrohen BE-së;
2. perspektiva e qartë e anëtarësimit në BE-në – sipas mendimit të Unionit, e vetmja mënyrë që të mbahet stabiliteti i rajonit është perspektivë e qartë e anëtarësimit në BE-në;
3. qasja individuale – shpejtësia me të cilën një shtet kalon përmes fazave të ndryshme të procesit varet nga aftësia e çdo shteti që t'i ndërmarrë dhe plotësojë detyrimet që burojnë nga procesi i asociimit në BE-në;
4. bashkëpunimi rajonal – në kuadër të procesit vëmendja e veçantë i kushtohet bashkëpunimit rajonal; madje në kuadër të procesit krijohen lidhjet e forta mes çdo shteti dhe BE-së, njëkohësisht fortë inkurajohet bashkëpunimi i shteteve që marrin pjesë në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit.

MARRËVESHJA PËR STABILIZIM-ASOCIIM (MSA)

Marrëveshja për Stabilizim-Asociim (MSA) është një marrëveshje me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet e shtetit që ka filluar procesin e asociimit BE-së. Me lidhjen e kësaj marrëveshjeje shtetit në klauzolën evolutive (ang. Evolutionary Clause) i konfirmohet statusi i kandidatit potencial për anëtarësim në BE-në.¹ Marrëveshja nënshkruhet për kohë të pacaktuar me qëllim që t'i kontribuohet stabilitetit ekonomik dhe politik të shtetit të kandidatit të ardhshëm për anëtarësim. MSA-ja është gjeneratë e re dhe e tretë e marrëveshjes për asociim, e ofruar kryesisht për shtetet e Ballkanit Perëndimor, në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit. MSA-ja është marrëveshje me karakter „të përzier“, çfarë do të thotë që, pranë BE-së, palët e kontraktuara janë edhe të gjitha shtetet anëtare, duke marrë parasysh që MSA-ja përfshin fushat të cilat nuk janë kryesisht në kompetencën e BE-së, por i takojnë edhe kompetencës së shteteve anëtare.

Me nënshkrimin e MSA-së shteti ka hyrë në marrëdhënien e parë kontraktuale me BE-në. Duke marrë parasysh që bëhet fjalë për marrëveshje me karakter të përzier, për të hyrë në fuqi, duhej të ishte e konfirmuar (e ratifikuar) në parlamentet e të gjitha shteteve anëtare dhe në PE-në. Deri tek mbarimi i procesit të ratifikimit në BE-në, në fuqi është Marrëveshja e Përkohshme Tregtare (ang. Interim Trade Agreement), e cila është pjesë e MSA-së, dhe e cila në pjesën më të madhe rregullon çështjen e tregtisë dhe transportit mes shtetit në marrëdhënie dhe BE-së. Me hyrjen në fuqi të MSA-së, shteti kandidat potencial për anëtarësim fiton statusin e shtetit të asociuar në BE-në.

1. Klauzola evolutive është formulim nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim. Me këtë klauzolë shteti që fillon asociimin shpreh përcaktimin e vet për aderim në BE-në, kurse BE-ja e pranon atë.

PROCESI I ADERIMIT NË BE-NË PËRBËHET NGA DY PROCESHE PARALELE TË MBËSHTETURA MBI BAZA TË NDRYSHME LIGJORE DHE DETYRA TË NDRYSHME, DHE ATO JANË:

(I) procesi i asociimit në BE-në në bazë të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, prej të cilit qëllimi kryesor është sigurim i kuadrit për procesin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me trashëgiminë juridike të BE-së, si edhe për zbatimin e saj – ka të bëjë me të tërë trashëgiminë juridike të BE-së, harmonizim me atë dhe zbatimin e saj në kuadër të rendit juridik kombëtar.

(II) procesi i negociatave për aderim në BE-në, në të cilin shteti kandidat duhet të arrijë marrëveshjen me anëtarët e BE-së për kushtet e aderimit të tij në Union – merret me çështje specifike në procesin e transferimit të trashëgimisë juridike dhe mbaron me përfundimin e negociatave.

1.2. Negociatat për aderim në BE-në

Rruga pas nënshkrimit të Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim deri tek hapja e negociatave aderuese me BE-në përbëhet nga disa hapa. Pas hyrjes në fuqi të MSA-së dhe fitimit formal të statusit të shtetit kandidat potencial, para kushti kyç për kalim në fazën e ardhshme të procesit të integrimeve evropiane d.m.th. për fillimin e negociatave për aderim është zbatim i plotë i detyrimeve të ndërmarra nga MSA-ja, si edhe aftësia e plotësimit të kriterëve të nevojshme për anëtarësim në BE-në, të cilat janë përcaktuar në përfundimet e Këshillit Evropian nga Kopenhaga dhe Madridi.

Duke u ftuar mbi Marrëveshjen për Bashkimin Evropian (MBE)², shteti i paraqit kërkesën për pranim në anëtarësim. Komisioni Evropian (KE) pas asaj shtetit ia dorëzoi Pyetëtorin, i cili përbëhet nga seti i pyetjeve në bazë të cilave KE-ja jep mendimin për kërkesën e shtetit për pranim në anëtarësim. Plotësimi i përgjigjeve të detajuara mbi Pyetëtorin e dërguar është një nga kushtet për fitimin e statusit të kandidatit për anëtarësim në BE-në, çfarë përfundon me dorëzimin e përgjigjeve mbi Pyetëtorin e dërguar. Në bazë të përgjigjeve të dorëzuara KE-ja përgatit Mendimin (fr. avis) për kërkesën e shtetit për anëtarësim në BE-në. Në Mendimin për kandidaturën e shtetit, KE-ja i rekomandon Këshillit të Bashkimit Evropian (Këshilli) që shtetit në fjalë t'i ndahet statusi i kandidatit për anëtarësim në BE-në, por (nuk) vendos njëkohësisht edhe për ndarjen e datës për fillimin e negociatave. Negociatat për aderim mes shtetit kandidat dhe BE-së formalisht hapen me konferencën e parë ndërqeveritare (KNQ).

2. Kërkesa paraqitet në pajtim me nenin 49 të MBE-së.

Dinamika e përparimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor kah anëtarësimi në BE³

	Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Mali i Zi	Kosova*	Maqedonia	Serbia
Procesi i Stabilizim-Asociimit						
Fillimi i negociatave për lidhjen e MSA-së	31.01.2003	25.11.2005	10.10.2005	28.10.2013	5.04.2000	10.10.2005
Nënshkrimi i MSA-së e MPT-së (Kosova* nuk ka MPT-në)	12.06.2006	16.06.2008	15.10.2007	27.10.2015	9.04.2001	29.04.2008
Hyrja e në fuqi të MPT-së	1.12.2006	01.07.2008	01.01.2008	N/A	01.06.2001	01.02.2010
Hyrja në fuqi të MSA-së	01.04.2009	01.06.2015	01.05.2010		01.04.2004	01.09.2013
Procesi i aderimit në BE-në						
Paraqitja e kandidaturës për anëtarësim	28.04.2009		15.12.2008		22.03.2004	22.12.2009
Pranimi i pyetësorit të KE-së	16.12.2009		22.07.2009		01.10.2004	25.11.2010
Dërgimi i përgjigjes mbi pyetësorin e KE-së	14.04.2010		09.12.2009		14.02.2005	31.01.2011
Ndarja e statusit të kandidatit	23.06.2014		17.12.2010		17.12.2005	01.03.2012
Hapja e negociatave për aderim			29.06.2012			21.01.2014

3. Drejtorja e Përgjithshëm i Komisionit Evropian për Politikë të Fqinjësisë dhe Negociata për Zgjerim http://ec.europa.eu/enlargement/index_en.htm (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)



**PROCESI I
NEGOCIATAVE
PËR ADERIM NË
BASHKIMIN EVROPAIN**

Pjesa e dytë e Udhëzuesit është kushtuar shqyrtimit të procesit të negociatave për aderim në BE-në, me përshkrim të detajuar të çdo hapi në proces. Synimi i këtij Udhëzuesi është që të ofrojë një imazh të qartë dhe të shfaqë rrjedhjen e zhvillimit të negociatave me BE-në, me qëllim që të gjitha palët e interesuara të marrin një imazh të qartë për atë proces dhe t'i kuptojnë aktorët kyçë dhe institucionet e përfshira në proces si edhe të marrin pjesë në mënyrë barabartë në ndjekjen e tij.

Me imazh më të qartë për hapat dhe metodologjinë e udhëheqjes së negociatave për aderim, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile (OSHC), por edhe e anëve të tjera të interesuara kanë mundësi që përmes veprimeve të vet të jenë të përfshirë në procesin e ndjekjes së negociatave në dy mënyra: a) me ofrimin e kontributit të vet cilësor për zgjidhje të propozuara, me masa dhe hapa gjatë vet procesit dhe b) me informimin e qytetarëve për zhvillimin e procesit dhe përmbajtjen e negociatave.

Negociatat për aderim në BE-në përfaqësojnë fazën kyçe të procesit të aderimit dhe ato nënkuptojnë negociatat për kushte dhe mënyra të pranimi dhe zbatimit të trashëgimisë juridike të BE-së. Negociatat nuk zhvillohen në kuptim të vërtetë ligjor të kësaj fjale sepse me negociata nuk depërtohet në përmbajtjen e trashëgimisë juridike të BE-së, por negociohet për modalitete, kushte dhe korniza kohore në të cilat shteti kandidat do ta pranojë trashëgiminë juridike të BE-së në formë në të cilën ajo vlen për të gjitha shtetet anëtare të BE-së në momentin e aderimit të tyre. Pranimi i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve mbi të cilat themelohet BE-ja, duke përfshirë edhe kuadrin institucional në të cilin ai vepron, është kusht për hyrjen në anëtarësim në BE-në.

Trashëgimia juridike e BE-së dhe burimet e tjera janë ndarë në 35 kapituj negociues. Për çdo kapitull negociohet veçanërisht. Negociatat zgjatin ndërsa BE-ja dhe shteti kandidat të mos pajtohen rreth kushteve nën të cilat shteti kandidat do të harmonizojë legjislacionin e vet me trashëgiminë juridike të BE-së.

Procesi i negociatave për aderim në BE-në mund të ndahet në tri faza:

- 1) shqyrtimi analitik i legjislacionit – skringing;**
- 2) faza përmbajtëse e negociatave (hapja, mbyllja e përkohshme e kapitujve);**
- 3) lidhja e marrëveshjes për aderim.**

Pas mendimit pozitiv dhe rekomandimeve të KE-së, pastaj përfundimeve dhe rekomandimeve të Këshillit të BE-së, Këshilli Evropian konfirmon dhe merr një vendim politik që me shtetin kandidat të hapen negociatat për aderim. Njëkohësisht, ai fton KE-në për ta përpiluar propozimin e kornizës negociuese për negociata me shtetin kandidat me qëllim që të mbahet KNQ-ja e parë.

Kuadri negociues i BE-së (ang. Negotiating Framework) përfaqëson pjesën e përgjithshme të pozitës së BE-së, d.m.th. kuadrin e përgjithshëm

mbi të cilin janë themeluar negociatat për aderim me shtetin kandidat për anëtarësim. Bëhet fjalë për dokumentin i cili përcakton parimet, thelbin dhe procedurat sipas të cilave do të zhvillohen negociatat e aderimit. Ai është themeluar mbi përvoja dhe praktika nga proceset e mëparshme të zgjerimit, dhe mbi trashëgiminë juridike të BE-së (acquis), që është vazhdimisht në rritje, duke përfshirë edhe qasjen e re për ndjekjen e përparimit në Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore) dhe Kapitullin 24 (Drejtësia, liria dhe siguria). Qasja e re nënkupton që ndalimi eventual në negociata në kapitujt e cituar shënon ndalimin në tërë procesin negociues. Gjithashtu, ky kuadër përfshin edhe disa elemente (kryesisht të karakterit politik) të cilat janë specifike për shtetin i cili duhet të fillojë procesin e negociatave. Pranë elementeve të përmendura, në përmbajtjen e kuadrit negociues janë përfshirë edhe dy anekse të tjera:

- 1) procedurat për organizimin e negociatave (kryesimi, frekuenca e takimeve, organizimi i detajeve logjistike);
- 2) lista e kapitujve të drejtësisë së BE-së për të cilët do të negociohet (kjo listë në asnjë mënyrë nuk paragjykon vendimin për rendim sipas të cilit do të negociohet për çdo kapitull individualisht të drejtësisë së BE-së).

Kuadri negociues i miratuar më parë është kusht për përcaktimin e datës dhe mbajtjes së KNQ-së së parë.

Formalisht, negociatat për aderim në BE-në zhvillohen në kuadër të KNQ-së bilaterale mes shtetit kandidat për anëtarësim, nga një anë, dhe shteteve anëtare të BE-së, nga ana tjetër. KE-ja koordinon tërë procesin e negociatave në kuadër të KNQ-së. **Konferenca e parë ndërqeveritare** (ang. First Intergovernmental Conference) përfaqëson një përparim i rëndësishëm politik dhe fillim formal të negociatave për aderim. Ka një karakter solemn, kurse në këtë konferencë përfaqësuesit e shteteve anëtare të BE-së dhe shtetit kandidat prezantojnë pritjet e vet në lidhje me negociatat e ardhshme. Në delegacionin e BE-së janë përfaqësuesit të Këshillit dhe KE-së. Delegacionin e BE-së e udhëheqin ministri i punëve të jashtme të shtetit i cili në atë moment e kryeson Këshillin dhe komisioneri i BE-së i detyruar për çështjen e politikës për zgjerim (aktualisht Komisioneri i detyruar për politikë të fqinjësisë dhe negociata për zgjerim). Delegacionin e shtetit kandidat përfaqësojnë zyrtarët më të lartë shtetërorë – kryeministri, ministri i punëve të jashtme/i integriteteve evropiane dhe personi i emëruar që të udhëheqë negociatat për aderim. Në konferencën e parë ndërqeveritare përfaqësohen pozitat e përgjithshme negociuese (duke përfshirë edhe kuadrin negociues të miratuar më parë), ekipet negociuese dhe kalendari, d.m.th. orari i mbajtjes së takimeve të ardhshme. Hapja formale dhe thelbësore, por edhe mbyllja e negociatave për aderim sipas çdo kapitulli individualisht organizohet në të ardhmen në formë të konferencave të tilla bilaterale aderuese dy herë në vit, zakonisht një në nivelin ministror, kurse herën e dytë në nivelin e zëvendëshefave të delegacioneve.

2.1. Fazat në procesin e negociatave për aderim

2.1.1. Shqyrtimi analitik i legjislacionit - skringing

Skriningu është shqyrtim analitik i pajtueshmërisë së legjislacionit të shtetit kandidat me trashëgiminë juridike të BE-së dhe përfaqëson hap fillestar në kuadër të negociatave për aderim, në të cilin vlerësohet përputhja e legjislacionit në çdo kapitull individualisht.⁴ Qëllimi i këtij procesi është që të përcaktohen dallimet ekzistuese në legjislacionin e BE-së dhe legjislacionin e shtetit kandidat. Në procesin e skringing-ut, para BE-së marrin pjesë përfaqësuesit e KE-së, d.m.th. përfaqësuesit e drejtorëve të përgjithshëm me kompetencë, kurse para shtetit kandidat anëtarët e grupeve punuese për përgatitjen e negociatave sipas kapitujve negociues individualë, përfaqësuesit e organeve dhe trupave të administratës shtetërore. Skringingu zbatohet veçanërisht për çdo kapitull negociues, megjithatë mund të zbatohet edhe për disa kapituj paralelisht. Kohëzgjatja e tij për kapitull varet nga vëllimi dhe sasia e trashëgimisë juridike në kapitullin në fjalë dhe mund të zgjatë nga një deri më disa ditë, ndërsa e tërë procedura e skringingut zgjat rreth një viti. Fazat themelore të shqyrtimit analitik të legjislacionit janë:

- 1) skringingu shpjegues (ang. Explanatory Screening);**
- 2) skringingu bilateral (ang. Bilateral Screening);**
- 3) raporti për skringing (ang. Screening Report).**

Orarin e skringingut (ang. Screening Timetable) e përgatit KE-ja, të cilin pastaj e përshtat me shtetin kandidat. Orari përfaqëson kuadrin indikativ kohor në të cilin do të kryhet procesi i shqyrtimit analitik të legjislacionit të shtetit kandidat dhe vlerësimit të nivelit të përputhjes së tij me drejtësinë e BE-së. Orari përfshin edhe rendim sipas të cilit do të kryhet shqyrtimi analitik i të gjithë kapitujve negociues, si edhe koha e cila do të jetë e nevojshme për skringing shpjegues dhe bilateral. Qasja e re në negociata nënkupton që gjatë përgatitjes së orarit të skringingut ai të fillojë me kapitujt 23 e 24. Është e rëndësishme të përmendet që skringingu deri tani nuk është zbatuar për Kapitullin 34 (Institucione) dhe Kapitullin 35 (Çështje të tjera).

Skringingu shpjegues ka për qëllim që përfaqësuesve të shtetit kandidat në mënyrë të detajuar t'u përfaqësohet kuadri ligjor i BE-së në kapitullin në emër për fusha individuale të politikës. E përgatis KE-ja dhe zhvillohet në formë të takimeve me rendin ditor të përcaktuar saktësisht, kurse për këto takime përfaqësuesit e KE-së, përmes prezantime të ndryshme, tregojnë për informacionet dhe faktet më të rëndësishme nga korpusi i dhënë juridik të BE-së.

4. Madje ekziston praktika që kjo fazë të fillojë pas mbajtjes së KNQ-së së parë dhe përfaqësimit të pozitave të përgjithshme, kjo nuk ishte rast kur bëhet fjalë për Malin e Zi dhe Republikën e Serbisë. Duke marrë parasysh interesin e ççantë të BE-së për kapitujt 23 e 24, procesi i skringingut filloi edhe para mbajtjes së KNQ-së së parë.

Skriningun bilateral e përgatis shteti kandidat në pajtim me materiale të cilat i dorëzoi KE-ja (listat e skringut, pyetjet, pyetjet plotësuese etj.) Në takimet e skringut bilateral përfaqësuesit e delegacionit të shtetit kandidat përfaqësojnë kuadrin kombëtar ligjor në kapitullin e dhënë negociues, si edhe vlerësimin e nivelit të përshtatshmërisë dhe planet për arritjen e harmonizimit të plotë me trashëgiminë juridike të BE-së deri tek momenti i hyrjes në anëtarësim. Gjithashtu, tregohet edhe për probleme dhe vështirësi me të cilat mund të ballafaqohet në procesin e mëtejshëm të harmonizimit. Ky skringing zhvillohet në formë të takimeve, kurse respektohet rendi ditor i njëjtë ose i ngjashëm edhe gjatë takimeve të skringut shpjegues.

Pas takimit të mbajtur të skringut bilateral, KE-ja përgatis një **raport për skringing** për çdo kapitull negociues, i cili përmban edhe vlerësimin e nivelit të përshtatshmërisë së legjislacionit të shtetit kandidat me trashëgiminë juridike të BE-së, si edhe rekomandime për përputhjen e mëtejshme të kuadrit kombëtar juridik me trashëgiminë juridike të BE-së. Gjatë përgatitjes së këtij raporti përdoren dokumentet dhe informacionet të cilat i ka përfaqësuar shteti kandidat gjatë skringut, por edhe pas tij. Ajo çfarë citohet në raport në një masë të madhe përcakton rrjedhjen e mëtejshme të veprimeve në tërë procesin. Raportet për skringingun KE-je ua prezanton shteteve anëtare të BE-së, d.m.th. Këshillit të BE-së, i cili i shqyrton, dhe pastaj i miraton. Varësisht nga vlerësimi i KE-së, d.m.th. nga përfundimet e raportit për skringing, janë të mundshme dy skenarë:

1) KE-ja në raport përfundon që shteti kandidat në një masë të madhe e ka harmonizuar legjislacionin e vet me trashëgiminë juridike të BE-së, dhe që është e gatshme për t'i filluar negociatat në kapitullin në fjalë dhe jep rekomandimin në atë kuptim. Raporti i paraqitet Këshillit për shqyrtim dhe miratim. Në rast se shtetet anëtare të BE-së në kuadër të Këshillit nuk kanë vërejtje mbi raportin, Këshilli drejtpërdrejt fron kandidatin për të dorëzuar pozitën e vet negociuese për kapitullin në fjalë.

2) Në bazë të informacioneve të prezantuara në raport, KE-ja përfundon që shteti kandidat nuk është e gatshme për t'i filluar negociatat në kapitullin negociues në fjalë dhe që duhet të zbatojë veprimet e nevojshme të cilat do të çonin kah përshtatshmëria e mëtejshme me drejtësinë e BE-së. Në atë rast KE-ja në raport jep rekomandim, d.m.th. **kriteret për hapjen e negociatave** (ang. Opening Benchmarks) të cilat duhet patjetër të plotësohen më parë për t'u arritur deri tek hapja e kapitullit konkret negociues. Kriteret për hapjen e negociatave për disa kapituj mund të kenë forma të ndryshme, siç janë kërkesa për miratimin e strategjive dhe planeve të veprimit, kërkesa për plotësimin e detyrimeve kontraktuale me BE-në – në radhë të parë zbatimi i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, dhe kërkesat për miratimin e ligjeve dhe akteve nënligjore. Kriteret mund të revidohen ose plotësohen, veçanërisht në raste kurs shteti negociacion shumë kohë, kurse ndërkohë BE-ja miratoi rregulla të reja në ato fusha.

Këshilli diskuton për raportin për skringing të cilin e ka përgatitur KE-ja dhe në bazë të tij miraton një dokument i cili quhet **rezultati i skringut**. (ang. Out-

come of the Screening). Ky dokument përmban rekomandimet për hapjen e negociatave në kapitullin e caktuar negociues d.m.th. kriteret të cilat shteti kandidat duhet t'i plotësojë si parakusht për hapjen e negociatave në kapitullin në fjalë. KE-ja në konsultime dhe bashkëpunim me shtetin kandidat ndjek realizimin e planeve për plotësimin e kriterëve dhe ia paraqet raportin Këshillit të BE-së.

Raporti për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve për hapjen e negociatave (ang. Opening Benchmark Assessment Report) përfaqëson shqyrtimin e kriterëve të cilat shteti kandidat planifikon t'i zbatojë për t'i kapërcyer mungesat në raporte për skringing. Kur KE-ja është e kënaqur me cilësinë e planeve të veprimit dhe kur shteti kandidat i plotëson kriteret të cilat janë përcaktuar, KE-ja raportin e përgatitur ua përfaqëson organeve kompetente të Këshillit të BE-së. Në bazë të fakteve të prezantuara dhe vlerësimit të KE-së, Këshilli miraton përfundimet dhe fton shtetin kandidat që ta dorëzojë pozitën e vet negociuese për kapitullin negociues të dhënë.

2.1.2. Faza përmbajtëse e negociatave

Negociatat për aderim në BE-në zhvillohen në bazë të pozitive negociuese të BE-së dhe të shtetit kandidat, të cilat përgatiten për çdo kapitull negociues në bazë të rezultateve të skringing-procesit. Këshilli i BE-së merr vendim për hapjen e negociatave në kapitullin e caktuar pasi që më parë është konfirmuar që janë realizuar të gjitha parakushtet për hapjen e negociatave. Hapja e negociatave për kapitullin për të cilin ishin përcaktuar kriteret për hapjen e negociatave mund të fillojë pas vendimit të Këshillit që shteti kandidat ka plotësuar këto kriterë.

Nëse Këshilli vlerëson që shteti kandidat është i gatshëm për hapjen e kapitullit të caktuar, ai do të ftojë shtetin kandidat për ta dorëzuar **pozitën negociuese** (ang. Negotiation Position of the Candidate Country) për një kapitull të caktuar. Pozita negociuese përfaqëson platformën për negociatat e shtetit kandidat për kapitullin e caktuar të drejtësisë së BE-së. Në pozitën negociuese për ndonjë kapitull shteti kandidat prezanton nivelin e arritur të pajtueshmërisë me trashëgiminë juridike të BE-së, programin e pajtueshmërisë së mbetur dhe shqyrtimin e kapaciteteve ekzistuese dhe të ardhshme administrative për implementim. Pranë asaj, në pozitën negociuese shteti kandidat përcakton edhe kërkesat për afate kalimtare, d.m.th. përjashtimet në ato segmente ku konsideron nga arsye të kuptueshme, që nuk do të jetë në mundësi që kreytësisht të vendosë rendin ligjor të BE-së në kuadrin ligjor deri tek momenti i parashikuar për aderim në BE-në. Shteti kandidat mund t'ia dorëzojë plotësimin Bashkimit Evropian gjatë negociatave, d.m.th. ndryshimin e pozitive negociuese. Pozitën negociuese për çdo kapitull e përpilojnë grupet negociuese, d.m.th. ekipi negociues duke e përdorur mekanizmin koordinues të krijuar për negociatat adruese. Pozita negociuese për kapitull të caktuar pas miratimit formal në shtetin kandidat i dorëzo-

het Bashkimit Evropian.

KE-ja e përgatis draftin e pozitës së përbashkët të BE-së (ang. Draft European Union Common Position) dhe ia paraqet Këshillit për miratim. Me draftin e Pozitës së përbashkët të BE-së, KE-ja mund:

- 1) të konstatojë që shteti kandidat në atë kapitull ka arritur nivelin e mjaftueshëm të pajtueshmërisë me trashëgiminë juridike të BE-së, dhe që negociatat e mëtejshme në atë kapitull nuk janë të nevojshme, dhe në atë rast kapitulli mbyllet përkohësisht;
- 2) të konstatojë që niveli i pajtueshmërisë nuk është në nivelin i cili mundëson mbylljen e përkohshme të kapitullit, dhe përcakton kushtet, d.m.th. **kriteret për mbylljen e kapitullit** (ang. Closing Benchmarks) të cilat shteti kandidat duhet t'i plotësojë për t'u arritur deri tek mbyllja e kapitullit;
- 3) të vendosë edhe **kriteret kalimtare** (ang. Interim Benchmarks) për Kapitujt 23 e 24, që janë veçanërisht delikate, me qëllim që më qartë ta ndjekë përparimin në realizimin e reformave dhe të procesit e pajtueshmërisë të legjislacionit në këto fusha të rëndësishme, dhe mbas plotësimit të tyre përcaktohen kriteret për mbylljen e kapitullit.

Këshilli i BE-së miraton **pozitën e përbashkët të BE-së** (ang. European Union Common Position) si përgjigje mbi pozitën e shtetit kandidat. Nëse shteti kandidat ka realizuar nivelin e mjaftueshëm të përputhshmërisë me trashëgiminë juridike në kapitull të caktuar, konstatohet që negociatat e mëtejshme në këtë kapitull nuk janë të nevojshme dhe që ai mbyllet përkohësisht. Nëse është vlerësuar që nevojiten hapat plotësues në harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me atë evropian, përcaktohen kriteret për mbylljen e kapitullit, të cilat shteti kandidat duhet t'i plotësojë për t'i mbyllur negociatat përkohësisht për kapitullin në fjalë.

Kapitujt negociues hapen dhe mbyllen përkohësisht në konferencën ndërqeveritare e cila organizohet në pajtim me rrjedhjen dhe dinamikën e hapjes së kapitujve negociues dhe plotësimin e kriterëve për hapjen ose mbylljen e tyre të përkohshme. Gjithashtu, duhet marrë parasysh, që varësisht nga ajo a ekzistojnë kriteret për hapjen e negociatave, për mbylljen e negociatave, d.m.th. kriteret kalimtare, janë të mundshme edhe procedurat e ndryshme të zhvillimit të negociatave në çdo kapitull.

Skemën e detajuar të rrjedhjes së negociatave me skenarë të mundshëm, e cila tregon për ndërlikueshmërinë e procesit negociues për anëtarësim në BE-në shih në Shtojcën 1 (Zhvillimi i negociatave – Pesë skenarë të mundshëm).

2.1.3. Lidhja e marrëveshjes për aderim

Pas mbarimit të negociatave për çdo kapitull individualisht, KE-ja harton një raport të veçantë me pasqyrimin e gjendjes dhe vlerësimin e të tërë gatishmërisë së shtetit kandidat për t'i ndërmarrë detyrimet të cilat dalin nga anëtarë-

simi në BE-në, në të cilin propozohet përfundimi i negociatave aderuese. Ky propozim kalon nëpër procedurë të njëjtë në nivelin e Këshillit, i cili miraton që në konferencën përfundimtare ndërqeveritare të konstatohet përfundimi formal i negociatave, propozon nënshkrimin e marrëveshjes për aderim, si edhe datën e hyrjes në anëtarësim. Kjo pastaj konstatohet në përfundimet e Këshillit Evropian. Ndërsa Këshilli Evropian të mos konfirmon përfundimin e negociatave në të gjithë kapitujt, ekziston mundësia e hapjes së çdo kapitulli negociues, në rast se shteti nuk ka plotësuar ose nuk i plotëson detyrimet e ndërmarra.

Rezultatet e negociatave aderuese përfaqësohen dhe vendosen në draftin e **marrëveshjes për aderim** (ang. Accession Treaty) dhe të **aktit** ndjekës **për aderim**, me të cilët rregullohen të gjithë detajet dhe kushtet e aderimit të shtetit kandidat për anëtarësim në BE-në, d.m.th. data e aderimit, rezultatet e negociatave, kushtet për aderim dhe periudha kalimtare në fusha të cilat Komisioni i ka identifikuar si të nevojshme për harmonizim plotësues, pjesëmarrja në punën e organeve të BE-së (ndarja e votave në Këshillin dhe PE-në, si edhe numri i anëtarëve në PE-në).

Marrëveshja për aderim është marrëveshje ndërkombëtare bilaterale mes shteteve anëtare të BE-së, nga një anë, dhe shtetit kandidat, nga ana tjetër.

Pasi që është nënshkruar, marrëveshja për aderim hyn në periudhën e ratifikimit në shtetet anëtare të BE-së dhe nevojitet që të jetë e miratuar edhe në PE-në. Deri tek momenti i hyrjes në fuqi të marrëveshjes për aderim, sipas mbarimit të procesit të ratifikimit, shteti në rolin e vëzhguesit merr pjesë në punën e organeve të BE-së me qëllim që me vëmendje të ndjekë procesin e miratimit të vendimeve në nivelin e BE-së. Përveç asaj, shteti duhet të vazhdojë me zbatimin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar deri tek momenti i hyrjes në fuqi të marrëveshjes për aderim dhe datës së hyrjes në anëtarësim të plotë.

Shteti bëhet anëtarja me fuqi të plotë të BE-së me ditën e cila është përcaktuar në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare të marrëveshjes për aderim në BE-në, nën kusht që me kohë është mbaruar procesi i ratifikimit në parlamentet e të gjitha shteteve anëtare.

2.2. Aktorët në procesin e negociatave për aderim

Pjesëmarrësit e negociatave për aderim janë shtete anëtare të BE-së dhe shteti kandidat për anëtarësim.

Strukturat dhe organet e BE-së të përfshira në procesin e negociatave janë të njëjta në bazë si ato të përdorura në ciklet e mëparshme të zgjerimit. Qëndrimet negociuese të BE-së në emër të shteteve anëtare i përfaqëson shteti i cili kryeson Këshillin e BE-së.

Në shtetet candidate për anëtarësim, organet dhe strukturat të cilat marrin pjesë në negociatat e aderimit dallohen, varësisht nga rregullimi juridiko-politik

dhe tradita, kurse në disa raste edhe nga personat të cilët marrin pjesë në ato. Të gjitha shtetet anëtare kanë negociator kryesor ose shef të ekipit negociues, i cili merr pjesë në takime në Bruksel, dhe këtu ndalon ngjashmëria.

2.2.1. Struktura negociuese e Bashkimit Evropian

Në pajtim me Përfundimet e Këshillit Evropian nga dhjetori i vitit 2004, negociatat aderuese me shtetet kandidatë për anëtarësim zhvillohen në bazë të kuadrit negociues, i cili përcakton mënyrën dhe parimet në bazë të cilave negociohet.

Këshilli i Bashkimit Evropian (Këshilli i Ministrave të BE-së) shqyrton rezultatet e skringut, vlerëson mundësinë e shtetit kandidat që t'i zbatojë trashëgiminë juridike në kapitullin e caktuar negociues dhe fton shtetin kandidat për ta dorëzuar pozitën negociuese, nëse të gjitha kushtet janë plotësuar. Pozitat negociuese e BE-së i përgatisin grupet punuese të Këshillit të ministrave të BE-së. Trupi punues i Këshillit të BE-së për zgjerim dhe shtete të cilat udhëheqin negociata për aderim – COELA (ang. Working Party on Enlargement and Countries Negotiating Accession to the EU), i cili përbëhet nga përfaqësuesit e përfaqësive të përhershme të shteteve kandidatë pranë BE-së, koordinon procesin e përgatitjes së pozitive negociuese nga ana e BE-së dhe për atë rregullisht u raporton anëtarëve të Komitetit të përfaqësuesve të përhershëm (COREPER).

Këshilli Evropian merr vendim se shteti kandidat për anëtarësim të fillojë procesin e negociatave për aderim në BE-në dhe konfirmon kuadrin negociues. Këshilli Evropian, sipas mbarimit të negociatave për aderim, merr vendim për përfundimin formal të negociatave.

Komisioni Evropian i përgatis dokumentet dhe draftin e pozitës negociuese për Këshillin. KE-ja zhvillon në mënyrë operative negociatat aderuese në emër të BE-së dhe ua ofron këshillat shtetit kandidat në lidhje me realizimin e qëllimeve të politikave publike dhe zbatimin e trashëgimisë juridike të BE-së. Si i tillë, KE-ja tradicionalisht është aleat i shtetit kandidat që negocion për anëtarësim.

Parlamenti Evropian jep pajtim për anëtarësim me fuqi të plotë për shtetin kandidat i cili me sukses ka kaluar përmes negociatave aderuese. PE-ja mund të bëjë presion mbi palët negociuese me dhënien e mendimit për disa çështje specifike të cilat kanë të bëjnë me procesin e negociatave aderuese (më shpesh për çështje të cilat kanë të bëjnë me realizimin e qëllimeve të politikave publike të BE-së ose me probleme në zbatim të trashëgimisë juridike në ndonjë nga fushat e politikave).

Shtetet anëtare e BE-së zhvillojnë pozitat kombëtare, të cilat harmonizohen në pozitën unike negociuese ndaj shtetit kandidat përmes konsultimeve dhe punës së përbashkët në grupet punuese të Këshillit dhe COREPER-it. Për të hyrë në fuqi, marrëveshjen për aderim duhet ta konfirmojnë (ratifikojnë) të gjitha shtetet anëtare.

2.2.2. Struktura negociuese e shtetit kandidat për anëtarësim

Nuk ekziston forma e dhënë më parë e strukturës negociuese të shtetit kandidat. Strukturën negociuese e rregullon vet shteti kandidat, duke marrë parasysh kapacitetet e vet, si edhe vëllimin e punës që e pret. Struktura negociuese e shtetit kandidat varet, nga një anë nga rregullimi i brendshëm ekzistues dhe sistemi i ndarjes së pushtetit, ndërsa, nga ana tjetër, nevoja për krijimin e saj mund t'i shkaktojë reformat në vet rregullimin e brendshëm duke i kontribuar formimit të trupave dhe pozitive të reja.

Për shkak të koordinimit më të lehtë dhe ndarjes së punëve çdo prej shteteve kandidate për anëtarësim në BE-në e cila gjendet në procesin e negociatave aderuese, ose ka përfunduar këtë proces me sukses, ose ka krijuar strukturën e veçantë për udhëheqjen e negociatave për aderim. Siç është përmendur më parë, e vetmja gjë e përbashkët në strukturën për udhëheqjen e negociatave për të gjitha shtetet është emërimi i personit që është në krye të procesit negociues – në karakterin e shefit të ekipit negociues ose të kryenegociatorit. Detyra kryesore e personit të emëruar është koordinim gjithëpërfshirës i punës në procesin e negociatave, si edhe lidhje dhe komunikim mes aktorëve administrativo-teknike dhe aktorëve që marrin pjesë në proces në nivelin më të lartë politik.

Pjesa e madhe e punës në negociatat aderuese i ngarkon administratat publike – të punësuarit në institucionet qeveritare dhe trupat që punojnë mbi punët e integritimeve evropiane, si edhe mbi zbatimin e politikave specifike në nivelin kombëtar, por edhe lokal.

Një ngjashmëri më në struktura të themeluara për udhëheqjen e negociatave aderuese është ekzistimi i Sekretariatit për struktura negociuese, i cili koordinon punën e shumë aktorëve të përfshirë në procesin dhe i cili është përgjegjës për komunikim me institucionet dhe trupat e Bashkimit Evropian.

Varësisht nga rregullimi politiko-shoqëror dhe vendimi i marrë në nivelin më të lartë politik rolin e rëndësishëm në negociata aderuese e kanë edhe parlamentet e shteteve kandidate si edhe palët e tjera – përfaqësuesit e shoqërisë civile.



**SHQYRTIMI DHE ANALIZA E
STRUKTURËS SË DOKUMENTEVE
TË CILAT SHFAQEN NË
PROCESIN E NEGOCIATAVE**

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është që të ofrojë një shqyrtim të detajuar të dokumenteve të cilat rrjedhin nga procesi i negociatave për aderim dhe kjo në çdo fazë individualisht. Me qasje në dokumente dhe kuptimin e drejtë të tyre palët e interesuara në procesin e negociatave për aderim do të kenë mundësi që më qartë të ndjekin të tërë procesin e negociatave përmes çdo prej hapave të përmendur dhe përmes çdo prej dokumenteve individualisht që janë rezultat e procesit negociues. Duke njohur strukturën dhe përmbajtjen e vetë dokumenteve, pjesëmarrësit e interesuar në procesin e negociatave, por edhe ata që kryejnë mbikëqyrjen e përhershme mbi procesin e negociatave por nuk janë përfshirë në atë drejtpërdrejt, do të kenë mundësi që në mënyrë më efektive të ndjekin plotësimin e detyrimeve të dhëna në proces për të dyja anët, si edhe mënyra, korniza financiare dhe kohore të nevojshme për plotësimin e tyre.

Me qasje në përmbajtjen e dokumenteve në çdo fazë të procesit, për çdo kapitull negociues individualisht krijohet imazhi i qartë i gjendjes në fushën e caktuar të politikës së shtetit kandidat dhe hapat e nevojshëm për harmonizimin e saj me kuadrin ligjor evropian. Gjithashtu, në atë mënyrë ofrohet mundësia që të punohet mbi vlerësimin plotësues dhe ndjekjen e gjendjes përmes hartimit të raporteve, studimeve dhe analizave të caktuara që do t'u përfaqësohen më vonë vendimmarrësve të shteteve candidate të përfshirë në proces si edhe organeve të BE-së, anëve të interesuara në shtetet anëtare, por edhe publikut më të gjerë.

Siç është thënë më parë, procesi i negociatave për aderim në BE- në zhvillohet në tri faza:

- 1) skringing;**
- 2) faza përmbajtëse e negociatave (hapja dhe mbyllja e përkohshme të kapitujve);**
- 3) lidhja e marrëveshjes për aderim.**

Për nevojat e hartimit të këtij Udhëzuesi në këtë pjesë do të prezantohen vetëm dokumentet që janë rezultati i dy fazave të para të procesit negociues.

3.1. Skringingu

Skringingu përfaqëson fazën fillestare në procesin e negociatave në të cilin jepet vlerësimi i përputhshmërisë së kuadrit kombëtar ligjor me kuadrin ligjor të BE-së për çdo kapitull negociues veçanërisht. Skringingu përbëhet nga dy faza, nga skringingu shpjegues – në të cilin përfaqësuesit i KE-së shtetit kandidat ia përfaqësojnë kuadrin ligjor të BE-së në fushën e caktuar të politikës dhe nga skringingu bilateral – në të cilin delegacioni i shtetit kandidat, për çdo prej kapitujve të dhënë, përfaqësuesve të KE-së ua përfaqëson përshtatshmërinë e kuadrit kombëtar ligjor me kuadrin ligjor të BE-së si edhe plane për harmonizim të mëtejshëm. Pas mbarimit të takimeve të skringut bilateral KE-ja harton raportin për skringing, për çdo kapitull negociues veçanërisht.

3.1.1. Raporti për skringing

Raportin për skringing e harton KE-ja. Pas harmonizimit të tekstit të raportit, ai miratohet në kuadër të Trupit Punues të Këshillit të Ministrave të BE-së për zgjerim dhe shtete të cilat udhëheqin negociatat për aderim – COELA.

Ky është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm për të gjitha palët e interesuara të përfshira në procesin e negociatave për aderim duke marrë parasysh që ai jep bazat fillestare për zhvillimin e mëtejshëm dhe përparimin e negociatave në kapitullin e caktuar.

Raporti për skringing përbëhet nga tri pjesë:

- 1) përmbajtja e kapitullit;**
- 2) kapaciteti i shtetit për harmonizim dhe implementim;**
- 3) vlerësimi i nivelit të përshtatshmërisë dhe kapaciteteve për implementim.**

Në përmbajtjen e kapitullit jepet shqyrtimi i shkurtë i trashëgimisë juridike të BE-së në kuadër të kapitullit të caktuar, ku më shpesh theksohen parimet themelore mbi të cilat bazohet kuadri ligjor në fushën e caktuar të politikës që burojnë nga marrëveshjet themeluese të BE-së. Përveç asaj, janë cituar edhe disa prej dispozitave kyçe të legjislationit dytësor të BE-së (dispozitat, direktivat, vendimet) me të cilat duhet bërë harmonizimin e legjislationit kombëtar në kuadër të kapitullit të caktuar.

SHEMBULLI 1: RAPORTI PËR SHQYRTIMIN ANALITIK TË PËRSHTATSHMËRISË SË LEGJISLACIONIT PËR MALIN E ZI PËR KAPITULLIN 23 (GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE)

I. PËRMBAJTJA E KAPITULLIT

„...Politikat e BE-së në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore e kanë për qëllim ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të Unionit si hapësirë e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Parimi i sundimit të ligjit dhe e drejta për gjykim të drejtë, siç është përcaktuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat njerëzore dhe nenin 47 të Kartës për të drejtat themelore të Bashkimit Evropian, parashikojnë që gjyqësori duhet të jetë i pavarur dhe i paanshëm.“

Raporti për shqyrtimin analitik të përshtatshmërisë së legjislationit për Malin e Zi për Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore), f. 2.5⁶

5. Raporti për shqyrtim analitik të përshtatshmërisë së legjislationit për Malin e Zi për Kapitullin 23, f. 2, <http://www.eu.me/mn/23/23-dokumenti> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

6. Raporti për shqyrtim analitik të përshtatshmërisë së legjislationit për Malin e Zi për Kapitullin 23, f. 2, <http://www.eu.me/mn/23/23-dokumenti> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

Pjesa e dytë e dokumentit, Kapacitetet e shtetit për harmonizim dhe implementim, jep shqyrtimin e përshtatshmërisë së kuadrit kombëtar ligjor të shtetit kandidat me kuadrin ligjor të BE-së dhe shqyrtimin e kapaciteteve të shtetit kandidat për zbatimin e kuadrit ligjor. Ky shqyrtim është dhënë në bazë të informacioneve të cilat shteti kandidat i ka dhënë në takimet e skringut, si edhe në bazë të informacioneve plotësuese të cilat KE-ja i ka kërkuar për shkak të hartimit të dokumentit në fjalë, dhe të cilat shteti kandidat i ka dorëzuar. Pjesa e dytë e Raportit për skringing përfaqëson pjesën më të madhe dhe të rëndësishme të dokumentit, duke marrë parasysh që në kuadër të tij është dhënë shqyrtimi i qartë i përshtatshmërisë së kuadrit ligjor të shtetit kandidat ashtu siç e kanë përfaqësuar organet shtetërore, institucionet dhe trupat të cilat marrin pjesë në procesin negociues, ndërsa të gjitha anëve të tjera të interesuara që janë përfshirë në procesin e ndjekjes së negociatave për aderim ua jep imazhin e qartë të gjendjes si edhe mundësinë që informacionet e cituara t'i kontrollojnë, t'i tregojnë për mungesa, por edhe që veprime të mëtejshme, veçanërisht veprimet të shoqërisë civile t'i drejtojnë kah përforsimi dhe zbatimi i veprimeve që mund të çojnë në përmirësimin dhe implementimin efikas të kuadrit të harmonizuar ligjor.

SHEMBULLI 2:

RAPORTI PËR SHQYRTIMIN ANALITIK TË PËRSHTATSHMËRISË SË LEGJISLACIONIT PËR MALIN E ZI PËR KAPITULLIN 23 (GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE)

II. PËRSHATSHMËRIA E SHTETIT DHE KAPACITETET PËR IMPLEMENTIM

I Gjyqësori: Efikasiteti

„...Me ditën 31 dhjetor të vitit 2011, numri i çështjeve të prapambetura në atë vit ka qenë për 4% më të ulët sesa në vitin 2010 dhe ka qenë rreth 11.500 çështjeve të pazgjidhura në të gjitha gjykatat në Malin e Zi. Mes këtyre çështjeve të pazgjidhura, 38% janë çështjet kontestimore, 8% penale, 1.5% jokontestimore dhe 58% kryerjet. Duke përjashtuar Gjykatën themelore në Podgoricë, numri i çështjeve të prapambetura të pazgjidhura gradualisht është duke u zvogëluar.“

Raporti për shqyrtimin analitik të përshtatshmërisë së legjislacionit për Malin e Zi për Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore), f. 6.⁷

Në pjesën e tretë të Raportit për skringing, Vlerësimi i nivelit të përshtatshmërisë dhe kapaciteteve për implementim, jepet vlerësimi i nivelit të përshtatshmërisë dhe kapaciteteve për implementimin të shtetit kandidat në fushën e caktuar të politikës, në kuadër të çdo kapitulli negociues. Kjo pjesë të raportit veçanërisht është e rëndësishme sepse përmban, për çdo prej fushave të politikave që janë

7. Raporti për shqyrtimin analitik të përshtatshmërisë së legjislacionit për Malin e Zi për Kapitullin f. 6, <http://www.eu.me/mn/23/23-dokumenti> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

përfshirë në kapituj negociues, edhe rekomandime për rritjen e nivelit të përshtatshmërisë së kuadrit ligjor në kapitullin specifik me kuadrin ekzistues ligjor të BE-së. Këto rekomandime përfaqësojnë drejtimit për miratim të masave, veprimeve ose planeve të veprimit që duhet realizuar para se mund të hapen negociatat në një kapitull të caktuar. Këto drejtime quhen kriteret për hapjen e kapitullit.

SHEMBULLI 3:

RAPORTI PËR SHQYRTIMIN ANALITIK TË PËRSHTATSHMËRISË SË LEGJISLACIONIT PËR MALIN E ZI PËR KAPITULLIN 23 (GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE)

III. VLERËSIMI I NIVELIT TË PËRSHTATSHMËRISË DHE KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

I Gjqësori: Profesionalizmi, ekspertiza, efikasiteti:

„... Të sigurohet statistika e sigurt dhe konsistente dhe të vendoset sistemi i ndjekjes së kohëzgjatjes së procesit gjyqësor. Të rivlerësohet dhe racionalizohet rrjeti gjyqësor dhe të sigurohen mjaft mjete për funksionimin efikas të tërë sistemit gjyqësor. Të zvogëlohet më shumë numri i mbetur i çështjeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për çështje kontestimore. Të përmirësohet kryerja e aktgjykimeve në çështjet kontestimore. Të sigurohet funksionimi efikas i Qendrës për edukimin e mbajtësve të funksionit gjyqësor. Të ndërmerren masat nxitëse që do t'i kontribuojnë lëvizshmërisë vullnetare të gjyqtarëve dhe prokurorëve.“

Raporti për shqyrtimin analitik të përshtatshmërisë së legjislacionit për Malin e Zi për Kapitullin 23 (Gjqësori dhe të drejtat themelore), f. 23⁸

3.1.2. Rezultati i skringut

Rezultati i skringut është dokument që e miraton Këshilli, pasi që për të është diskutuar në kuadër të COELA-s. Dokumenti përfaqëson përmbledhjen e raportit për skringing dhe në të qartë janë futur në listë rekomandimet të cituara në kuadër të raportit për skringing që përfaqësojnë kriteret për hapjen e negociatave. Vet rezultati i skringut përbëhet nga dy pjesë:

- 1) pjesa hyrëse – përmbledhja e raportit në kapitullin e caktuar dhe**
- 2) rekomandimi.**

Rezultati i skringut vetëm konfirmon ajo çfarë është përfshirë me raportin për skringing, duke theksuar në planin e parë vlerësimin e përshtatshmërisë së legjislacionit të shtetit kandidat me kuadrin ligjor të BE-së në kapitullin e cak-

8. Raporti për shikimin analitik të përshtatshmërisë së legjislacionit për Malin e Zi për Kapitullin f. 23, <http://www.eu.me/mn/23/23-dokumenti> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

tuar. Pranë asaj, ky dokument i citon një herë më rekomandimet për zmadhimin dhe arritjen e nivelit të përputhjes së legjislationit në kapitullin të cituar. Duke marrë parasysh që negociatat për aderim në BE-në janë negociata me shtetet anëtare të BE-së, rezultati i skringut në të cilin janë konfirmuar rekomandimet nga raporti për skringing thekson në mënyrë plotësuese nevojën që shteti kandidat t'i përmbushë rekomandimet e cituara – kriteret për hapjen e kapitullit – sepse e kanë miratuar shtetet anëtare në kuadër të Këshillit.

Duke marrë parasysh parimin e ri dhe metodologjinë për zhvillimin e negociatave për aderim të përcaktuar në kuadrin negociues të BE-së, negociatat me shtetet candidate më parë do të hapen në Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore) dhe Kapitullin 24 (Drejtsia, liria dhe siguria) dhe përparimi në të gjitha fushat e tjera negociuese do të varet nga këta dy kapituj. Gjithashtu, duke marrë parasysh fushën e politikave dhe reformave, që janë përfshirë në këta dy kapituj, rekomandimet e përcaktuara në kuadër të raportit për skringing dhe të konfirmuara në rezultatin e skringingut, ato do të përcaktohen në kuadër të planeve të veçanta të veprimit, të cilat shteti kandidat duhet t'i hartojë, në bashkëpunim me KE-në.

3.1.3. Plani i veprimit

Planet e veprimit për kapitullin e dhënë, në pajtim me qasje të re në negociata përfaqësojnë një lloj të hartës së rrugës për shtetin kandidat për plotësimin e rekomandimeve të përcaktuara në kuadër të raportit për skringing. Shteti kandidat në kuadër të planit të veprimit duhet patjetër t'i përkufizojë masat që çojnë kah realizimi i rekomandimeve lidhur me reformat legjislative, përparimin e kapaciteteve administrative, zbatimin e politikave reformuese dhe rezultateve të saja, organet përgjegjëse dhe kuadrin kohor.

Çdo prej rekomandimeve të cituara duhet të jetë e caktuar ashtu që në të të përcaktohen:

- 1) masa;**
- 2) organi kompetent për zbatimin e saj;**
- 3) afati i plotësimit të masës së cituar;**
- 4) mjetet financiare të nevojshme për realizimin e saj;**
- 5) treguesi i rezultateve;**
- 6) treguesi i ndikimit.**

Plani i veprimit është dokument i cili të gjitha palëve të interesuara të përfshira në procesin e negociatave për aderim ose të ndjekjes së negociatave për aderim duhet të shërbejë së „udhëzues“ për realizimin e rekomandimeve që i ka përkufizuar BE-ja. Nga rëndësia e madhe është që ky dokument, si edhe të gjitha dokumentet e krijuara në kuadër të procesit negociues, të jetë publik me qëllim që rezultatet e procesit mund të ndiqen edhe që të gjitha kapacitetet ekzistuese, në sektorin shtetëror ose civil, mund të jenë të përdorura për plotësimin e masave të propozuara për realizimin e rekomandimeve.

Dokumenti i përcaktuar ashtu palëve të interesuara që ndjekin procesin e negociatave ua jep mundësinë që të kenë qasje në punën e organeve kompetente të detyruara për zbatimin e masave të cituara për plotësimin e rekomandimeve, në kuadër të afatit të përcaktuar kohor, dhe që të ndjekin atë punë. Gjithashtu, dokumenti veçanërisht i jep mundësi OSHC-së që veprimet e vet t'i planifikojë dhe përcaktojë në pajtim me rekomandimet e vendosura dhe masat për plotësimin e tyre.

SHEMBULLI 4: PLANI I VEPRIMIT TË MALIT TË ZI PËR KAPITULLIN 23 (GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE) *

1.4. PROFESIONALIZMI, EKSPERTIZA dhe EFIKASITETI I GJYQËSORIT						
Nr.	Masa/Veprimi	Organi kompetent	Afati	Mjetet e nevojshme/Burimet e financimit	Treguesi i rezultateve	Treguesi i ndikimit
1.4.1. Rekomandimi: Të sigurohet statistika e sigurt dhe konsistente gjyqësore dhe të vendoset sistemi i ndjekjes së kohëzgjatjes së procesit gjyqësor						
1.4.1.1.	Vendosja e statistikës gjyqësore të sigurt dhe konsistente sipas drejtimeve të CEPEJ-it me për statistikën gjyqësore	Ministria e drejtësisë (Branko Lakoçeviq, Natasha Radonjiq), Këshilli gjyqësor (Danko Drashković)	Shtatori 2013 deri më tremujorin e dytë të vitit 2015	Mjetet e rregullta buxhetore 220.000 €	Vendosja e statistikës gjyqësore sipas drejtimeve të CEPEJ-it	Raporti i CPEJ-it; Të dhënat që fitohen me mbështetjen e PRIS-it janë të sigurta dhe konsistente
1.4.1.1.1.	Hartimi i procedurës për procedura, metodologji dhe afate për mbledhjen e të dhënave statistikore në pajtim me drejtimet e CEPEJ-it, drejtimet nga ana e grupit punues, të përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor	Ministria e drejtësisë (Branko Lakoçeviq, Natasha Radonjiq), Këshilli gjyqësor (Danko Drashković)	Shtatori 2013 deri më marsi 2014.	Buxheti	Formuar grupi punues; Përgatitur drafti i rregullave	

* Plani i veprimit të Malit të Zi për Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore), Qeveria e Malit të Zi, 27 qershor 2013, f. 43. Plani i veprimit është i disponueshëm në faqen e internetit <http://www.eu.me/mn/23/23-dokumenti> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

3.1.4. Raporti për realizimin e planit të veprimit

Raportin për realizimin e planit të veprimit për kapitullin në fjalë e harton shteti kandidat dhe kjo në nivelin tremujor ose gjashtëmujor, varësisht nga korniza e vendosur kohore për zbatim të masave. Raporti për realizimin e planit të veprimit e përfaqëson udhëzuesin për realizimin e masave të cituara në kuadrin e parashikuar kohor në pajtim me rezultatet e vendosura.

Raporti për realizimin e planit të veprimit për kapitullin në fjalë përmban masat e njëjta të përcaktuara dhe komponentë si edhe vet plani i veprimit. Duke marrë parasysh në cilën periudhë raportohet, qartë duhet cituar çdo prej rezultateve të arritura dhe treguesve të rezultateve për masën e parashikuar në kuadër të periudhës së përcaktuar kohore, e cila përputhet me kohën e hartimit dhe shpalljes së raportit për realizimin e planit të veprimit.

Hartimi dhe shpallja e raporteve është nga rëndësia e madhe për të gjitha palët e përfshira në procesin e udhëheqjes së negociatave për aderim në kapitullin e caktuar negociues, edhe për të gjitha anët e interesuara, që pranë veprimeve të veta të rregullta të ndjekjes së procesit të negociatave të aderimit dhe plotësimit të masave për realizimin e rekomandimeve të cituara, mund të krijojnë një imazh të qartë për atë çfarë kanë bërë organet shtetërore kompetente për plotësimin e masës së caktuar në kuadër të planit të veprimit në afatin e parashikuar kohor. Hartimi dhe shpallja e raportit në nivelin tremujor ose gjashtëmujor u lehtëson të gjitha palëve të përfshira në proces që t'i marrin drejtimet më të qarta për plotësimin e hapave që çojnë kah mbyllja e negociatave në këtë kapitull negociues.

3.2. Faza përmbajtëse e negociatave

Pozitën negociuese e përgatis shteti kandidat për anëtarësim në BE-në pasi që Këshilli, pas rekomandimit të KE-së, konfirmon që janë plotësuar kriteret për hapjen e negociatave, d.m.th. që në planet e veprimit për plotësimin e rekomandimeve nga raporti për skringing për kapitullin e caktuar janë parashikuar të gjitha masat e përshtatshme dhe afatet, dhe fton shtetin kandidat që të dorëzojë pozitën e vet negociuese për kapitullin e caktuar.

Pozita negociuese përgatitet dhe miratohet në pajtim me procedurat dhe standardet e përcaktuara në shtetin kandidat për anëtarësim. Pasi që është miratuar, ajo u dorëzohet KE-së dhe Këshillit dhe për atë diskutohet në KNQ-në në të cilën zhvillohen edhe negociatat mbi kapitullin e dhënë.

SHEMBULLI 5: PLANI I VEPRIMIT TË MALIT TË ZI PËR KAPITULLIN 23 (GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE) – RAPORTI NR. 5*

1.4. PROFESIONALIZAMI, EKSPERTIZA DHE EFIKASITETI TË GJYQËSORIT MP – Tijana Badnjar

1.4.1. Rekomandimi: Të sigurohet statistika gjyqësore e sigurt dhe konsistente dhe të vendoset sistemi i ndjekjes së kohëzgjatjes së procesit gjyqësor

Nr.	Masat/Veprimi	Organi kompetent	Afati/ Statusi	Treguesi i rezultateve	Treguesi i ndikimit
1.4.1.1.1	<p>Hartimi i rregullave për procedura, metoda dhe afate për mbledhjen e të dhënave statistikore në pajtim me drejtimit e CEPEJ-it nga ana e grupit punues të përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor.</p> <p>(1) 31. XII 2013 [RK]</p> <p>(2) 31. III 2014 [NR] Ministria e drejtësisë në bashkëpunim me IMG-në në kuadër të projektit „Përforcimi i drejtësisë në Malin e Zi“, ka siguruar mbështetjen profesionale në ndërtimin e kapaciteteve e Ministrisë së Drejtësisë në pikëpamje të përdorimit të raporteve statistikore dhe analitikës së tyre.</p>	MD	Shtatori 2013 deri më tremujorin e dytë 2015	<p>Formuar grupi punues;</p> <p>(1) 31. XII 2013 (2) 31. III 2014 [NR] (3) 30. VI 2014 [R]</p> <p>Me qëllimin e realizimit të projektit „Përforcimi i gjyqësorit në Malin e Zi“, i cili është përkrahur nga ana e IMG-së, janë përcaktuar punonjësit i Ministrisë së Drejtësisë dhe Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor që kanë marrë pjesë në këtë projekt, kanë bashkëpunuar me ekspertë të angazhuar dhe kanë kaluar trajnimin për përdorimin e Modelit për analizën e sistemit gjyqësor në pajtim me drejtimit e CEPEJ-it.</p> <p>(4) 30. IX 2014 [NR] Vërejtje: Në periudhën e raportimit, Grupi punues nuk është formuar. Përmes projektit EUROL, Ministria e Drejtësisë ka marrë mbështetjen profesionale e cila do të përbëhet nga hartimi i Draftit të Udhëzimeve, të cilin pastaj Grupi Punues prej të cilit formimi pritet në tetor, do ta shqyrtojë dhe përpunojë.</p> <p>(5) 31. XII 2014 [R]</p> <p>Grupi punues është formuar me vendimin e Ministrisë së Drejtësisë. Anëtarët e Grupit Punues janë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor.</p>	Raporti i CPEJ-it; Të dhënat që merren me mbështetjen e PRIS-it janë të sigurta dhe konsistente.

* Plani i veprimit të Malit të Zi për Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore – Raporti nr. 5, Qeveria e Malit të Zi, dhjetori i vitit 2014. f. 69–71. Plani i veprimit është i disponueshëm në faqen interneti: <http://www.eu.me/mn/23/23-dokumenti> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

Nr.	Masat/Veprimi	Organi kompetent	Afati/ Statusi	Treguesi i rezultateve	Treguesi i ndikimit
1.4.1.1.1	<p>Në kuadër të këtij projekti, mes të tjerash, do të hartohet edhe rregullorja për procedura, metoda dhe afate për mbledhjen e të dhënave statistikore në pajtim me drejtimet e CEPEJ-it.</p> <p>(3) 30. VI 2014 [DR] (4) 30. IX 2014 [NR] (5) 31. XII 2014 [DR]</p>			<p>Përgatitur Drafti i rregullave (1) 31. XII 2013 [RK] Punonjësit e Degës për IKT-në dhe multimedia kanë filluar analizën paraprake me qëllim që në mënyrë më efektive të realizohen këto masa.</p> <p>(2) 31. III 2014 (3) 30. VI 2014 [DR] Përmes projektit të Ministrisë së Drejtësisë dhe IMG-së „Përforcimi i Gjyqësorit në Malin e Zi“, janë angazhuar ekspertët të cilët së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë dhe Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor kanë punuar mbi lidhjen këtyre dy institucioneve me qëllim që t’i mundësohen Ministrisë së Drejtësisë lidhjet e drejtpërdrejta me të dhënat nga PRIS-i. Kështu Ministrisë së Drejtësisë në kuadër të këtij projekti i është mundësuar lidhja e drejtpërdrejt me pjesën e të dhënave nga PRIS-i, që janë të nevojshme për analizën sipas drejtimeve të CEPEJ-it. Gjithashu, në bazë të dhënave të marra, ekspertet kanë hartuar Modelin Analitik, i cili u mundëson zyrtarëve të Ministrisë së Drejtësisë që të ndjekin punën e gjykatave sipas tre treguesve të CEPEJ-it: clearance rate, disposition time i efficiency rate. Modeli në periudhën e mëtejshme do të jetë i përmirësuar, kurse në bazë të punës së deritanishme Sekretariati i Këshillit Gjyqësor do të hartojë rregullat për procedura, metoda dhe afate për mbledhjen e të dhënave statistikore në pajtim me drejtimet e CEPEJ-it.</p> <p>(4) 30. IX 2014 [NR] (5) 31. XII 2014 [R] Me mbështetjen e eksperteve të angazhuar përmes projektit „Mbështetja sundimit të ligjit“ (EU RoL), Grupi punues ka përgatitur Draftin e Udhëzimeve për hartimin e raporteve statistikore për punën e gjykatave në pajtim me drejtimet e Komisionit Evropian për efikasitetin e gjyqësorit. (CEPEJ).</p>	

3.2.1. Pozita negociuese e shtetit kandidat

Dokumenti në të cilin përcaktohet pozita negociuese e shtetit kandidat përbëhet nga pjesët e mëtejshme, që janë:

- 1) pjesa hyrëse;
- 2) kuadri legjislativ dhe institucional;
- 3) harmonizimi i kuadrit legjislativ e institucional me trashëgiminë juridike të BE-së.

STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E POZITËS NEGOCIUESE

1) PJESA HYRËSE:

- përmbledhja e pozitës negociuese;
- kërkesat për afatet kalimtare;
- situata në lidhje me kapitullin konkret në kohën e përgatitjes së pozitës negociuese;
- niveli i përshtatshmërisë me trashëgiminë juridike të BE-së;
- vlerësimi i kapaciteteve institucionale për zbatimin e rregullave të harmonizuara.

2) SHPEJGIMI:

- në të cilin citohet përshkrimi i detajuar në lidhje me kapitullin konkret dhe rregullat ekzistuese dhe jepet përmbledhja e shkurtër e procesit të harmonizimit me trashëgiminë juridike të BE-së;
- në të cilin citohet shpjegimi i detajuar për çdo kërkesë të bërë për afatet kalimtare ose përjashtime (derogimet);
- në të cilin përcaktohet kuadri institucional për zbatimin e rregullave të përputhura.

3) SHTOJCAT:

- oraret kohore, analizat, informacionet plotësuese etj. (nëse nevojitet).

Afatet kalimtare të cilat i kërkoj shteti për zbatimin e plotë të trashëgimisë juridike pas datës së parashikuar të aderimit duhet të jenë të përcaktuara qartë në pikëpamje të qëllimeve dhe kohës; kërkesat duhet të jenë të parashtruara në mënyrë bindëse dhe me argumente të mira, mund t'i kërkoj edhe BE-ja.

Përjashtimet (derogimet) i kërkon shteti kandidat në pikëpamje të zbatimit të rregullës së caktuar të BE-së ose të ndonjë pjese të rregullës –miratohen vetëm në raste të veçanta.

Përshtatjet teknike me trashëgiminë juridike të BE-së i kërkon shteti kandidat në ato fusha në të cilat shteti mund ta sjellë „vlerën plotësuese “ për trashëgiminë juridike të BE-së.

Shpjegimet plotësuese jepen mbi kërkesën e organeve të BE-së, kurse përmbajnë të gjitha informacionet plotësuese në lidhje me dorëzimin e pozitave negociuese dhe përgatiten në formë të shkruar.

Pranë pozitës negociuese bashkëngjitet edhe plani i veprimit për implementimin dhe miratimin e trashëgimisë juridike në kapitullin negociues.

Në pjesën hyrëse të përmbledhjes së pozitës negociuese shteti kandidat për anëtarësim deklarohet për pranimin e trashëgimisë juridike të BE-së në kapitullin e caktuar dhe citon a në atë kapitull do të kërkojë afatet plotësuese kalimtare për përputhshmërinë me trashëgiminë juridike ose përjashtimet nga zbatimi i saj.

Në pjesën që ka të bëjë me kuadrin legjislativ e institucional shteti kandidat përcakton dhe citon kuadrin ligjor i cili e përkufizon fushën specifike të politikës, si edhe shqyrtimin e gjendjes dhe funksionimit të kuadrit politik në pjesën e politikave që janë përfshirë me kapitullin negociues në fjalë.

Pjesa e fundit të pozitës negociuese e cila ka të bëjë me përshtatshmërinë e kuadrit legjislativ e institucional me trashëgiminë juridike të BE-së ka të bëjë me vlerësimin e shtetit kandidat për anëtarësim në të cilën masë është përshtatur legjislacioni në kapitull të caktuar dhe cilat masa do të realizohen në periudhën e ardhshme për ta përputhur legjislacionin krejtësisht.

SHEMBULLI 7:

POZITA NEGOCIUESE E MALIT TË ZI PËR KAPITULLIN 23 (GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE)

III PËRPUTHSHMËRIA E KUADRIT LEGJISLATIV DHE INSTITUCIONAL ME TRASHËGIMINË JURIDIKE TË BE-së

1. GJYQËSORI

1.4. Profesionalizmi, ekspertiza, dhe efikasiteti në gjyqësor

„...Përforcimi i efikasitetit të drejtësisë është një nga qëllimet e Strategjisë së re të reformës së gjyqësorit 2013-2018, kurse fushat kryesore të veprimit do të jenë në lidhje me racionalizimin e rrjetit gjyqësor; zgjidhjen e çështjeve të mbetura përmes përcaktimit të rregullave dhe miratimit të programeve vjetore dhe raportimit të rregullt për zgjidhjen e çështjeve të mbetura në nivelin e të gjitha gjykatave, si edhe përmes informimit vullnetar të gjyqtarëve, delegimit të çështjeve, përparimit dhe kontrollimit të punës së shërbimit të ofrimit dhe kryerjes së ndjekjes së punës, mënyrave alternative të zgjidhjes së kontesteve, përmirësimit të menaxhimit gjyqësor dhe të administratës, përmirësimit të mënyrave alternative të zgjidhjes së kontesteve përmes zbatimit të institutit të ndërmjetësimit, ujdisë gjyqësore dhe arbitrazhit dhe zhvillimit të trupave të tjera gjyqësore (avokate, noterë, ekzekutues gjyqësorë, ekspertë gjyqësorë, përkthyes gjyqësorë).“

Pozita negociuese e Malit të Zi për Kapitullin 23, (Gjyqësori dhe të drejtat themelore), f. 41⁹

9. Pozita negociuese e Malit të Zi për konferencën ndërqeveritare për aderimin e Malit të Zi në Bashkim Evropian për Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore, tetor 2013, f. 41. Pozita negociuese është në dispozicion në faqen e internetit: <http://www.eu.me/mn/23/23-dokumenti> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

3.2.2. Pozita e përbashkët e Bashkimit Evropian (ang. EU Common Position)

Pozitën e përbashkët negociuese e përgatis KE-ja, kurse e miraton Këshilli dhe ajo është përfaqësuar në KNQ-në në të cilën zhvillohen negociatat për kapitullin e caktuar. Në pozitën e përbashkët negociuese BE-ja mund të konstatojë që shteti kandidat në kapitullin e caktuar ka arritur nivelin e mjaftueshëm dhe të nevojshëm të përshtatshmërisë me trashëgiminë juridike të BE-së dhe negociatat për këtë kapitull do të mbyllen përkohësisht.

Nëse BE-ja konstaton që nuk është arritur niveli i mjaftueshëm i përshtatshmërisë, do të përcaktohen kriteret për mbylljen e kapitullit, të cilat shteti kandidat duhet t'i plotësojë me qëllim që negociatat në atë kapitull të mbyllen përkohësisht.

Dokumenti me të cilin përcaktohet pozitat e përbashkët e BE-së për një kapitull të caktuar përbëhet nga:

- 1) pjesa hyrëse
- 2) rekomandimet e mëtejshme për përshtatshmëri me trashëgiminë juridike nëpër fusha në kapitull të caktuar në bazë të qëndrimeve të dhëna në pozitën negociuese të shtetit kandidat për anëtarësim.

Në pjesën hyrëse të pozitës së përbashkët negociuese BE-ja mbështetet mbi kuadrin negociues i cili i është përfaqësuar shtetit kandidat për anëtarësim në KNQ-në e parë dhe mbi parimet e përmbajtura në të dhe thekson detyrën të cilën shteti ka ndërmarrë kur ka qenë e detyruar për pranimin e trashëgimisë juridike të BE-së në kapitullin e caktuar negociues.

Pjesa përmbajtëse e pozitës së përbashkët të BE-së ka të bëjë me setin e rekomandimeve dhe hapave të cilët BE-ja do t'i ndërmarrë në periudhën e ardhshme me qëllim që shteti kandidat të vazhdojë procesin e përputhshmërisë me trashëgiminë juridike në fushën e caktuar të politikës në mënyrë në të cilën këtë e ka prezantuar në pozitën negociuese.

SHEMBULLI 8: **POZITA NEGOCIUESE E BASHKIMIT EVROPIAN PËR KAPITULLIN 23 (GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE) PËR MAL TË ZI**

GJYQËSORI: Profesionalizmi, ekspertiza, dhe efikasiteti

„BE-ja ndjek informacionet për profesionalizëm, ekspertizë, dhe efikasitet, veçanërisht për masat që kanë të bëjnë me zhvillimin e statistikës gjyqësore dhe treguesit të efektit, për planet e Malit të Zi që kanë të bëjnë me racionalizimin e mëtejshëm të rrjetit gjyqësor, masat për përparimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, futjen e sistemit nxitës të lëvizshmërisë vullnetare/transferimit të gjyqtarëve dhe përkushtimin e Malit

të Zi për zvogëlimin plotësues të çështjeve të mbetura gjyqësore. BE-ja thekson rëndësinë e zvogëlimit të mëtejshëm të numrit të çështjeve të mbetura si hap kyç për efikasitetin më të madh të gjyqësorit malazez. Në atë pikëpamje, BE-së thekson nevojën e ekzaminimit të mëtejshëm dhe nxitimit të përdorimit të mesave alternative, siç janë ndërmjetësim, ujdj gjyqësorë, arbitrazh. BE-ja fton Malin e Zi që të sigurojë përparimin e prekshëm në sigurimin e koherencës në pikëpamje të mbikëqyrjes dhe ekzekutimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, mes të tjerash me ndërmjetësimin e ekzekutuesve gjyqësorë – për t'i kontribuar përparimit të sigurisë juridike.”

Pozita e përbashkët e Bashkimit Evropian për kapitullin negociues 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore), f. 5¹⁰

3.2.3. Raporti për plotësimin e detyrimeve për kapitullin negociues

Raportin për plotësimin e detyrimeve për kapitullin negociues e përgatis shteti kandidat për anëtarësim dhe ai përfshin periudhën nga hapja formale e negociatave në kapitullin e dhënë deri te mbyllja e përkohshme e kapitullit.

Raporti përmban shqyrtimin e masave të miratuara dhe veprimeve të zbatuara nëpër fusha të politikës për shkak të miratimit të trashëgimisë juridike në kapitullin e caktuar dhe shqyrtimin e kapaciteteve administrative dhe institucionale për zbatimin e detyrimeve të ndërmarra.

10. GENERAL EU POSITION, Ministerial meeting opening the Intergovernmental Conference on the Accession of Montenegro to the European Union, Brussels, 29 June 2012, <http://bit.ly/1TvsNbn>. Përkthimi i Pozitës së përbashkët është i disponueshëm në faqen e internetit: <http://www.eu.me/mn/23/23-dokument> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.) f. 5.

IV

NDJEKJA E NEGOCIATAVE ADERUESE ME BASHKIMIN EVROPIAN

Në këtë pjesë Udhëzuesi ofron një vështrim në atë sesi shoqëria civile dhe anët e tjera të interesuara mund në mënyrë konkrete të ndjekin negociatat aderuese dhe t'i kontribuojnë këtij procesi. Për shoqërinë civile në shtete kandidatë dhe të gjitha anët e tjera të interesuara që nuk janë drejtpërdrejt të përfshira në procesin e negociatave për aderim në BE-në është nga rëndësia e madhe që të kuptojnë rëndësinë e negociatave aderuese, dhe që duke marrë parasysh kapacitetet që i disponojnë, të japin kontribut konkret dhe të ndjekin vazhdimisht zhvillimin e negociatave, si edhe që ta bëjnë procesin sa më cilësor në mënyrë më efektive. Pjesëmarrja në negociata dhe ndjekja e negociatave aderuese nënkupton kuptimin e kuadrit institucional dhe udhëheqës brenda të cilit kryhen negociatat, e mënyrës sesi zhvillohen negociatat, e përmbajtjes së procesit negociues dhe instrumenteve të disponueshme me të cilat shoqëria civile dhe palët e tjera të interesuara mund të ndikojnë mbi atë proces.

Suksesi i integrimi evropian qëndron mbi atë që shoqëria civile dhe palët e tjera të interesuara të veprojnë jo si aktorë pasivë, por si partnerë aktivë që e përparojnë cilësinë e negociatave dhe ndikojnë mbi rezultatin e tyre përfundimtar. Përfshirja e procesit siguron zbatimin e plotë të trashëgimisë juridike të BE-së në shtetin kandidat dhe realizimin e qëllimeve të politikave publike të BE-së që do të bazohen mbi mundësitë reale dhe periudhat objektive kohore për arritjen e tyre, angazhimin e burimeve të kufizuara me respektimin e intereseve dhe nevojave e të gjithë aktorëve.

4.1. Matrica për ndjekjen e negociatave për aderim në Bashkimin Evropian

Matrica për ndjekjen e negociatave për aderim në BE-në në kuadër të këtij Udhëzuesi është krijuar si përgjigje mbi nevojë për përforcimin e kapaciteteve të shoqërisë civile për pjesëmarrje në procesin dhe ndjekjen e procesit negociues. Në ambientin dinamik në të cilin zhvillohen negociatat aderuese, ku vendimet shpesh merren në afate të shkurtra kohore, kurse vet procesi është shënuar me një numër të madh të informacioneve që shkëmbehen shumë shpejtë, si edhe me dokumentet që krijohen për nevoja të ndryshme, si edhe rezultat të negociatave, veprimi i përshtatshëm është nga rëndësia thelbësore për ndikim efektiv mbi përparimin e cilësisë së procesit negociues. Matrica përfaqëson kuadrin e dobishëm për shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të interesuara për ndjekjen e procesit të negociatave për aderimin e shteteve kandidatë në BE-në sepse përmban elementet e mëtejshme:

1) **Hapat në procesin e negociatave aderuese** – Varësisht nga asaj a ekzistojnë kriteret për hapjen e negociatave, për mbylljen e negociatave, kriteret kalimtare, janë të mundur procedurat e ndryshme të zhvillimit të negociatave në çdo kapitull. Për nevojat e Udhëzuesit është përfaqësuar një nga skenarët e ndërlikuar në procesin e negociatave aderuese d.m.th. rasti në të cilin para shtetit kandidat do të përfaqësohen kriteret për hapjen e kapitullit negociues dhe kriteret për mbylljen e kapitullit konkret negociues. Ky nuk do të jetë rast në të gjithë kapitujt negociues. (Mos)ekzistimi i këtyre kriterëve do të varet nga cilë-

sia e reformave që shteti kandidat i zbaton në fushat e politikave publike që janë përfshirë në kapitullin e caktuar negociues dhe kapacitetet ekzistuese të shtetit kandidat për t'i realizuar qëllimet të politikave publike të BE-së dhe për ta zbatuar në praktikë trashëgiminë e BE-së.

Përshkrimin e detajuar të hapave në kuadër të pesë skenarëve të mundshëm të zhvillimit të negociatave e shihni në Shtojcën 1 (Zhvillimi i negociatave – Pesë skenarë të mundshëm).

2) **Kontributi konkret në procesin negociues** – ÇFARË përfaqëson kontributi konkret për procesin negociues? Këtu mendohet për kontributin përmbajtës të shoqërisë civile dhe të palëve të tjera të interesuara në: a) zbatimin e fazave konkrete të procesit negociues (p.sh. shtojcat për përpilimin e planit të veprimit, pozitat negociuese etj.); b) ndjekjen e zbatimit të masave të përcaktuara dhe raportimin për atë (p.sh. analizat, raportet, studimet e politikës praktike, shqyrtimet e gjendjes etj.); dhe c) informimin e publikut të interesuar dhe qytetarëve për përmbajtjen dhe procesin e negociatave si edhe për sfida kyçe dhe rezultatet e procesit negociues.

3) **Mënyra e komunikimit** – SESI kontributi për procesin negociues formulohet dhe sesi komunikohet me palët e interesuara në procesin negociues? Këtu mendohet për INSTRUMENTET e komunikimit dhe KANALET e komunikimit. Këtu nën instrumentet e komunikimit nënkuptohen të gjitha llojet e dokumenteve analitike, praktiko-politike dhe „përkrahëse“ me të cilat sigurohet që argumentet dhe zgjidhjet e shoqërisë civile dhe anëve të tjera të interesuara të bëhen pjesë përbërëse e procesit të vendimmarrjes në kuadër të çdo faze në negociatat aderuese, por edhe të gjitha llojet e përmbajtjeve që shërbejnë për informimin e publikut dhe qytetarëve për procesin e negociatave. Kanalet e komunikimit kanë të bëjnë me atë në cilën mënyrë shoqëria civile dhe të gjitha palët e interesuara vijnë deri tek informacionet gjatë procesit të negociatave (p.sh. takime, shkresa, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.) dhe si informacionet i transferojnë më tej (media, ngjarje, rrjete sociale etj.).

4) **Kuadri institucional** – KUJT i drejtohem? Çdo prej hapave në procesin e negociatave aderuese nënkupton nivelin e ndryshëm dhe cilësinë e përfshirjes së numrit të madh të institucioneve dhe aktorëve. Njohja e institucioneve dhe aktorëve, të cilët janë kyçe për disa faza të negociatave aderuese, mundëson ndikim mbi zhvillimin dhe rezultatet e negociatave, si edhe mbi angazhimin efikas të shoqërisë civile dhe palëve të tjerë të interesuara në këtë proces.

Nr.	HAPI NË PROCESIN E NEGOCIATAVE ADERUESE	KONTRIBUTI KONKRET (ÇKA?)	MËNYRA E KOMUNIKIMIT (SI?)		KUADRI INSTITUCIONAL (KUJT?)
			INSTRUMENTET E KOMUNIKIMIT	KANALET E KOMUNIKIMIT	
1.	Skringu shpjegues (ang. Explanatory Screening)	<ul style="list-style-type: none"> - Njohja me qëllimet e politikave publike të BE-së dhe trashëgimisë juridike të BE-së për kapitullin negociues në fjalë - Ndjekja e takimit të skriningut shpjegues, kërkimi i shpjegimeve informacioneve plotësuese - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut 	<ul style="list-style-type: none"> - Metodologjia për transferimin e dijënisë dhe informacioneve, prezantimet, tekstet për përmbajtjen e politikave të BE-së dhe trashëgimitë juridike të BE-së e etj. - Mbledhja e informacioneve relevante nga përfaqësuesit e organeve të autoritetit publik që janë kompetente për një kapitull të caktuar negociues - Mbledhja e informacioneve relevante përmes mediave, faqeve të interneti, ueb portave dhe listave të e-mail-it - Vështrimi i gjendjes (Factsheet) - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj. - Formimi i koalicioneve/rrjeteve/ OSHC-së platformave dhe lëvizja e iniciativave 	<ul style="list-style-type: none"> - Veprimet arsimore (ligjëratat, trajnimet, seminarat, punëtorët etj.) - Takimet, letrat, mail-et, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.) - Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) - Koalicionet/rrjetet/ platformat OSHC 	<ul style="list-style-type: none"> - Komisioni Evropian - Institucionet/organet/trupat brenda strukturës për udhëheqjen e negociatave për aderim në BE-në - Ministria përkatëse - Institucioni/organi/trupi për bashkëpunim me shoqërinë civile - Organizatat ndërkombëtare joqeveritare



2.	Skriningu bilateral (ang. Bilateral Screening)	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i shqyrtimit të gjendjes për nivelin e përshtatshmërisë së politikave publike dhe të sistemit juridik me politikat publike dhe trashëgiminë juridike të BE-së për kapitullin negociues në fjalë - Përgjigjet mbi pyetjet plotësuese të KE-së pas skringut bilateral të mbajtur - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut 	<ul style="list-style-type: none"> - Raportet alternative për shkallën e përshtatshmërisë - Studimet, analizat e efektit të zbatimit të rregullave juridike dhe vlerësimet e kapaciteteve etj. - Vështrimi i gjendjes (Factsheet) - Shtojcat për raportin vjetor të KE-së për përparimin e Serbisë në procesin e integrimi me BE-në - Raporti për nivelin e plotësimit të planeve të veprimit/strategjive/planeve për përshtatje me trashëgiminë juridike të BE-së - Mbledhja e informacioneve relevante nga përfaqësuesit e organeve të autoritetit publik që janë kompetente për kapitullin e caktuar negociues - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj. - Formimi i koalicioneve/rreteve/OSHC-së platformave dhe lëvizja e iniciativave 	<ul style="list-style-type: none"> - Takimet, letrat, email, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.) - Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) - Koalicionet/rrjetet/platformat OSHC - Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet 	<ul style="list-style-type: none"> - Këshilli i BE-së - Komisioni Evropian - Këshilli i BE-së - Përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare në Bruksel - Shtetet anëtare të BE-së - Organizatat ndërkombëtare joqeveritare - Misioni i shtetit kandidat pranë BE-së - Institucionet/organet/trupat brenda strukturës për udhëheqjen e negociatave për aderim në BE-në - Ministria përkatëse - Institucioni/organi/trupi për bashkëpunim me shoqërinë civile
----	--	--	---	---	---



<p>3. KE-ja përgatis raportin për skringing (ang. Screening Report) dhe i propozon Këshillit Kriteret për hapjen e negociatave (ang. Opening benchmarks)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i shkallës së përshtatshmërisë së politikave publike dhe sistemit juridik me politikat publike dhe trashëgimisë juridike të BE-së - Shqyrtimi i kapaciteteve të shtetit për realizimin e qëlimeve të politikave publike dhe zbatimin e trashëgimisë juridike të BE-së - Propozimi i kriterëve alternative për hapjen e kapitujve (nëse kjo nevojitet) <ul style="list-style-type: none"> - „Input-e” për ekipet e ekspertëve të KE-së që vijnë për vizitë gjatë përgatitjes së Raportit për skringing për kapitullin e dhënë. - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut 	<ul style="list-style-type: none"> - Raportet alternative për shkallën e përshtatshmërisë - Vështrimi i gjendjes (Factsheet) - Studimet, analizat e efektit të zbatimit të rregullave juridike dhe vlerësimet e kapaciteteve etj. - Letrat e pozitiës (Position papers) për nivelin e përshtatshmërisë së politikave publike dhe mundësi reale për zbatimin e trashëgimisë juridike të BE-së - Mbledhja e informacioneve relevante nga përfaqësuesit e organeve të autoritetit publik që janë kompetente për një kapitull të caktuar negociues - Mbledhja e informacioneve relevante përmes mediave, faqeve të internetit, ueb portaleve dhe listave të email-it - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj. - Formimi i koalicioneve/rrejtëve/ OSHC-së - Platformave dhe lëvizja e iniciativave 	<ul style="list-style-type: none"> - Takimet, letrat, email, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.) - Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) - Koalicionet/rrjetet/ platformat OSHC - Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet 	<ul style="list-style-type: none"> - Komisioni Evropian - Këshilli i BE-së - Parlamenti Evropian - Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social - Komiteti i rajonit - Përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare në Bruksel - Shtetet anëtare të BE-së - Organizatat ndërkombëtare joqeveritare - Misioni i shtetit kandidat pranë BE-së
--	--	---	--	--



4.	<p>Këshilli i BE-së e pranon raportin për skringing dhe kriteret për hapjen e kapitullit dhe e fton shtetin kandidat që t'i plotësojë</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Komunikimi me Këshillin e BE-së – trupat profesionale të Këshillit dhe përfaqësitë e përherëshme të shteteve anëtare të BE-së për shkallën e përshatshmërisë së politikave publike me politikat publike dhe trashëgiminë juridike të BE-së në kapitullin konkret negocies - Komunikimi i përherëshëm me përfaqësuesit e shteteve anëtare të BE-së (ministri përkatës dhe përfaqësitë diplomatike në shtetin kandidat) - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut 	<ul style="list-style-type: none"> - Raportet alternative për shkallën e përshatshmërisë - Vështrimi i gjendjes (Fact-sheet) - Studimet, analizat e efektit të zbatimit të rregullave juridike dhe vlerësimet e kapaciteteve etj. - Letrat e pozitës (Position papers) për nivelin e përshatshmërisë së politikave publike dhe mundësi reale për zbatimin e trashëgimisë juridike të BE-së - Mbledhja e informacioneve relevante nga përfaqësuesit e organeve të autoritetit publik që janë kompetente për një kapitull të caktuar negocies - Mbledhja e informacioneve relevante përmes mediaeve, faqeve të interneti, ueb portave dhe listave të email-it - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - Takimet, letrat, email, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.) - Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) -Koalicione/rrjetet/platformat OSHC - Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet 	<ul style="list-style-type: none"> - Trupi punues i Këshillit të BE-së për zgjerim dhe shtete që udhëheqin negociatat për aderim - COELA - Përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare në Bruksel - Përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare të BE-së në shtetin kandidat
----	---	---	--	---	---



5.	<p>Shteti kandidat ndërmerr hapa të përshkueshëm për plotësimin e kritereve për hapjen e negociatave</p>	<p>- Plotësimet, drejtimet, komentet për përmbushjen e kritereve për hapjen e kapitullit negociues</p> <p>- Hartimi i planit alternativ për plotësimin e kritereve për hapjen e kapitullit negociues</p> <p>- propozimi dhe përkrahja e hapave konkretë dhe veprimeve për përmbushje e kritereve</p> <p>- Ndjekja e zbatimit të kritereve për hapjen e kapitullit negociues</p> <p>- Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut</p>	<p>- Plani alternativ për plotësimin e kritereve për hapjen e kapitullit negociues</p> <p>- Analiza e efektit të masave të propozuara dhe veprimeve që janë zbatuar (p.sh. kapacitetet e organeve kompetente, afatet për plotësimin e tyre, burimet e propozuara financiare dhe cilësia e treguesve të vendosur të realizimit të masave)</p> <p>- Raporti për zbatimin e planit për plotësimin e kritereve për hapjen e kapitullit negociues</p> <p>- Komunikimi me përfaqësuesit e organeve të pushtetit publik që janë kompetente për kapitulimin e caktuar negociues</p> <p>- Mbledhja e informacioneve relevante përmes mediave, faqeve të internetit, ueb portaleve dhe listave të email-it</p> <p>- Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj.</p> <p>- Formimi i koalicioneve/ rrjeteve/ OSHC-së platformave dhe lëvizja e iniciativave</p>	<p>- Takimet, letrat, email, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.)</p> <p>- Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike</p> <p>- Mediat (shtyp, radio e televizion)</p> <p>- Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.)</p> <p>-Koalicionet/rrjetet/platformat OSHC</p> <p>- Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet</p>	<p>Komisioni Evropian</p> <p>- Institucionet/organet/trupat brenda strukturës për udhëheqjen e negociatave për aderim në BE-në</p> <p>- Ministria përkatëse</p> <p>- Institucioni/organi/trupi për bashkëpunim me shoqërinë civile</p> <p>- Trupat relevantë qeveritarë dhe agjenci</p> <p>- Oda ekonomike</p> <p>- Bordi për integrimet evropiane dhe/ose bordet përkatëse të parlamentit/trupit përfaqësues të shtetit kandidat</p>
----	--	--	---	---	---



<p>6. KE-ja mbikëqyr edhe, kur shteti kandidat i ka plotësuar kriteret, harton raportin për vlerësimin e plotësimit të kriterëve (ang. Opening Benchmark Assessment Report – OBAR) dhe ia dorëzon Këshillit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi i zbatimit të kriterëve për plotësimin e kriterëve për hapjen e kapitullit negociues - Shtojcat për Raportin e KE-së për plotësimin e kriterëve për hapjen e kapitullit negociues - Hartimi i raportit alternativ për plotësimin e kriterëve për hapjen e kapitullit negociues - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut 	<ul style="list-style-type: none"> - Raporti alternativ për plotësimin e kriterëve për hapjen e kapitullit negociues - Analiza e efektit të masave të propozuara dhe veprimeve që janë zbatuar (p.sh. kapacitetet e organeve kompetente, afatet për plotësimin e tyre, burimet e propozuara financiare dhe cilësia e treguesve të vendosur të realizimit të masave) - Raporti për zbatimin e planit për plotësimin e kriterëve për hapjen e kapitullit negociues - Shqyrtimi i gjendjes (Factsheet) për rezultatet e arritura në realizimin e masave për hapjen e kapitullit - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj. - Formimi i koalicioneve/rrjeteve/ OSHC-së platformave dhe lëvizja e iniciativave 	<ul style="list-style-type: none"> - Takimet, letrat, email, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.) - Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) -Koalicionet/rrjetet/ platformat OSHC - Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet 	<ul style="list-style-type: none"> - Komisioni Evropian - Trupi punues i Këshillit të BE-së për zgjerim dhe shtete që udhëheqin negociatat për aderim - COELA - Përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare në Bruksel - Përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare të BE-së në shtetin kandidat -Institucionet/organet/trupat brenda strukturës për udhëheqjen e negociatave për aderim në BE-në - Ministrinë përkatëse - Institucioni/organi/trupi për bashkëpunim me shoqërinë civile
---	--	--	---	--



<p>7. Këshilli i BE-së konstaton se kriteret për hapjen e negociatave janë plotësuar dhe kërkon nga shteti kandidat që ta dorëzojë pozitën e vet negociuese.</p>	<p>- Komunikimi me Këshillin e BE-së, me trupat profesionale të Këshillit dhe të përfaqësive të përhershme të shteteve anëtare të BE-së, për shkallën e përshtatshmërisë së politikave publike me politikën publike dhe trashëgiminë juridike të BE-së në kapitull konkret negociues</p> <p>- Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut</p>	<p>- Vlerësimet e plotësimit të kriterëve për hapjen e kapitullit negociues</p> <p>- Shqyrtimi i gjendjes (Factsheet) për rezultatet e arritura në realizimin e masave për hapjen e kapitullit negociuese</p> <p>-Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj.</p>	<p>- Takimet, letrat, email, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.)</p> <p>-Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike</p> <p>- Mediat (shtyp, radio e televizion)</p> <p>- Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.)</p> <p>-Koalicionet/rrjetet/platformat OSHC</p> <p>- Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet</p>	<p>- Komisioni Evropian</p> <p>- Trupi punues i Këshillit të BE-së për zgjerim dhe shtete që udhëheqin negociatat për aderim - COELA</p> <p>- Përfaqësitë diplomatike e shteteve anëtare të BE-së në shtetin kandidat</p> <p>- Delegacioni i BE-së në shtetin kandidat</p>
--	---	---	--	--



<p>8. Shteti kandidat e përgatit dhe dorëzon pozitën negociuese</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kontributi në hartimin e përmbajtjes së pozitës negociuese - Përkrahja i zgjidhjeve, afateve kalimtare të propozuara, përjashtimeve ose përshatjeve teknike të trashëgimive juridike të BE-së - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut 	<ul style="list-style-type: none"> - Shtojcat për hartimin e pozitës negociuese për kapitullin e dhënë - Studimet dhe propozimet e politikave praktike - Shqyrtimi i gjendjes (Factsheet) dhe letrat e pozitës - Mbledhja e informacioneve relevante nga përfaqësuesit e organeve të autoritetit publik që janë kompetente për ka-pitull të caktuar negociues - Informimi përmes mediave, faqeve të interneti, ueb portaleve dhe listave të e-mail-it - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj. - Formimi i koalicioneve/ rrjeteve/ OSHC-së platformave dhe lëvizja e iniciativave 	<ul style="list-style-type: none"> - Takimet, letrat, email, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.) - Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) -Koalicionet/rrjetet/ platformat OSHC - Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet 	<ul style="list-style-type: none"> - Institucionet/organet/trupat brenda strukturës për udhëheqjen e negociatave për aderim në BE-në - Ministritë përkatëse - Institucioni/organi/trupi për bashkëpunim me shoqërinë civile - Oda ekonomike - Bordi për integrimet evropiane dhe/ose bordet e tjera përkatëse të parlamentit/trupit përfaqësues të shtetit kandidat
---	---	---	---	--



9.	<p>KE-ja na bazë të pozitës negociuese të shtetit kandidat e përgatis draftin e pozitës së përbashkët</p> <p>(ang. Draft EU Common Position) dhe propozon kriteret për mbylljen e kapitullit (ang. Closing benchmarks), nëse nevojitet</p>	<p>- Kontributet për KE-në, i cili e përgatit hartimin e pozitës së përbashkët të BE-së për kapitullin e dhënë</p> <p>- Propozimi i kriterëve të nevojshme për mbylljen e kapitullit (nëse nevojitet)</p> <p>- Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut</p>	<p>- Shqyrtimi i gjendjes (Fact-sheet) dhe letrat e pozitës për pozitën negociuese të shtetit kandidat për kapitullin e dhënë</p> <p>- Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj.</p>	<p>- Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike</p> <p>- Mediat (shtyp, radio e televizion)</p> <p>- Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.)</p> <p>-Koalicionet/rrjetet/ platformat OSHC</p> <p>- Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet</p>	<p>- Komisioni Evropian</p> <p>- Këshilli i BE-së</p>
----	--	--	--	---	---



10.	<p>Këshilli i BE-së miraton pozitën e përbashkët të BE-së (ang. EU Common Position) dhe kriteret për mbylljen e kapitullit dhe thirr konferencën ndërqeveritare (ang. Intergovernmental Conference</p>	<p>- Mundësia e kufizuar e kontributeve (përkrahja e ndryshimit të draftit të pozitës negociuese) - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut</p>	<p>- Shqyrtimi i gjendjes (Fact-sheet) dhe letrat e pozitës (Position papers) për pozitën negociuese të shtetit kandidat - Shqyrtimi i gjendjes (Fact-sheet) dhe letrat e pozitës (Position papers) për përm-bajtjen e pozitës së përbashkët të BE-së - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj.</p>	<p>- Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) - Koalicionet/rrjetet/platformat OSHC - Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet</p>	<p>- Komisioni Evropian - Këshilli i BE-së - Parlamenti Evropian - Organizatat ndërkombëtare joqeveritare dhe think-tanks</p>
-----	--	--	---	---	--



<p>11.</p>	<p>Në KNO-në hapet kapitulli dhe konstatohen kriteret për mbylljen</p>	<p>Mundësia e kufizuar e kontributeve (përkrahja e ndryshimit të draftit të pozitës negociuese)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut 	<p>- Shqyrtimi i gjendjes (Fact-sheet) dhe letrat e pozitës (Position papers) për përmbajtjen e pozitës së përbashkët të BE-së dhe pozitën negociuese të shtetit kandidat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj. 	<p>- Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) -Koalicionet/rrjetet/platformat OSHC - Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet 	<p>- Komisioni Evropian</p> <ul style="list-style-type: none"> - Këshilli i BE-së - Parlamenti Evropian - Organizatat ndërkombëtare joqeveritare dhe think-tanks
------------	--	---	---	---	---



<p>12. Negociatat brenda kapitullit të hapur (KNQ-ja dhe konsultime teknike)</p>	<p>- Hartimi i kontributeve gjatë negociatave (p.sh. përkrahja e afateve përfundimtare kalimtare, përjashtimeve ose përshtatjeve teknike të trashëgimisë juridike të BE-së për kapitullin e dhënë)</p> <p>- Raportimi për rrjedhjen e negociatave</p> <p>- Hartimi i raportit për pasojat e zbatimit të afateve konkrete kalimtare, përjashtimeve ose përshtatjeve teknike të trashëgimisë juridike të BE-së për kapitullin e dhënë</p> <p>- Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut</p>	<p>- Studimet dhe propozimet e politikave praktike</p> <p>- Shqyrtimi i gjendjes (Fact-sheet) dhe letrat e pozitës (Position papers)</p> <p>- Mbledhja e informacioneve relevante nga përfaqësuesit e organeve të autoritetit publik që janë kompetente për kapitullin e caktuar negociues</p> <p>- Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj.</p>	<p>- Takimet, letrat, email, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.)</p> <p>- Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike</p> <p>- Mediat (shtyp, radio e televizion)</p> <p>- Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.)</p> <p>-Koalicione/rrjetet/platformat OSHC</p> <p>- Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet</p>	<p>- Institucionet/organat/trupat brenda strukturës për udhëheqjen e negociatave për aderim në BE-në</p> <p>- Ministrinë përkatëse</p> <p>- Institucioni/organi/trupi për bashkëpunim me shoqërinë civile</p> <p>- Oda ekonomike</p> <p>- Bordi për integrimet evropiane të parlamentit ose trupit përfaqësues të shtetit kandidat dhe/ose bordet e tjera përkatëse</p> <p>- Këshilli i BE-së</p> <p>- Komisioni Evropian</p> <p>- Parlamenti Evropian</p> <p>- Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social</p> <p>- Komiteti i rajonit</p> <p>- Shtetet anëtare të BE-së</p> <p>- Përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare në Bruksel</p> <p>- Organizatat ndërkombëtare joqeveritare</p> <p>- Misioni i shtetit kandidat pranë BE-së</p>
--	--	---	--	---



<p>13. Shteti kandidat i ndërmerr hapat e përshtatshëm për plotësimin e masave për mbylljen e kapitullit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kontributi në hartimin e planeve dhe përcaktimin e masave për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit - Hartimi i planit alternativ për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit - Hartimi i raportit alternativ për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut 	<ul style="list-style-type: none"> - Plani alternativ për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit - Analiza e efektit të masave të propozuara dhe veprimëve që janë zbatuar (p.sh. kapacitetet e organeve kompetente, afatet për plotësimin e kriterëve, burimet e propozuara financiare dhe cilësia e treguesve të vendosur të realizimit të masave) - Raporti alternativ për zbatimin e planit për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit - Dokumentet jozyrtare (ang. Non-Paper) për mënyrat për zbatim më efikas të masave të nevojshme për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit - Komunikimi me përfaqësuesit e organeve të autoritetit publik që janë kompetente për kapitullin e caktuar negociues - Informimi përmes mediave, faqeve të internetit, ueb portaleve dhe listave të email-it - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj. - Formimi i koalicioneve/rrijeve/OSHC-së platformave dhe lëvizja e iniciativave 	<ul style="list-style-type: none"> - Takimet, letrat, email, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj.) - Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) -Koalicionet/rrjetet/platformat OSHC - Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet 	<ul style="list-style-type: none"> - Komisioni Evropian - Institucionet/organet/trupat brenda strukturës për udhëheqjen e negociatave për aderim në BE-në - Ministrinë përkatëse - Institucioni/organi/trupi për bashkëpunim me shoqërinë civile - Trupat relevantë dhe agjencitë e Qeverisë - Oda ekonomike - Bordi për integrimet evropiane të parlamentit/trupit përfaqësues të shtetit kandidat dhe/ose bordet përkatëse
--	---	--	--	---



14.	<p>KE-ja ndjek zhvillim edhe kur kriteret për mbylljen të plotësohen, e përgatis raportin për atë dhe ia propozon Këshillit mbylljen e përkohshme të kapitullit</p>	<p>- Monitorimi i zbatimit të planeve dhe masave për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit - Kontributi në hartimin e raportit të KE-së për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit - Hartimi i raportit alternativ për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut</p>	<p>- Raporti alternativ për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit negociues - Analiza e efekteve të masave të propozuara dhe verimet që janë zbatuar - Raporti për zbatimin e planit për plotësimin e kriterëve për mbylljen e kapitullit - Informimi përmes mediave, faqeve të interneti, ueb portaleve dhe listave të e-mail-it - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj. - Shqyrtimi i gjendjes (Fact-sheet) për rezultatet e realizuara në plotësimin e masave për hapjen e kapitullit</p>	<p>- Takimet, letrat, email, kërkesat për qasje në informacione nga rëndësia publike etj. →) - Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) -Koalicionet/rrjetet/platformat OSCH - Konferencat ndërkombëtare dhe ngjarjet</p>	<p>- Komisioni Evropian - Trupi punues i Këshillit të BE-së për zgjerim dhe shtete që udhëheqin negociatat për aderim - COELA - Përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare në Bruksel - Përfaqësitë diplomatike e shteteve anëtare të BE-së në shtetin kandidat - Ministrinë përkatëse - Institucioni/organi/trupi për bashkëpunim me shoqërinë civile</p>
-----	---	---	--	---	--



15.	Këshilli e pranon raportin e KE-së dhe në konferencën e parë të ardhshme ndërqeveritare, mbylll përkohësisht kapitullin	- Mundësia e kufizuar e kontributeve (përkrahja e ndryshimit të draftit të pozitës negociuse) - Informimi dhe lajmërimi i shoqërisë civile, aktorëve të interesuar dhe publikut	- Shqyrtimi i gjendjes (Fact-sheet) dhe letrat e pozitës për rezultatet e procesit negociues në kapitullin e caktuar negociues - Deklarata për media, artikujt e gazetave, blog postimet, infografika etj.	- Konferenca për shtyp, forumet, ngjarjet publike - Mediat (shtyp, radio e televizion) - Rrjetet shoqërore (Facebook, Twitter, Youtube, blogjet.) - Koalicionet/rrjetet/ platformat OSHC	- Këshilli i BE-së - Përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare në Bruksel - Institucionet/organet/ trupat brenda strukturës për udhëheqjen e negociatave për aderim në BE-në - Ministritë përkatëse - Institucioni/organi/ trupit për bashkëpunim me shoqërinë civile
-----	---	--	---	--	---



V

**TRANSPARENCA DHE
QASJA NË DOKUMENTE NË
PROCESIN E NEGOCIATAVE
PËR ADERIM NË BE**

Në këtë pjesë të udhëzuesit shqyrtohet çështja e transparencës së procesit të negociatave për aderim në BE-në, me fokus të veçantë mbi kornizën ligjore për qasje në dokumentet të cilat burojnë nga puna e organeve të BE-së (Parlamentit Evropian, Këshillit Evropian dhe Komisionit Evropian). Synimi i veçantë i këtij kapitulli është që lexuesve t'u mundësojë që të kuptojnë dhe të përdorin instrumentet ligjore për qasje në dokumente në procesin e negociatave për aderim në BE-në.

Transparenca, e cila se pari manifestohet përmes qasjes së lirë në dokumentet e organeve të autoritetit publik dhe informacionet të cilat janë në posedim të këtyre organeve, përfaqëson njërin nga parimet themelore të demokracisë. Qasja e lirë në informacione është e drejta civile dhe trashëgimia e qytetërimit evropian. E drejta për qasjen në dokumentet që janë në posedim të organeve të autoritetit publik rrjedh nga vetë natyra e institucioneve demokratike që u shërbejnë qytetarëve si shërbim.

Sipas rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit Evropian për qasje në dokumentet zyrtare¹¹, kufizimi i së drejtës për qasje në dokumente publike duhet të jetë i përcaktuar qartë me ligj që nevojitet për funksionimin e shoqërisë demokratike. Madje me karakter jo të detyruar, ky dokument përfaqëson një dëshmi të qartë për gamën njerëzore të demokracisë në Evropë, d.m.th. kriterin e qartë për atë cili është kufiri më të ulët nën të cilin nuk mund të kalohet në kufizimin e të drejtave të qasjes në dokumente publike. Prandaj, çdo kufizim i së drejtës së qasjes në informacione duhet të jetë i arsyetuar qartë, kurse arsyet për kufizim, d.m.th. mohimet e të drejtave njerëzore të garantuara, duhet të jenë të arsyetuara në kontekstin e mbrojtjes së interesit të dytë legjitim të parashikuar me ligj.

E drejta e qasjes në informacione është lidhur pandashmërisht me lirinë e mendimit dhe shprehjes si me drejtën themelore njerëzore. Me nenin 10 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore¹² e drejta për lirinë e shprehjes është përcaktuar si liri e mendimit, pranimit dhe transmetimit të lirshëm të informacioneve dhe ideve, pa ndërhyrje të organeve të autoritetit publik duke mos i marrë parasysht kufijtë. Kjo e drejtë mund të jetë e kufizuar në shoqërinë demokratike në interesin e sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, ndalimit të mos punimit ose krimeve, mbrojtjes së shëndetësisë ose moralit, reputacionit ose të drejtës së të tjerëve, ndalimit të zgjerimit të informacioneve të besueshme ose në interesin e ruajtjes së autoritetit dhe gjyqësisë së paanshme. Çdo devijim nga detyrimi i veprimit transparent të organeve të autoritetit publik, duhet të jetë i themeluar në të drejtën, d.m.th. duhet të jetë i përcaktuar më parë me ligj.

11. Council of Europe, Access to Official Documents. Recommendation Rec (2002) 2 adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on February 2002 and explanatory memorandum, <http://bit.ly/1mT2LCi> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.) Për zhvillimin e së drejtës së qasjes në dokumentet publike shih edhe: Hins, Wouter; Voorhoof, Dirk, "Access to State-Held Information as a Fundamental Right under the European Convention on Human Rights", *European Constitutional Law Review*, 3, 2007, pp 114–126, doi:10.1017/S1574019607001149.

12. Konventa për të drejtat themelore http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SRP.pdf (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

Për ta realizuar parimin e respektimit të transparencës nuk është thjesht e mjaftueshme që publikut t'i vihen në dispozicion dokumentet. Transparenca nënkupton që organet e autoritetit publik në mënyrë të parashikueshme t'i kryejnë veprimet e veta të rregullta duke qenë të dukshme për publikun, kështu që veprimi i tyre është i qartë dhe i kuptueshëm për qytetarë, si edhe që me veprimin e vet të nxitojnë pjesëmarrjen e publikut dhe përgjegjësinë e mbajtësve të funksioneve publike.

E drejta e qasjes në dokumentet në posedimin e organeve të autoritetit publik që përmbajnë informacionet nga rëndësia publike kryesisht është garantuar me legjislacionin e shteteve anëtare të Këshillit Evropian. Këshilli Evropian në vitin 2009 ka miratuar Konventën për qasje në dokumentet zyrtare¹³, por këtë konventë e kanë konfirmuar deri tani vetëm 7 shtete anëtare, kurse në momentin e shkrimit të këtij udhëzuesi nuk ka hyrë në fuqi.

Mbi nevojë për transparencën më të madhe në procesin e negociatave tregon Mendimi i Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social për përforcimin e transparencës dhe gjithëpërfshirës së procesit të aderimit në BE-në.¹⁴ Në rekomandimet që u dërguan organeve të BE-së veçanërisht theksohet nevojja për atë që PE-ja, Këshilli i BE-së dhe KE-ja të bëjnë të gjitha dokumentet kyçe publikisht të disponueshme dhe t'i shpallin në faqen zyrtare të internetit (raportet për skринing, përkthimi i trashëgimisë juridike të BE-së, kriteret për hapjen dhe mbylljen e kapitujve negociuese).¹⁵ Gjithashtu, organeve të BE-së sugjerohet që të sigurojnë që qasja në informacione dhe pjesëmarrja e publikut të jenë pjesë përbërëse e programit të ndjekjes së përparimit në procesin e aderimit në BE-në. Rekomandimet për shtete në procesin e aderimit kanë të bëjnë me krijimin e rregullave të qarta dhe të shkruara për qasje në informacione lidhur me procesin e negociatave.

5.1. E drejta për qasje në dokumente në posedimin e organeve të Bashkimit Evropian

E drejta për qasje në dokumente në posedimin e organeve të BE-së është përcaktuar me marrëveshjet themeluese. Me marrëveshjen nga Amsterdami (1997), me të cilën janë ndryshuar dhe plotësuar Marrëveshja për BE-në dhe marrëveshjet për themelimin e Komuniteteve Evropiane, çdo personi fizik që ka vendqëndrim në territorin e BE-së¹⁶ dhe çdo personi juridik prej të cilit selia është

13. Council of Europe Convention on Access to Official Documents (CETS No: 205) <http://bit.ly/1TIkLDA> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

14. Opinion of the European Economic and Social Committee on Enhancing the transparency and inclusiveness of the EU accession process REX/401, 2014 <http://bit.ly/1ogGnnA> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

15. Në faqen e internetit të Komisionit Evropian që ka të bëjë me politikën e fqinjësisë dhe zgjerimit mund të gjetet një pjesë e dokumenteve lidhur me procesin e negociatave me Republikën e Serbisë <http://bit.ly/1RG3lel> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

16. Me qëllim që materia me të cilën merremi të jetë e kuptueshme në praktikë shprehja Komunitetet Evropiane ose Komunitete, është zëvendësuar me shprehjen Bashkimi Evropian ose Bashkimi/Union, ku kjo ka qenë e zbatueshme. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes nga Lisbona Bashkimi Evropian është bërë mbajtës i subjektiviteti ligjor, ndërsa këtë rol më parë kanë pasur Komunitetet Evropiane.

regjistruar në territorin BE-së¹⁷ i është siguruar e drejta për qasje në dokumentet e PE-së, Këshillit dhe KE-së. Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes nga Lisbona, Karta e të drejtave themelore të BE-së, e cila është miratuar si dokument politik në Samitin në Nicë në vitin 2000 është bërë burimi i të drejtave të BE-së. Në titullin V të Kartës („Të drejtat civile“) është përcaktuar e drejta për qasje në dokumente, d.m.th. është konfirmuar e drejta për qasje në dokumentet e PE-së, Këshillit dhe KE-së.¹⁸ Në sistemin e BE-së, para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Lisbonës, parimi i transparencës administrative në kuptim më të gjerë ka qenë i rëndësishëm formalisht për Këshillin, KE-në dhe PE-në¹⁹, por jo edhe për organe dhe trupa të tjera. Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Lisbonës (2009), qasja në informacione është bërë e drejta themelore në të drejtën e BE-së. Nga një anë, neni 15 të Marrëveshjes për funksionimin e BE-së përcakton që „për ta nxitur administratën e mirë dhe për ta siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile, organet, trupat, shërbimet, agjencitë e Unionit në masën më të madhe të mundshme duhet ta respektojnë parimin e veprimit publik“ dhe përsërit që „çdo qytetar i Unionit dhe çdo person fizik ose juridik që ka vendqëndrim/seli të regjistruar në shtetin anëtar, ka të drejtë për qasje në dokumentet e organeve, trupave, shërbimeve dhe agjencive të Unionit, duke mos marr parasysh mbajtësin e informacioneve në të cilin gjenden“.²⁰ Nga ana tjetër, Karta e Bashkimit Evropian për të drejtat themelore, në mënyrë eksplicite garanton „të drejtën e çdo personi që të ketë qasje në dosjen e vet (neni 41) dhe të drejtën e qasjes në dokumentet e organeve të BE-së (neni 42). E drejtat e publikut që të dijë është bërë e drejta themelore në të drejtën e BE-së, pra nga shtetet anëtare pritet që ta sigurojnë transparencën administrative në kuptim më të gjerë.

Zbatimi i të drejtës për qasje në dokumentet në posedimin e organeve të BE-së më afër është përcaktuar me Rregulloren e PE-së dhe të Këshillit 1049/2001 për qasjen e publikut në dokumentet e PE-së, Këshillit dhe KE-së.²¹ Rregullorja është miratuar më 30 maj të vitit 2001 kurse zbatohet nga 3 dhjetori i vitit 2001.²² Aktgjykimi i parë i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë është themeluar mbi dispozitat e Rregullores 1049/2001, e marrë në vitin 2003 në rastin Messina v. Commission T-76/02.²³ Që nga viti 2005 është lëvizur „Iniciativa Evropiane për Transparencë“, e cila përfshinte propozimin që të ndryshohet Rregullorja 1049/2001.²⁴ Duke

17. Neni 255 të Marrëveshjes nga Amsterdami.

18. Neni 42 të Kartës së të drejtave themelore të Bashkimit Evropian.

19. REGULATION (EC) No 1049/2001 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 30 May 2001 regarding public access to European Parliament, Council and Commission documents, <http://bit.ly/1oxDRcC> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

20. Neni 11, paragrafi 2. MBE: „Organet e mbajnë një dialog të hapur, transparent dhe të rregullt me shoqëri përfaqësuese dhe shoqëri civile“.

21. REGULATION (EC) No 1049/2001 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 30 May 2001 regarding public access to European Parliament, Council and Commission documents, http://www.europarl.europa.eu/RegData/PDF/r1049_en.pdf (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

22. COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES, GREEN PAPER Public Access to Documents held by institutions of the European Community, A review, COM(2007) 185 final, Brussels, 2007.

23. <http://curia.europa.eu/juris/liste.jsf?language=en&num=T-76-02> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

24. COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES, GREEN PAPER Public Access to Documents held by institutions of the European Community, A review, COM(2007) 185 final, Brussels, 2007.

marrë parasysh që Rregullorja 1049/2001 edhe më tej përfaqëson bazën ligjore për qasjen e publikut në dokumentet e PE-së, Këshillit dhe KE-së, në vazhdimin e tekstit është përfaqësuar procedura e cila është përcaktuar me këtë rregullore, si edhe përkufizimet e qasjes në dokumente. Njohja e procedurave për qasje në dokumentet e organeve të BE-së mund të jetë e rëndësishme në mënyrë të shumëfishtë për shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të interesuar që ndjekin procesin e negociatave dhe përpiqen që t'u kontribuojnë informimit më të mirë të qytetarëve dhe respektimit të parimeve të sundimit të ligjit dhe administratës së mirë.

5.1.1 E drejta e publikut për qasje në dokumentet e Parlamentit, Këshillit dhe Komisionit Evropian – Rregullorja 1049/2001

Me Rregulloren 1049/2001 është mundësuar efekti juridik i dispozitës së nenit 255 të Marrëveshjes nga Amsterdami. Në pjesën hyrëse të Rregullores e drejta për qasje në dokumentet e organeve të BE-së qartë lidhet me parimin e çiltërisë dhe përcaktimin e shteteve anëtare që duke shënuar një etapë të re në procesin e krijimit të aleancës sa më të ngushtë mes popujve të Evropës, vendimet t'i marrin në mënyrë sa më të hapur dhe të afërt për qytetarët.²⁵ Qëllimi i Rregullores është që ta mundësojë zbatimin e plotë të së drejtës së publikut për qasje në dokumente, që t'i vendosë parimet e përgjithshme për zbatimin e kësaj të drejte dhe kufizimet për qasje në dokumentet në lidhje me interes publik ose privat, në pajtimin me nenin 255 të Marrëveshjes për Komunitetet Evropiane. Zbatimi i kësaj Rregulloreje hyn edhe në politikën e jashtme të BE-së, me dokumentet që hartohen nga puna e organeve të BE-së ose janë në posedimin e tyre, kurse kanë të bëjnë me politikë të jashtme.²⁶ Për ta siguruar zbatimin e plotë e kësaj Rregulloreje mbi të gjitha veprimet e BE-së, të gjitha agjencitë të cilat i kanë themeluar organet kanë për detyrë që ta zbatojnë parimet që janë përcaktuar me këtë rregullore. Rregullorja 1049/2001 përfaqëson dokumentin kryesor dhe të gjitha rregullat që përcaktojnë të drejtën për qasje në dokumentet e organeve të BE-së duhet të jenë në pajtim me të.

Parimisht, sipas dispozitave të këtij akti ligjor, të gjitha dokumentet e organeve të BE-së duhet të jenë të disponueshme për publik. Megjithatë, interesat e caktuara publike dhe private duhet të jenë të mbrojtura përmes përjashtimit nga rregulla. Mbrojtja e të dhënave personale, d.m.th. përdorimi dhe shpallja e këtyre të dhënave nga ana e organeve të BE-së, është rregulluar me Rregulloren 45/2001²⁷, por mbrojtja e të dhënave personale nuk është subjekt i këtij udhëzu-

25. Neni 1. MBE.

26. Në moment kur është miratuar Rregullorja 1049/2001 Bashkimi Evropian ka funksionuar nëpër të ashq. tri shtylla – Komuniteti Evropian, politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurt dhe bashkëpunimi në çështjet gjyqësore dhe penale. Me këtë Rregullore është përcaktuar qartë që të drejtat për qasje në dokumente u takojnë edhe politikës së jashtme dhe të sigurt dhe bashkëpunimit në çështje juridike e penale.

27. REGULATION (EC) NO 45/2001 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 18 December 2000 on the protection of individuals with regard to the processing of personal data by the Community institutions and bodies and on the free movement of such data, <http://bit.ly/1KRBjR1> (aksesuar herën e fundit me dt. 16.11.2015.)

esi. Gjithashtu, për shkak të nevojës që pa pengesë t'i zbatoj veprimet e veta të rregullta organet janë autorizuar që të kufizojnë qasje në dokumentet për konsultime të brendshme dhe pajtime. Në vlerësimin e shkallës së kufizimit të qasjes në dokumente organet kanë për detyrë që t'i afrohen parimit të së drejtës komunitare lidhur me mbrojtjen e të dhënave për personalitet. Kjo rregullore nuk u takoj rregullave të përcaktuara për qasje në dokumente në shtetet anëtare, as të drejtave për qasje në dokumente në posedimin e organeve gjyqësore dhe hetuese. Gjithashtu, kjo rregullore nuk hyn në të drejtën për qasje në dokumente që janë në posedim të organeve të cilat burojnë nga instrumenteve të së drejtësisë ndërkombëtare ose akteve të organeve që i zbatojnë.

Në preambulën e Rregullores është përcaktuar që qasja në dokumente nuk është kufizuar vetëm për dokumente që rrjedhin nga puna e organeve ose i kanë miratuar PE-ja, Këshilli ose KE-ja, por ka të bëjë edhe me dokumentet që janë në posedimin e këtyre organeve, d.m.th. me dokumentet të cilat i pranojnë institucionet e përmendura në punën e vet. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e negociatave për aderim në BE-në. Në pajtim me Deklaratën nr. 35, me të cilën është plotësuar Marrëveshja nga Amsterdami, kjo Rregullore ua siguron shteteve anëtare të drejtën që të kërkojnë që dokumentet që vijnë nga shtetet anëtare t'i mos vihen në qasje publikut pa pajtimin e tyre të mëparshëm.²⁸

KUSH KA TË DREJTË PËR QASJE NË DOKUMENTE NË PAJTIM ME RREGULLORE?

Neni 2, paragrafi 1

Çdo qytetar i Bashkimit dhe çdo person fizik ose juridik që ka vendqëndrim ose seli të regjistruar në shtetin anëtar ka të drejtë për qasje në dokumentet e organeve, në pajtim me parimet, kushtet dhe kufizimet e përcaktuara me këtë rregullore.

Neni 2, paragrafi 2

Organet mund, në pajtim me parime, kushte, kufizime të njëjta t'ia miratojnë qasjen në dokumente çdo personi juridik ose fizik që nuk ka vendqëndrim ose seli të regjistruar në shtetin anëtar.

Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha dokumentet të cilat i ruan ndonjë organ, d.m.th për dokumente të cilat i ka hartuar, pranuar ose i posedon organi i BE-së, kurse të cilat kanë të bëjnë me të gjitha fushat e veprimit të BE-së.

28. Declaration on Article 191a(I) of the Treaty establishing the European Community, Treaty of Amsterdam amending the Treaty on European Union, the Treaties establishing the European Communities and certain related acts, signed at Amsterdam, 2 October 1997, OJ 97/C 340 /01, <http://bit.ly/1QtG1jS> (aksesuar herën e fundit me dt. 16.11.2015.)

„dokument“ është çdo përmbajtje, duke mos marrë parasysh mbajtësin e informacioneve (i shkruar në letër ose i ruajtur në formë elektronike ose si shënim audio, vizual ose audio-vizual) që ka të bëjë me politika, veprim dhe vendime që janë në fushën e organit kompetent.

Dokumentet e ndjeshme, në pajtim me këtë Rregullore (neni 9), kanë një trajtim të veçantë. Me Rregullore (neni 12) rregullohet qasja në dokumente të cilat krijohen ose janë pranuar gjatë procesit legjislativ.

Dokumentet i vihen publikut në qasje pas kërkesës së shkruar ose në formë elektronike përmes regjistrit të dokumenteve.

Këtu duhet theksuar dallimin mes dokumenteve që janë të disponueshme nëpër regjistrat elektronike të dokumenteve të BE-së dhe dokumenteve që i duhet kërkuar duke paraqitur një kërkesë të shkruar. BE-ja ka zhvilluar ueb servise shumë efikase për qasje në dokumente, prej të cilave arkiva më e pasur elektronike e legjislacionit të BE-së është Eur-Lex.²⁹ Hapi i parë për qasje në dokumentet e BE-së duhet të jetë kontrollim a dokumenti i kërkuar tashmë gjendet në bazën elektronike të ndonjë organi të BE-së.

Linqet e dobishme

EUR-Lex	Qasje në legjislacionin e BE-së
Portali për transparencë	Qasje në dokumentet e KE-së
Regjistri publik i dokumenteve të Këshillit	Qasje në dokumentet e Këshillit Evropian dhe Këshillit
Parlamenti Evropian – Informohu	Qasje në dokumentet e PE-së

Analiza e zbatimit të Rregullores 1049/2001 nuk është subjekt i këtij udhëzuesi, por duhet theksuar që transparencja e organeve të BE-së ende është një sfidë e madhe me të cilën ballafaqohen edhe vetë organet, por edhe ata që e gëzojnë të drejtën për qasje në dokumente, d.m.th. qytetarët e BE-së.

Pranë asaj që përcakton kush ka të drejtë për qasje në dokumente, si edhe nocionin e shprehjes dokument, Rregullorja 1049/2001 jep edhe përkufizimin e „anës së tretë“, çfarë është e nevojshme për implementim të kënaqshëm, d.m.th. për gëzimin e të drejtave për qasje në dokumente. „Ana e tretë“ është çdo person fizik ose juridik, ose subjekt tjetër jashtë organit, duke përfshirë edhe shtete anëtare, organe të tjera ose trupa të Unionit ose jashtë Unionit, si edhe shtete e treta. Duke marrë parasysh këtë përkufizim, shteti kandidat për anëtarësim i përket të asht. ane të tretë në pajtim me dispozitat e Rregullores.

29. Arkiva elektronike e legjislacionit të BE-së: <http://eur-lex.europa.eu/homepage.html> (aksesuar herën e fundit me dt. 16.11.2015.)

5.1.1.1. Kufizimet e qasjes në dokumente

Rregullorja (neni 4) përcakton cilat janë kufizime, d.m.th. situata në të cilat organet e BE-së mund ta pengojnë qasjen në dokumente. Organet e pengojnë qasjen në dokumente në rast kur zbulimi i tyre do ta rrezikonte mbrojtjen e interesave komerciale të personit fizik ose juridik duke përfshirë pronësinë intelektuale, nëse zbardhimi i dokumenteve do të ndikonte mbi zhvillimin e procesit gjyqësor ose të këshillimit juridik, veprimeve hetimore, vetë-shqyrtimeve ose rishikimeve. Këto kufizime krijohen nëse nuk ekziston interesi publik mbizotërues që dokumentet t'i vihen në qasje publikut. Pra, mbrojtja e interesit publik është kriter themelor në bazë të cilit merren vendimet për kufizimet e qasjes në dokumentet e organeve të BE-së. Nga qasja e detajuar në nenin e cituar të Rregullores vjen përfundimi që për qasje në dokumentet e BE-së janë vendosur shumë kufizime, dhe për atë arsye është e rëndësishme që kërkuesi i informacionit të kushtojë vëmendje gjatë paraqitjes së kërkesës për qasje në informacione. Ashtu, qasja në dokumentet të cilat përmbajnë mendimin për përdorim të brendshëm, si edhe pjesa e diskutimeve dhe konsultimeve paraprake në organ janë kufizuar edhe pas vendimmarrjes, nëse zbulimi i tij mund ta rrezikojë procesin e vendimmarrjes në kuadër të organit, përveç rastit kur për zbulimin e tij nuk ekziston interesi publik mbizotërues.

NENI 4 F. 1 E 2

Organet e ndalojnë qasjen në dokument, nëse zbulimi i tij do të rrezikonte mbrojtjen e:

(a) interesit publik i cili ka të bëjë me:

- siguri publike,
- mbrojtje dhe çështje ushtarake,
- marrëdhënie ndërkombëtare,
- politikën financiare, monetare ose ekonomike të Unionit ose ndonjë shteti anëtar;

(b) intimitetit dhe integritetit të individit, posaçërisht në pajtim me rregullat e Unionit për mbrojtjen e të dhënave të personit.

Kur bëhet fjalë për dokumentet e anës së tretë (neni 4, paragrafi 4), organet kanë për detyrë që të konsultohen me anën e tretë për të vlerësuar a është i zbatueshëm kufizimi i cili citohet, përveç në raste kur është qartë a dokumenti mund të shpallet ose jo. Pra, ana e tretë nuk ka të drejtë të diskrecionit për ta kufizuar qasjen në dokumente por organi ka për detyrë, që përmes konsultimeve me anën e tretë, të vlerësojë a ndonjë prej kufizimeve është e zbatueshme ose jo.

Shteti anëtar mund të kërkojë nga organi që pa pajtimin e tij të mëparshëm të mos shpall dokumentin i cili buron nga ky shtet, çfarë është në pajtim me Deklaratën nr. 35 të përmendur më lartë me Marrëveshjen e Amsterdimit.

Nëse ekziston shkak i arsytuar për kufizim, kjo nuk do të thotë që tërë dokumenti duhet të jetë i mbrojtur. Në se me përjashtime janë përfshirë vetëm pjesët e kërkuara të dokumentit, pjesët e tjera të dokumentit mund të shpallen. Gjithashtu, kufizimet e cituara zbatohen vetëm në atë periudhë kohore gjatë të cilës ekzistojnë shkaqet për kufizimin e qasjes, duke marrë parasysh përmbajtjen e dokumentit. Përjashtimi mund të zbatohet në periudhën maksimale prej 10 viteve. Në rastin kur dokumenti përmban informacione në lidhje me interes privat ose të biznesit ose në rastin e dokumenteve të ndjeshme, përjashtimi mund të zbatohet edhe pas periudhës 30 – vjeçare.

Me nenin 5 është rregulluar qasja në dokumentet e organeve të BE-së që janë në posedimin e shteteve anëtare. Kurs shteti anëtar pranon kërkesën për qasje në dokumentin i cili është në posedimin e tij, kurse i cili vjen nga njëri prej organeve të BE-së, shteti anëtar ka për detyrë që të konsultohet me organin në fjalë për ta marrë vendimin i cili nuk do ta rrezikojë realizimin e qëllimeve të Rregullores, përveç nëse është krejt e qartë a mund të shpallet dokumenti ose jo. Shteti anëtar, në vend të asaj, mund t'ia dërgojë kërkesën organit.

5.1.1.2. Si paraqitet dhe procedohet kërkesa për qasje në dokumentet e BE-së

ENI 6 PARAGRAFI 1

Kërkesat për qasje në dokumente paraqitet në formë të shkruar, duke përfshirë edhe formën elektronike, në një prej gjuhëve zyrtare të BE-së, në mënyrë në të cilën janë përcaktuar mjaft që organit t'ia mundësojnë identifikimin e dokumentit. Paraqitësi i kërkesës nuk ka për detyrë që të citojë shkaqet për paraqitjen e kërkesës.

Nëse kërkesa nuk është caktuar mjaft, organi ka për detyrë që ta kërkojë sqarimin nga paraqitësi i kërkesës dhe t'ia ndihmojë në ofrimin e informacioneve për përdorimin e regjistrave publike të dokumenteve. Rregullorja (neni 14) përcakton që çdo organ është i detyrueshëm që t'ia ndërmarrë masa të nevojshme për ta informuar publikun për të drejtat që i gëzojnë në bazë të kësaj rregulloreje. Organet janë, mes të tjerash, të detyrueshme që qytetarëve t'ua ofrojnë informacionet dhe udhëzimet për atë ku dhe sesi mund ta paraqesin kërkesën për qasje në dokumente. Gjithashtu, shtetet anëtare duhet të bashkëpunojnë me organet për t'ua ofruar informacionet qytetarëve. Me rregulloren janë parashikuar edhe konsultimet joformale të organeve me paraqitësin e kërkesës për ta arritur deri tek zgjidhja e përshtatshme në rast se bëhet fjalë për dokumentin e vëllimit të madh ose për numër më të madh të dokumenteve.

Formulari për kërkesën online për qasje në dokumente është i disponueshëm në ueb sajtin zyrtar të KE-së, ku gjendet edhe udhëzimi për plotësimin e formularit. Gjithashtu, formulari për qasje në dokumente është i disponueshëm edhe në ueb sajtin e [Agjencisë Evropiane për të drejtat themelore](#).

Sipas dispozitave të Rregullores (neni 7), organi i përshtatshëm vepron menjëherë sipas kërkesës, kurse vërtetimi për pranimin e kërkesës i dërgohet paraqitësit të saj. Brenda 15 ditëve të punës nga pranimi i kërkesës, organi miraton qasjen për dokumentin e kërkuar dhe siguron qasjen në pajtim me nenin 10. Me Rregulloren, në të njëjtin afat kohor, në përgjigje të shkruar arsyetohet refuzimi i pjesshëm ose i plotë i kërkesës dhe informohet paraqitësi i kërkesës për të drejtën e tij për ta përsëritur të njëjtën. Në rastin e refuzimit të plotë ose të pjesshëm, paraqitësi i kërkesës mund të paraqes një kërkesë në afatin kohor prej 15 ditëve të punës, duke kërkuar nga organi për ta shqyrtuar qëndrimin e vet.

Në raste të veçanta, kur kërkesa ka të bëjë me një dokument të vëllimit të madh ose numrin e madh të dokumenteve, afati për plotësimin e kërkesës mund të zgjatohet për 15 ditë më. Në atë rast paraqitësi i kërkesës duhet të jetë i informuar përpara, me citimin e shkaqeve të detajuara për zgjatimin e afatit. Nëse në afatin e parashikuar paraqitësi i kërkesës nuk merr asnjë përgjigje, ka të drejtë që ta përsërisë kërkesën për qasje në dokumente. Procedimi i kërkesës së përsëritur nuk dallohet nga procedimi i kërkesës fillestare, përveç kësaj që organi është i detyruar që në rastin e refuzimit të plotë ose të pjesshëm, të lajmërojë paraqitësin e kërkesës për mjete juridike që i janë në dispozicion (neni 8). Paraqitësi i kërkesës mund ta lëvizë procesin gjyqësor kundër organit i cili ia refuzoi qasjen ose t'ia paraqesë ankesën Ombudspersonit Evropian. Nëse mungon përgjigjja mbi kërkesën e përsëritur, konsiderohet që përgjigjja është negative dhe paraqitësi i kërkesës mund t'i përdorë mjetet e disponueshme juridike.

5.1.1.3. Trajtimi me dokumentet konfidenciale

NENI 9, PARAGRAFI 1.

Dokumentet e ndjeshme janë dokumentet që vijnë nga organet ose agjencitë të cilat ato i kanë themeluar, ose nga shtetet anëtare, shtetet e treta dhe organizatat ndërkombëtare, që janë shënuar me shënimin „TRÉS SECRET/TOP SECRET”, „SECRET” ose „CONFIDENTIAL” në pajtim me rregullat e organit në fjalë, të cilat mbrojnë interesat thelbësore të Bashkimit Evropian ose një ose disa anëtarët e saj në fusha me të cilat lidhet neni 4 paragrafi 1 pika (a) të Rregullores 1049/2001, kurse veçanërisht në fushën e sigurisë publike, mbrojtjes dhe çështjeve ushtarake.

Është e rëndësishme të përmendet që dokumentet e ndjeshme janë ato që janë shënuar si të tillë edhe para se paraqitësi i kërkesës ka kërkuar një dokument të caktuar për qasje, d.m.th. arbitrariteti në vendimmarrje për qasje në

dokumentet e besueshme nuk është lejuar. Detyrimi i tillë rrjedh nga parimet mbi të cilat është themeluar puna e të gjitha organeve të BE-së. Çdo organ i cili vendos që të refuzojë qasjen në dokumentet e ndjeshme duhet ta arsyetojë vendimin e vet. Vetëm në atë mënyrë mund të kontrollohet a vendimi për refuzimin e dokumentit ka qenë i ligjshëm. Rregullat e organeve që kanë të bëjnë me dokumentet e ndjeshme duhet patjetër të jenë të disponueshme publikisht.

Për arsyet e kufizimit të qasjes në dokumente vendoset në çdo rast individualisht, kurse organi kompetent është i detyruar që kërkuesit t'i ofrojë shpjegimin e shkruar të arsyeve për kufizimin e qasjes. Për atë arsye kërkuesi potencial nuk duhet të jetë i pamotivuar me kufizimet e cituara në Rregulloren 1049/2001. Ndonjëherë informacioni, që organi i BE-së posedon një dokument të caktuar dhe nuk mund t'ia vërë në dispozicion publikut për shkak të ndonjë arsyeje të cituar me Rregulloren, është i mjaftueshëm që kërkuesi mund të kuptojë më mirë proceset në të cilat merr pjesë si anë e interesuar.

Gjithashtu, posaçërisht është i rëndësishëm qëndrimi ndaj dokumenteve që rrjedhin nga puna me anët e treta, në rastin e posaçëm me shtetin kandidat në procesin e negociatave. E drejta e publikut që të informohet për procesin e negociatave, si edhe që të ketë qasje në dokumente që krijohen në këtë proces, është përcaktuar qartë me kuadrin juridik evropian dhe kombëtar. Është e qartë që çdo devijim duhet të jetë i arsyetuar, kurse në rastin e BE-së duhet të jetë edhe në pajtim me dispozitat e Rregullore 1049/2001. Madje bëhet fjalë për një proces politik, nuk duhet harruar që ky proces është përcaktuar me kuadrin e qartë juridik. Më thjeshtë, kufizimi i qasjes në dokumentet që krijohen në procesin e negociatave është i pranueshëm vetëm nëse është në pajtim me ligjin aktual që rregullon këtë fushë. Respektimi i parimit të sundimit të ligjit dhe respektimi i të drejtave të garantuara civile janë burim unik i besimit mes organeve të pushtetit dhe qytetarëve.

SHTOJCA 1.

Zhvillimi i negociatave – Pesë skenarë të mundshëm

SKENARI I: PROCEDURA E SHKURTËR – PA KRITERE TË VEÇANTA	
1	Skriningu shpjegues (ang. Explanatory Screening)
2	Skriningu bilateral (ang. Bilateral Screening)
3	KE-ja përgatis raportin për skrining (ang. Screening Report)
4	Këshilli e pranon raportin dhe fton shtetin kandidat që ta prezantojë pozitën e vet negociuese
5	Shteti kandidat e dorëzon pozitën negociuese
6	KE-ja, në bazë të saj, përgatis draftin e pozitës së përbashkët të BE-së (ang. Draft EU Common Position)
7	Këshilli miraton pozitën e përbashkët (ang. EU Common Position) dhe thirr Konferencën Ndërqeveritare (ang. Intergovernmental Conference)
8	Në KNQ-në hapet dhe mbyllet përkohësisht kapitulli konkret negociues

SKENARI II: PROCEDURA ME KRITERE PËR HAPJEN E NEGOCIATAVE PËR KAPITULLIN E KAKTUAR	
1	Skriningu shpjegues (ang. Explanatory Screening)
2	Skriningu bilateral (ang. Bilateral Screening)
3	KE-ja përgatis raportin për skrining (ang. Screening Report) dhe ua propozon Këshillit kriteret për hapjen e kapitullit (ang. Opening benchmarks)
4	Këshilli pranon i raportin për skrining dhe kriteret për hapjen e kapitullit dhe fton shtetin kandidat që t'i plotësojë
5	Shteti kandidat ndërmerr hapat e përshtatshëm për plotësimin e kriterëve për hapjen e kapitullit
6	KE-ja mbikëqyr, kurse shteti kandidat përmbush kriteret, harton raportin për vlerësimin e kriterëve të plotësuar (ang. Opening Benchmark Assessment Report – OBAR) ia dorëzon Këshillit
7	Këshilli i BE-së e pranon OBAR-in dhe kërkon nga shteti kandidat për ta dorëzuar pozitën e vet negociuese
8	Shteti kandidat e dorëzon pozitën negociuese
9	KE-ja në bazë të saj e përgatis draftin e pozitës së përbashkët të BE-së (ang. Draft EU Common Position)
10	Këshilli e miraton pozitën e përbashkët (ang. EU Common Position) dhe thirr KNQ-në (ang. Intergovernmental Conference)

11	Në KNQ-në hapen negociatat për kapitullin konkret negociues
12	Negociatat zhvillohen në kuadër të strukturës ekzistuese në kapitullin konkret
13	Në KNQ-në përkohësisht mbyllet kapitulli konkret negociues

SKENARI III: PROCEDURA ME KRITERE PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE PËR KAPITULLIN E CAKTUAR	
1	Skriningu shpjegues (ang. Explanatory Screening)
2	Skriningu bilateral (ang. Bilateral Screening)
3	KE-ja e përgatisë raportin për skrining (ang. Screening Report)
4	Këshilli e pranon raportin dhe fton shtetin kandidat që të përfaqësojë pozitën e vet negociuese për kapitullin në fjalë
5	Shteti kandidat e dorëzon pozitën e vet negociuese
6	KE-ja në bazë të saj e përgatis draftin e pozitës së përbashkët të BE-së (ang. Draft EU Common Position) dhe i propozon kriteret për mbylljen e kapitullit (ang. Closing benchmarks)
7	Këshilli miraton pozitën e përbashkët të BE-së (ang. EU Common Position) dhe kriteret për mbylljen e kapitullit dhe thirr KNQ-në (ang. Intergovernmental Conference)
8	Në KNQ-në hapet kapitulli dhe konstatohen kriteret për mbylljen e kapitullit
9	Vjen mbajtja e konferencave negociuese (ang. Negotiating conferences) dhe konsultimeve teknike
10	KE-ja ndjek zhvillim, edhe kur kriteret për mbylljen të plotësohen, përgatis raportin për atë dhe ia propozon Këshillit mbylljen e përkohshme të kapitullit
11	Këshilli pranon dhe në KNQ-në e parë mbyll kapitull përkohësisht

SKENARI IV: PROCEDURA ME KRITERE PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN E NEGOCIATAVE PËR KAPITULLIN E CAKTUAR	
1	Skriningu shpjegues (ang. Explanatory Screening)
2	Skriningu bilateral (ang. Bilateral Screening)
3	KE-ja e përgatis raportin për skrining (ang. Screening Report) dhe ua propozon Këshillit kriteret për hapjen e negociatave (ang. Opening benchmarks)
4	Këshilli e pranon raportin për skrining dhe kriteret për hapjen e negociatave dhe fton shtetin kandidat që t'i përmbush
5	Shteti kandidat ndërmerr hapa të përshtatshëm për përmbushjen e kriterëve për hapjen e kapitullit
6	KE-ja mbikëqyr, dhe kur shteti kandidat i plotëson kriteret, përpilon raportin për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve (ang. Benchmark Assessment Report – OBAR) dhe ia dorëzon Këshillit
7	Këshilli e pranon OBAR-in dhe kërkon nga shteti kandidat për ta dorëzuar pozitën e vet negociuese
8	Shteti kandidat e përgatis dhe dorëzon pozitën negociuese
9	KE-ja në bazë të saj përgatis draftin e pozitës së përbashkët të BE-së (ang. Draft EU Common Position) dhe propozon kriteret për mbylljen e kapitullit të BE-së (ang. Closing benchmarks)
10	Këshilli miraton pozitën e përbashkët të BE-së (ang. EU Common Position) dhe kriteret për mbylljen dhe thirr KNQ-në (ang. Intergovernmental Conference)

11	Në KNQ-në hapet kapitulli dhe konstatohen masat për mbyllje
12	Negociatat brenda kapitullit të hapur (KNQ-ja dhe konsultime teknike)
13	Shteti kandidat ndërmerr hapa të përshtatshëm për përmbushjen e kriterëve për mbylljen e kapitullit
14	KE-ja ndjek zhvillimin dhe kur plotësohen kriteret për mbyllje, e përgatis raportin për atë dhe ia propozon Këshillit mbylljen e përkohshme të kapitullit
15	Këshilli pranon, dhe në KNQ-në e parë e ardhshme, mbyll kapitullin përkohësisht

SKENARI V: PROCEDURA ME E GJATË (DHE KRITERET PËR HAPJEN DHE KRITERET PËR MBYLLJEN E NEGOCIATAVE PËR KAPITULLIN E CAKTUAR, DHE KRITERE KALIMTARE)	
1	Skriningu shpjegues (ang. Explanatory Screening)
2	Skriningu bilateral (ang. Bilateral Screening)
3	KE-ja përgatis raportin për skrining (ang. Screening Report) dhe ua propozon Këshillit kriteret për hapjen e negociatave (ang. Opening benchmarks)
4	KE-ja mbikëqyr, dhe kur shteti kandidat i përmbush kriteret, përpilon raportin për vlerësimin e përmbushjes kriterëve (OBAR) dhe ia dorëzon Këshillit
5	Këshilli konstaton që kriteret për hapjen e kapitullit janë plotësuar dhe kërkon nga shteti kandidat që ta dorëzojë pozitën e vet negociuese
6	Shteti kandidat e dorëzon dhe KE-ja në bazë të saj e përgatis draftin e pozitës së përbashkët të BE-së dhe propozon kriteret kalimtare (ang. Interim benchmarks)
7	Këshilli i miraton pozitën e përbashkët të BE-së dhe kriteret kalimtare dhe thirr KNQ-në (ang. Intergovernmental Conference)
8	Në konferencën ndërqeveritare hapet kapitulli dhe konstatohen kriteret kalimtare
9	Vijnë konferencat negociuese dhe konsultimet teknike
10	KE-ja ndjek zhvillim, dhe kur të plotësohen kriteret kalimtare, i propozon Këshillit që të ftojë shtetin kandidat për ta dorëzuar pozitën kalimtare negociuese
11	Këshilli pranon propozimin e KE-së dhe fton shtetin kandidat për ta dorëzuar pozitën e vet kalimtare negociuese
12	KE-ja në bazë të saj e përgatis draftin e pozitës së përbashkët kalimtare të BE-së (ang. Interim Draft EU Common Position) dhe i propozon kriteret për mbylljen e kapitullit (ang. Closing benchmarks)
13	Këshilli pranon draftin e pozitës së përbashkët kalimtare të BE-së
14	KE-ja mbikëqyr, dhe kur vlerëson që janë përmbushur kriteret për mbylljen e kapitullit, e përpilon dhe ia dorëzon Këshillit draftin e pozitës përfundimtare të përbashkët të BE-së (ang. Draft Final EU Common Position) dhe propozon mbylljen e përkohshme të kapitullit
15	Këshilli miraton pozitën e përbashkët të BE-së (ang. EU Common Position) dhe thirr KNQ-në
16	KNQ-ja e mbyll kapitullin (përkohësisht)
17	KE-ja mbikëqyr dhe ia dorëzon Këshillit raportin gjashtëmujor
18	Para vet aderimit, KE-ja e paraqes raportin përfundimtar për negociata

SHTOJCA 2.

Shqyrtimi i dokumenteve të BE-së dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor të rëndësishme për ndjekjen e procesit të integritimeve evropiane

Kur flasin për procesin e integritimeve evropiane më shumë flasim për procesin e përputhshmërisë së legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së, çfarë nënkupton edhe miratimin e trashëgimisë juridike të BE-së dhe zbatimin e saj. Bëhet fjalë për një proces koherent i cili nënkupton disa bashkëveprime: bashkëveprimin e organeve shtetërore me organet e BE-së, bashkëveprimin mes vetë organeve shtetërore, bashkëveprimin e legjislacionit ekzistues vendor me „atë të ri“ që miratohet gjatë procesit të përputhshmërisë, si edhe bashkëveprimin e rregullave vendore me detyrimet ndërkombëtare të shtetit. Në atë kuptim, në planin e parë del çështja e njohjes së kuadrit ligjor, d.m.th. të tërë setit të dokumenteve me të cilat rregullohet ky proces, përcaktohet përmbajtja e marrëdhënieve, ndahen autorizimet dhe kompetencat, dhe përcaktohen rolet e institucioneve dhe aktorëve që udhëheqin këtë proces.

Shtojca 2 i është kushtuar shqyrtimit të dokumenteve të rëndësishme për ndjekjen e procesit të integritimeve evropiane. Në këtë Shtojcë janë përfaqësuar dokumentet më të rëndësishme që rrjedhin si rezultat i ndjekjes së përparimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor në procesin e integritimeve të BE-së si edhe marrëveshjet ndërkombëtare që ndikojnë mbi këtë proces ose përmbajnë dispozitat me të cilat janë rregulluar të drejtat dhe detyrimet mes BE-së dhe shteteve candidate për anëtarësim, si edhe mes shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe shteteve candidate për anëtarësim.

Njohja e përmbajtjes së këtyre dokumenteve është parakusht për përfshirjen aktive të përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe palëve të interesuara në procesin e integritimeve evropiane, ndjekjen e këtij procesi dhe kontributin e tyre. Me njohje të këtyre dokumenteve përfaqësuesit e shoqërisë civile, si edhe aktorë të tjerë të interesuar mund të ndjekin më lehtë këtë proces dhe: a) të konkretizojë pyetje në lidhje me problemet e (mos)zbatimit të detyrimeve të ndërmarra lidhur me integritimet evropiane ose mënyrën e zbatimit të tyre; b) t'i formulojnë kriteret të qarta dhe objektive për ndjekjen e implementimit të „agjendës evropiane të shtetit kandidat/kandidatit potencial dhe t'i formulojnë rekomandimet për përparimin e procesit; c) ta njohin rolin e tyre dhe vendin në proces, ta japin kontributin e vet dhe t'i organizojnë veprimin e vet sipas kriterëve kyç në proces; d) ta informojnë publikun më të gjerë.

Tabela me shqyrtimin e dokumenteve më të rëndësishme të BE-së përfaqëson një instrument të dobishëm për shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë të interesuar që të ndjekin procesin e integritimeve evropiane, sepse çdo prej dokumenteve të përfaqësuara në tabelë ka kategori si vijon më poshtë:

- a) **përshkrimi i dokumentit** (çfarë përfaqëson dokumenti, pse ai është i rëndësishëm dhe si është krijuar);
- b) **përmbajtja e dokumentit** (çfarë rregullohet me dispozitat e dokumentit);
- c) **struktura e dokumentit** (si duket dokumenti dhe cilat janë elementet e tij përbërëse);
- d) **mbajtësit e dokumentit** (cili organ/cila organizatë e kanë miratuar dokumentin);
- e) **data e miratimit** (kur dokumenti është miratuar).

DOKUMENTET E BASHKIMIT EVROPIAN	
Emri i dokumentit	Strategjia e zgjerimit të BE-së / EU Enlargement Strategy
Përshkrimi i dokumentit	Çdo vit KE-ja miraton një numër të dokumenteve („paketën e zgjerimit“), përmes të cilave shpjegohet politika e zgjerimit të BE-së dhe raportohet për përparim të arritur në çdo shtet që përpiqet të anëtarësohet më BE-në. Strategjia e zgjerimit është një nga dokumenteve me të cilin përcaktohen orientimet për vitin e ardhshëm dhe identifikohet përparimi i realizuar gjatë 12 muajve të fundit në vitin e kaluar në çdo shtet kandidat dhe kandidat potencial. Pranë këtij dokumenti strategjik, paketa përmban edhe raportin për përparim, ku KE-ja prezanton vlerësimin e vet për atë çfarë ka arritur çdo shtet kandidat/kandidat potencial në vitin e kaluar në procesin e integritimeve evropiane. KE-ja çdo vit shpall strategjinë e zgjerimit në tremujorin e fundit në kuadër të dokumentit nga „paketa e zgjerimit“.
Përmbajtja e dokumentit	Strategjia e zgjerimit të BE-së jep shqyrtimin e gjendjes, citon elemente kyçe, sfida kyçe për vitin e ardhshëm, vendos strategjinë e orientimit në pikëpamje të politikës së zgjerimit, jep një vështrim shumë të shkurtër të përparimit që e kanë arritur shtetet candidate dhe kandidatet potenciale, citon në të cilën mënyrë BE-ja do të vazhdojë të ofrojë mbështetjen (teknike e financiare) dhe në fund miraton rekomandimet e përgjithshme d.m.th. orientimin kyç strategjik për mbajtjen e politikës së zgjerimit, dhe përfundimet për çdo shtet kandidat dhe kandidat potencial. Strategjinë e ndjek edhe shtojca në të cilën në mënyrë më të detajuar janë prezantuar shqyrtimet dhe mendimet e Komisionit Evropian për përparim në procesin e aderimit për të gjitha shtetet, me të dhënat kyçe strategjike.
Struktura e dokumentit	Strategjinë e përbejnë katër kapituj dhe aneksi: I Agjenda e zgjerimit – arritjet dhe sfidat; II Vlerësimi i fokusit mbi zgjidhjen e çështjeve themelore; III Bashkëpunimi rajonal; IV Përfundimet dhe rekomandimet; Aneksi: 1) Shqyrtimet e shkurtra të rezultateve nga raporti për shtete 2) Ndryshimet në raportet vjetore për shtete dhe 3) Të dhënat kyçe strategjike.
Mbajtësi i dokumentit	Komisioni Evropian

Emri i dokumentit	Raporti vjetor i Komisionit Evropian për përparim në procesin e integrimi evropiane /Annual Progress Reports of the European Commission
<p>Përshkrimi idokumentit</p>	<p>Raporti për përparim (ang. Progress Report) është dokument me të cilin KE-ja ofron informacione për përparimin të cilin ndonjë shtet kandidat ose kandidat potencial e ka arritur në plotësimin e kushteve dhe qëllimeve që i ka kërkuar BE-ja, si edhe përmbledhjen e masave operative të cilat duhet ndërmarrë në bazë të planeve të përcaktuara të veprimit. Raporti për përparim bazohet mbi të dhënat e dorëzuara të shtetit kandidat/kandidatit potencial, shteteve anëtare të BE-së, raportit të PE-së, dhe të dhënat të cilat i dorëzojnë organizatat ndërkombëtare dhe organizatat të shoqërisë civile. Komisioni Evropian ka krijuar një seri të ndryshimeve në Paketën e zgjerimit për vitin 2015 në krahasim me vitet e mëparshme. Qëllimi është që në mënyrë plotësuese të zmadhohet cilësia e vlerësimit në raporte, si edhe besueshmëria e paketës si burim i informacioneve për të gjitha anët e interesuara. Këto ndryshimet do të zmadhojnë transparencën e procesit dhe do t'u mundësojnë të gjitha anëve të interesuara, duke përfshirë shoqërinë civile, edhe rishikimin më të mirë dhe më të detajuar të reformave. Në pajtim me atë, raportet: 1) zgjerojnë fokusin mbi gjendje aktuale më qëllim që më qartë të tregojnë në cilin nivel gjenden shtetet në pikëpamje të përgatitjes së tyre për plotësimin e kriterëve për anëtarësim; 2) ofrojnë drejtimet më të gjera për atë mbi çfarë duhet të fokusohen shtetet në vitin e ardhshëm, dhe 3) duke përfshirë raportet e përshtatura dhe shkallët e vlerësimit, do t'u mundësoje shteteve që drejtpërdrejt të krahasohen në fusha kyçe. Ndryshimet në raportet vjetore marrin parasysh edhe nevojën për rendin e përshtatshëm të reformave: 1) sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore (gjyqësori, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër kriminalitetit të organizuar, liria e shprehjes); 2) zhvillimi ekonomik dhe 3) reforma e administratës publike – tre kapituj negociues (prokurimet, statistika, kontrollimi financiar).</p> <p>Një vlerësimi jepet për situatë aktuale, kurse i tjetri për përparim në çdo fushë të shqyrtuar. Këto vlerësime bazohen mbi analizën e kujdesshme të situatës, me theksim të veçantë mbi implementimin dhe regjistrimin e rezultateve konkrete në çdo fushë. Kështu implementimi dhe arritjet kanë peshën më të madhe nga përputhshmëria ligjore dhe kuadri institucional në vlerësimin e përgjithshëm. Dhe situata aktuale dhe niveli i përparimit vlerësohen në krahasim me shkallën standarde në 5 pika për vlerësim. Shkalla e cila përdoret për vlerësimin e situatës aktuale është si vijon:</p> <p>Në fazë shumë të hershme – Në fazë të hershme – Përgatitja mesatare – Niveli i dukshëm i përgatitjes – Niveli shumë i përparuar i përgatitjes</p> <p>Shkalla e cila përdoret për vlerësimin e përparimit në 12 muajt të kaluar është si vijon:</p> <p>Kthimi mbrapsht – Pa përparim – Përparimi i dukshëm – Përparimi i mirë – Përparimi shumë i mirë</p> <p>KE-ja çdo vit shpall raportin për përparimin në tremujorin e fundit dhe ia dorëzon Këshillit të BE-së dhe Parlamentit Evropian, shtetit kandidat, kandidatit potencial. Raporti përfshinë periudhën nga tetori i vitit të kaluar deri tek shtatori i muajit aktual të vitit aktual.</p>
<p>Përmbajtja edokumentit</p>	<p>Raporti për përparim në procesin e integrimi evropiane përshkruan shkurtë marrëdhëniet mes shtetit kandidat/kandidatit potencial dhe BE-së; analizon gjendjen e shtetit kandidat/kandidatit potencial në pikëpamje të kriterëve politike e ekonomike për anëtarësim, dhe ekzaminon kapacitetet e shtetit kandidat/kandidatit potencial që të ndërmarrë detyrimet që dalin nga anëtarësimi, d.m.th. trashëgiminë juridike e shprehur në Marrëveshjen, legjislacionin sekondar dhe politikat e BE-së përmes kapitujve negociuese.</p>

Struktura e dokumentit	Struktura e raportit për përparim, pranë hyrjes që jep kontekstin dhe shqyrtimin e shkurtër të raportit, përbëhet nga tri pjesë bazike dhe aneksi: 1) Kriteret politike (Demokraci; Reforma e administratës publike; Sundimi i ligjit; Të drejtat njerëzore dhe mbrojtja e pakicave; Pyetjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare); 2) Kriteret ekonomike (Ekzistimi i ekonomisë funksionale të tregut; Kapacitet për ballafaqim me presionet e konkurrencës dhe forcave të tregut të BE-së); 3) Aftësia e ndërmarrjes së detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi (33 kapituj negociues); Aneksi për shtetin kandidat/shtetin potencial (Marrëdhëniet mes BE-së dhe shtetit kandidat/shtetit potencial; Aneksi statistikor)
Mbajtësi i dokumentit	Komisioni Evropian
Emri i dokumentit	Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi Raportin për përparimin e shtetit kandidat / shtetit potencial për anëtarësim në procesin e integritimeve evropiane / European Parliament Resolution on Annual EC Progress reports
Përshkrimi i dokumentit	Rezoluta në Parlamentin Evropian, por edhe rezolutat për përparimin e shtetit kandidat/shtetit potencial në procesin e integritimeve evropiane janë të ashtq. akte jo ligjore. Rezoluta është një dokument i PE-së i cili tregon për dëshirën politike që se bashku të veprohet në një fushë. Rezoluta i mundëson Parlamentit që të propozoj drejtimet në mënyrë jo të detyrueshme, respektivisht pa asnjë detyrim ligjor për të adresuarin – çfarë në këtë rast janë organet e shtetit kandidat ose kandidatit potencial për anëtarësim në BE-në. Mbajtësi i punës lidhur me Rezolutë është Këshilli për punët e jashtme të PE-së. Në kuadrin e veprimit të vet, Këshilli, sipas Rregullores për punën e PE-së, është përgjegjës edhe për ndjekjen e përparimit të shtetit kandidat/shtetit potencial në integritimet evropiane. Në rast kur përpilohet akti jo ligjor duhet patjetër që cilido komitet, por edhe Komiteti për punët e jashtme të PE-së, ta emërojë një raportues. Raportuesi është mbikëqyrës për përgatitjen e rezolutës dhe paraqitjen e saj në PE-në në emër të Komitetit. Raporti vjetor i KE-së për përparim është bazë fillestare dhe sipas saj raportuesi e përpilon draftin e rezolutës për këtë dokument. Prandaj emri i dokumentit të raportuesit është „Rezoluta për Raport për përparimin e shtetit kandidat/shtetit potencial“. Periudha për miratimin e rezolutës është tremujori i parë varësisht nga plani i Këshillit për punët e jashtme të PE-së.
Përmbajtja e dokumentit	Rezoluta për Raport për përparimin e shtetit kandidat/shtetit potencial prezanton vlerësimin e përgjithshëm i gjendjes në shtetin kandidat /shtetin potencial. Pastaj i kushton vëmendje mbi kriteret politike dhe zbatimin e tyre në periudhën e raportimit. Gjithashtu, Rezoluta trajton çështje ekonomike dhe bashkëpunim rajonal.
Mbajtësi i dokumentit	Parlamenti Evropian
Emri i dokumentit	Mendimi i Komisionit Evropian mbi Kërkesën për anëtarësim në Bashkimin Evropian / Commission Opinion on application for membership of the European Union
Përshkrimi i dokumentit	Në bazë të përgjigjeve të marra mbi Pyetësor, Komisioni Evropian përpilon mendimin (fr. avis) për atë a shteti është i gatshëm për statusin e kandidatit për anëtarësim në BE-në, si edhe për atë a është i gatshëm për fazë të mëtejshme – përcaktimi i datës së afërt për negociata për aderim në BE-në, për çfarë vendosin shtetet anëtare të BE-së me konsensus. Mendimin e KE-së për kërkesën e shtetit kandidat për anëtarësim në BE-në e ndjekin edhe raportet analitike, përfundimet dhe rekomandimet. Komisioni Evropian ia dorëzon mendimin Këshillit, dhe në bazë të tij Këshilli miraton mendimin për kandidaturë (avis).

Përmbajtja e dokumentit	KE-ja në Mendimin e vet për kandidaturë prezanton vlerësimin e përparimit në plotësimin e kriterëve politike dhe ekonomike të cilat i ka përkufizuar Këshilli Evropian në Kopenhagë dhe kushtet e vlerësimit të procesit të stabilizimit dhe asociimit. Në fundin e Mendimit prezantohet përfundimi dhe jepet rekomandimi që shtetit kandidat potencial t'i ndahet ose jo statusi i kandidatit për anëtarësim në BE-në.
Struktura e dokumentit	Mendimi i KE-ës mbi kërkesën për anëtarësim në BE-në përbëhet nga tri pjesë: A) Hyrje (kërkesa për anëtarësim; marrëdhëniet mes BE-së dhe shtetit kandidat potencial për anëtarësim); B) Kriteret për anëtarësim (kriteret politike, kriteret ekonomike dhe mundësia e plotësimit të detyrimeve nga anëtarësimi); C) Përfundim dhe rekomandime.
Mbajtësi i dokumentit	E përgatisë Komisioni Evropian, e miraton Këshilli.

MARRËVESHJET E SHTETEVE TË BALLKANIT PËRNDIMOR ME BASHKIMIN EVROPIAN

Emri i dokumentit	Traktati themelues i Komunitetit energjetik / Treaty establishing the Energy Community
Përshkrimi i dokumentit	<p>Komuniteti energjetik është krijuar në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare mes Bashkësisë Evropiane dhe shteteve të Evropës Juglindore, të vendosur që të krijojnë tregun e përbashkët të gazit dhe energjisë elektrike, me mundësi që ky treg më vonë të përfshijë edhe prodhime të tjera energjetike. Komuniteti energjetik është themeluar mbi interesin e përbashkët dhe solidaritetin e anëtarëve të saj. Në komunitetin në vitin 2009 u aderuan Ukraina dhe Moldavia. Statusin e vëzhguesit e kanë Norvegjia, Turqia e Armenia. Gjeorgjia nga viti 2006 ka pasur status të vëzhguesit, kurse nga 20 shkurt të vitit 2014 Komisioni Evropian ka filluar negociatat zyrtare me Gjeorgji për anëtarësim në Komunitet energjetik.</p> <p>Kur bëhet fjalë për furnizimin e energjisë, rajoni i Ballkanit Perëndimor përfaqëson një treg të fragmentuar, kryesisht të varur nga karburantet fosile importuese. Pranë thëngjillit (kryesisht linjitet me vlerë të ulët të kalorisë), nuk ka rezerve të rëndësishme të karburanteve fosile në këtë rajon.¹ Duke marrë parasysh të kaluarën e rajonit nga koha e fundit, Bashkësia Energjetike është promovuar edhe si projekt paqësor. Bashkësia energjetike përfaqëson projektin e parë të përbashkët institucional të shteteve të Evropës Juglindore që nuk janë anëtarë të BE-së.² Misioni i Komunitetit Energjetik është që të zgjerojë tregun energjetik të BE-së kah Evropa Juglindore edhe më tutje, përmes pranimit të kuadrit të detyruar juridik mes nënshkruesve të Marrëveshjes për themelimin e Komunitetit Energjetik. Krijimi i Komunitetit Energjetik themelohet mbi vendimet e Samitit të Këshillit Evropian në Kopenhagë në vitin 2002, ku u është konfirmuar mbështetja shteteve të Ballkanit Perëndimor në rrugë kah anëtarësimi në BE-në. Integrimi i rajonit të Ballkanit Perëndimor në tregun energjetik të BE-së është konfirmuar në Selanik në vitin 2003, kur Këshilli Evropian ka miratuar Agjendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor.³ Qëllimet e Bashkësisë Energjetike janë theksuar në Preambulën e Marrëveshjes.⁴</p>

1 Energy Community, Energy Strategy of the Energy Community.

2 Macura, Aleksandar, Kryesimi i 11-të të Këshillit Ministror të Komunitetit Energjetik – Përmbledhja e vendimeve të rëndësishme, BOS; Beograd 2014, f. 3, <http://bit.ly/1LCxvho> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

3 Preambula e Marrëveshjes për themelimin e Komunitetit Energjetik <http://bit.ly/1oDrIDQ>, shih <http://bit.ly/1SNpZYM> (aksesuar herën e fundit më 16.11.2015.)

4 Qëllimet janë cituara në Preambulën e Marrëveshjes. Përkthimi i dispozitave të Marrëveshjes nuk e ndjek krejtësisht tekstin e Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes („G. zyrtare RS”, nr. 62 nga dt. 19.07.2006).

Përmbajtja e dokumentit

Marrëveshja për themelimin e Komunitetit energjetik përfaqëson një kuadër ligjor për vendosjen e tregut të përbashkët energjetik, që është themeluar mbi zgjerimin dhe zbatimin e trashëgimisë juridike të BE-së në fushën e energjetikës, politikës së konkurrencës dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor, si edhe mbi përparimin e infrastrukturës energjetike në pajtim me dispozitat e trashëgimisë juridike të përshtatshme të BE-së. Me aderim në Komunitet Energjetik, anët e kontraktuara janë detyruar që do të ndërmarrin dhe do të zbatojnë trashëgiminë juridike të BE-së që është subjekt i Marrëveshjes. Pranë ndërmarrjes së trashëgimisë juridike të BE-së, në pajtim me kuadrin qartë të përcaktuar kohor, Palët e Kontraktuara kanë shprehur përkushtimin në vendosjen e kurdit adekuat rregullator dhe të liberalizimit të tregjeve energjetike. Gjithashtu, Marrëveshja përfaqëson bazën për zhvillimin e investimeve, por edhe politikat përgjegjëse energjetike që nuk lënë pas dorë dimensionin social të reformës së sektorit energjetik. Me Marrëveshje është përcaktuar edhe procedura e vendimmarrjes, janë vendosur institucionet e Bashkësisë energjetike dhe janë përcaktuar procedurat për zgjidhjen e kontesteve. Këshilli Ministror është shkalla më e lartë të Bashkësisë për vendimmarrje dhe zbatimin e tyre. Vendimet e Këshillit Ministror ndryshojnë dhe plotësojnë Marrëveshjen për themelimin e Bashkësisë energjetike.

Është e rëndësishme që të vërehet vëmendja mbi natyrën ligjore të Marrëveshjen në kontekstin e procesit të aderimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Marrëveshja për themelimin e Komunitetit energjetik krijon të drejtat dhe detyrimet për palët e kontraktuara. Madje me Marrëveshje është parashikuar miratimi i trashëgimisë juridike të BE-së në fushën e energjetikës, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe konkurrencës, plotësimi i detyrimeve në kuadër të Komunitetit energjetik nuk mund të identifikohet me procesin dhe rezultatet e negociatave për aderim në BE-në. Prandaj, nuk është e mundshme detyrimet nga Marrëveshja për Komunitetin energjetik, që janë përcaktuar qartë edhe në kuptim kohor, të lidhen me detyrimet që duhet të vijnë. Nga ana tjetër, Marrëveshja për themelimin e Komunitetit energjetik qartë përcakton cilat pjesë nga trashëgimia juridike duhet të transferohen dhe zbatohen në sistemin ligjor kombëtar, ndërsa çështja e negociatave e shtetit kandidat me BE-në është miratimi dhe zbatimi i tërë trashëgimisë juridike të BE-së, në afatin i cili përcaktohet gjatë negociatave. Në fund, me Marrëveshje për themelimin e Bashkësisë energjetike janë parashikuar procedurat e vendimmarrjes dhe trupat që marrin vendimet. Fushëveprimi i punës dhe ndikimit të tyre nuk mund të zgjerohet as jashtë kuadrit të Komunitetit as të zvogëlohet në lidhje me detyrimet e kontraktuara. Kur bëhet fjalë për mekanizëm për funksionimin e tregut të energjisë së rrjetit (Kapitulli III, nenet 26 e 27), qartë është përcaktuar kuadri gjeografik i zbatimit të dispozitave të Marrëveshjes që nuk i takon të gjitha anëtarëve të BE-së, por i takon Austrisë, Greqisë, Hungarisë, Italisë, Sllovenisë, si edhe të gjitha anëtarëve të ardhshme të BE-së që njëkohësisht janë nënshkruar të Marrëveshjes për themelimin e Komunitetit energjetik. Komunitetit energjetik është integrim rajonal i cili është drejtuar kah tregu energjetik i Evropës Juglindore, çfarë duhet ketë parasysh gjatë analizës së procesit të negociatave të anëtarëve të ardhshme me Bashkimin Evropian dhe anëtarët e tjerë të Unionit.

Struktura e dokumentit	<p>Marrëveshja për themelimin e Komunitetit energjetik përbëhet nga preambula, kapitujt dhe aneksi:</p> <p>1) Preambula përmban bazat për themelimin e Komunitetit, përcaktimin e tij vlerësues dhe qëllimet.</p> <p>2) Kapitujt janë ndarë në nënkapituj me të cilat janë përcaktuar parimet mbi të cilat është vendosur Komuniteti dhe janë rregulluar fushat individuale nga rëndësia për Komunitet: Kapitulli II – trashëgimia juridike e BE-së të cilën palët e kontraktuara duhet t'i ndërmarrin dhe zbatojnë; përputhshmëria me standardet e BE-së të zbatueshme në përgjithësi, masat për përshtatshmërinë e trashëgimisë juridike të BE-së dhe përputhshmëria me trashëgiminë juridike të ardhshme të BE-së; Kapitulli III – mekanizmi për funksionimin e tregut të energjisë së rrjetit; d.m.th. për harmonizim e tregut, sigurinë e furnizimit, sigurinë dhe masat në rastin e krizës së furnizimit; Kapitulli IV – vendosja e tregut unik energjetik; kapitujt V e VI – fushëveprimi i institucioneve të Bashkësisë energjetike, buxheti dhe mënyra e vendim-marrjes dhe Kapitulli VII – zbatimi i vendimeve dhe zgjidhja e kontesteve brenda Bashkësisë energjetike.</p> <p>3) Anekset e përmbajnë shqyrtimin e trashëgimisë juridik të BE-së në fushën e energjisë, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe konkurrencës, kuadrin kohor për implementimin e tyre dhe strukturën e kontributit të palëve të Kontraktuara për buxhetin e Bashkësisë energjetike.</p>
Palët e kontraktura	<p>Komuniteti evropian (nga viti 2009 Bashkimi Evropian), Republika e Shqipërisë, Republika e Bullgarisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë, Republika e Malit të Zi, Rumania, Republika e Serbisë, Misioni i Përkohshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë së OKB-së, Moldavia dhe Ukraina.</p>
Data e miratimit	<p>Marrëveshja është nënshkruar në Athinë më 25 tetor të vitit 2005</p>
Emri i dokumentit	<p>Marrëveshja për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (Marrëveshja për qiellin e hapur) / The Agreement on Common Aviation Area of Europe (The Open Skies Agreement)</p>
Përshkrimi i dokumentit	<p>Bashkimi Evropian ka filluar projektin e Hapësirës së përbashkët evropiane të Aviacionit në vitin 2004 dhe thelbi i tij është që hapësira evropiane ajrore t'i fshijë kufijtë kombëtare, sepse ndarja e hapësirës ajrore ka pasur ndikim negativ mbi efektivitetin e trafikut ajror pasi që kompanitë ajrore shpenzojnë më shumë karburant dhe kohë duke kaluar një seri të madhe kontrollimesh.</p> <p>Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është formim i Hapësirës së përbashkët evropiane të Aviacionit (ang. European Common Aviation Area – ECAA). ECAA-ja themelohet mbi parimin e lirë të tregut, lirinë e themelimit të kompanisë, kushtet e njëjta të konkurrencës dhe rregullat të përbashkëta në fushën e sigurisë, menaxhimit të trafikut ajror, çështjeve sociale dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor.</p>
Përmbajtja e dokumentit	<p>Marrëveshja përbëhet nga nenet që shpjegojnë funksionimin e përgjithshëm të Hapësirës së përbashkët evropiane të Aviacionit dhe bëjnë „Marrëveshjen Kryesore“. Përmes anekseve plotësuese Marrëveshja përcakton cilat masa të përgjithshme ose vetjake, palët e kontraktuara duhet t'i ndërmarrin për ta siguruar plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, dhe cilat janë ato prej të cilave duhet të përmbahen me qëllim që të mos rrezikojnë realizimin e qëllimeve të kësaj marrëveshjeje.</p>

Struktura e dokumentit	Marrëveshja përbëhet nga nenet e „Marrëveshjes kryesore“ dhe 5 anekse: Marrëveshja kryesore Aneksi I – Rregullat që zbatohen për aviacionin civil Aneksi II – Pajtimi horizontal dhe përcaktimi i rregullave procedurale Aneksi III – Rregullat për konkurrencë dhe ndihmë shtetërore Aneksi IV – Kërkesat në Gjykatën e Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane Aneksi V – Protokollat që kanë të bëjnë me aranzhimet të transitit
Palët e kontraktuara	Komunitetet evropiane dhe shtetet anëtare e tyre, nga një anë, dhe Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Bullgarisë, Republika e Maqedonisë, Republika e Islandës, Republika e Malit të Zi, Mbretëria e Norvegjisë, Rumania, Republika e Serbisë dhe Misioni i administratës së përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë ⁵ , nga ana tjetër.
Data e miratimit	Marrëveshja multilaterale për Hapësirën e përbashkët evropiane të Aviacionit është miratuar më 9 qershor të vitit 2006.
Emri i dokumentit	Marrëveshja për tregtinë e lirë në Evropën Qendrore / The Central European Free Trade Agreement (CEFTA)
Përshkrimi i dokumentit	Shtetet Ballkanike, duke përfshirë edhe Moldavinë, në vitin 2006 kanë nënshkruar Marrëveshjen për tregtinë e lirë në Evropën Qendrore (CEFTA), e cila ka zëvendësuar rjetin e marrëveshjeve bilaterale për tregti të lirë. Pas hyrjes në BE-në, në vitin 2007, nga CEFTA kanë dalë Rumania dhe Bullgaria, kurse në vitin 2013 Kroacia. Shtetet që kanë mbetur në marrëveshje janë: Serbi, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoni, Mali i Zi, UNMIK – Kosovë dhe Moldavi. Ato në këtë moment përbëjnë tregun prej 25 milion përdorues. CEFTA përfaqëson marrëveshjen multilaterale për tregtinë e lirë në rajon. Me krijimin e zonës së lirë të tregtisë, shtetet e Ballkanit Perëndimor përcaktohen për zhvillim ekonomik, duke treguar që janë të aftë që të udhëheqin politikën e përbashkët ekonomike dhe të ndërmarrin detyrimet e përgjegjësisë për të ardhmen e të tërë rajonit, çfarë më shumë thekson perspektivën evropiane e këtij rajoni dhe dëshirën për aderim në BE-në. Gjithashtu, CEFTA siguron lehtësimin dhe harmonizimin e kushteve të tregtisë në rajon, që vlejnë për të gjithë nënshkruarit, kurse investuesve të mundshme të huaj u krijohet ambienti për punë relativisht i qëndrueshëm, i parashikueshëm dhe atraktiv.
Përmbajtja e dokumentit	Marrëveshja CEFTA përcakton detyrimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me tregtinë e të gjitha mallrave. Rregulla e përgjithshme e kësaj marrëveshjeje është heqja e kufizimeve kuantitative, doganave dhe shpenzimeve të tjera për eksport-importin e mallrave në treg mes shteteve në rajon. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, kufizimet sasiore, shpenzimet doganore dhe të tjera të natyrë fiskale për eksport-import nuk do të zmadhohen dhe to të zbatohet niveli i liberalizimit të të parashikuar me marrëveshjen bilaterale. Me marrëveshje janë hartuar kufizimet teknike në tregti, si edhe fushat e reja që nuk kanë qenë të përfshira me marrëveshjen bilaterale për tregtinë e lirë: tregtia me shërbime, investimet, prokurimet, mbrojtja e të drejtave të pronës intelektuale dhe arbitrazhi në rastin e kontesteve. Qëllimet kryesore e Marrëveshjes janë: ndryshimi dhe përparimi i marrëveshjeve ekzistuese bilaterale; përmirësimi dhe krijimi i kushteve për nxitimin e mëtejshëm të investimeve; zgjerimi i tregtisë me mallra dhe shërbime; përmirësimi i investimeve përmes rregullave të qarta, stabile dhe të parashikueshme; heqja e barrikadave dhe çrregullimeve në tregti, lehtësimi i lëvizjes së mallrave në transit dhe lëvizjes ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve mes nënshkruarëve; sigurimi i fer kushteve të konkurrencës dhe hapja graduale e tregut të prokurimeve; sigurimi i mbrojtjes së përshtatshme të të drejtave të pronësisë intelektuale në pajtim me standardet ndërkombëtare; sigurimi i procedurës efektive për zbatimin e Marrëveshjes; përmirësimi i marrëdhënieve tregtare me shtetet e treta.

5 Në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë së OKB-së 1244 nga dt. 10 qershor të vitit 1999.

Struktura e dokumentit	CEFTA, me dispozitat themelore të marrëveshjes, ka 9 anekse, që përfaqësojnë Marrëveshjen për tregtinë e lirë në Ballkan. Mes të tyre janë dispozitat e përgjithshme që kanë të bëjnë me tregtinë e të gjitha mallrave (rregullat operative, rregullat e konkurrencës dhe rregullat e mbrojtjes – Aneksi IV e V), prodhimet industriale (Aneksi I e II), prodhimet bujqësore (Aneksi I e III), barrierat teknike në tregti; çështjet e reja tregtare (shërbime, investime, prokurime, pronësi intelektuale – Aneksi VI e VII) dhe rregullat e funksionimit (Aneksi XVIII e IX).
Palët e kontraktuara	Komunitetet Evropiane dhe shtetet anëtare të tyre, nga një anë, dhe Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Republika e Maqedonisë, Moldavia, Republika e Malit të Zi, Rumania, Republika e Serbisë dhe Misioni e administratës së përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të Kosovës ⁶ , nga ana tjetër.
Data e miratimit	Marrëveshjen CEFTA 2006 në Bukuresht në vitin 2006 e kanë nënshkruar: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Moldavia, Rumania, Mali i Zi, Serbia, Administrata e përkohshme të misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në pajtim me Rezolutën e OKB-së së Këshillit të Sigurisë. Deri në fundin e vitit 2007 Marrëveshja ka hyrë në fuqi në të gjitha shtetet nënshkrues.

6 Në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë së OKB-së 1244 nga dt. 10 qershor të vitit 1999.

LITERATURA:

Studimet, analizat, artikujt:

EUROPEAN COMMISSION, PRESS RELEASE 10229/03, EU-Western Balkans Summit, Thessaloniki, 21 June 2003, Declaration,
http://europa.eu/rapid/press-release_PRES-03-163_en.htm

EUROPEAN COUNCIL , CONCLUSIONS OF THE PRESIDENCY , Santa Maria Da Feira, 19– 20 June 2000, http://www.europarl.europa.eu/summits/fei1_en.htm

EUROPEAN COUNCIL CONCLUSIONS, Brussels, 27/28 June 2013,
http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/en/ec/137634.pdf

Jovanović, Biljana, Analiza nacionalnih struktura za pregovaranje sa Evropskom unijom, Centar za demokratsku tranziciju, Podgorica, 2011.

Pregovori o pristupanju Republike Hrvatske Europskoj uniji, Tko, što, kako, zašto, Ministarstvo vanjskih poslova i europskih integracija, Zagreb 2006,
http://www.mvep.hr/files/file/publikacije/MEI_hr_web_pass.pdf

Proces pristupanja Republike Srbije EU: Strukture i procedure za uspješne pregovore o pristupanju EU, GIZ GmbH, Beograd, 2013.

Sebastian, Sofia, "The Stabilisation and Association Process: are EU inducements failing in the Western Balkans?", 53 Working Paper, FRIDE, 2008.

Hins, Wouter; Voorhoof, Dirk, "Access to State-Held Information as a Fundamental Right under the European Convention on Human Rights", *European Constitutional Law Review*, 3, 2007.

COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION, PRESS RELEASE 5486/14, First Accession Conference with Serbia, Brussels, 21 January 2014,
<http://www.consilium.europa.eu/press>

COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION, PRESS RELEASE, GENERAL AFFAIRS Council meeting, Brussels, 17 December 2013,
<http://www.consilium.europa.eu/Newsroom>.

CONFERENCE ON ACCESSION TO THE EUROPEAN UNION – MONTENEGRO, EUROPEAN UNION COMMON POSITION, Chapter 23 and 24:, Brussels, 12 December 2013, <http://register.consilium.europa.eu/doc/srv>.

COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION, PRESS RELEASE 11443/13, 3251st Council meeting, General Affairs, Brussels, 25 June 2013,
<http://www.consilium.europa.eu/Newsroom>.

COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION, PRESS RELEASE 8419/13, First meeting of the Accession Conference with Montenegro at Deputy Level, Brussels, 15 April 2013, <http://www.consilium.europa.eu/Newsroom>

COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION, PRESS RELEASE 17885/12, Second meeting of the Accession Conference with Montenegro at Ministerial level - Start of substantial negotiations, Brussels, 18 December 2012,
<http://www.consilium.europa.eu/Newsroom>

COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION, PRESS RELEASE 12033/12, First Accession Conference with Montenegro, Brussels, 29 June 2012,
<http://www.consilium.europa.eu/Newsroom>

COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION, PRESS RELEASE 10369/03, GENERAL AFFAIRS AND EXTERNAL RELATIONS, 2518th Council meeting, Luxembourg, 16th June 2003,
http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/gena/76201.pdf

COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION, PRESS RELEASE 9008/99, GENERAL AFFAIRS, 2192nd Council meeting, Luxembourg, 21–22 June 1999,
http://www.consilium.europa.eu/en/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/gena/09008.en9.htm#_Toc454630682.

COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION, PRESS RELEASE 7738/97, GENERAL AFFAIRS, 2003rd Council meeting, Luxembourg, 29–30 April 1997,
http://europa.eu/rapid/press-release_PRES-97-129_en.htm?locale=en

Dokumentet:

Plani i veprimt të Malit të Zi për Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat theme-lore), Qeveria e Malit të Zi, 27 qershor të vitit 2013, <http://www.eu.me/mn/23/23-dokumenti> (6. 5. 2015).

GENERAL EU POSITION, Ministerial meeting opening the Intergovernmental Conference on the Accession of Serbia to the European Union, Brussels, 21 January 2014,
<http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?!=EN&t=PDF&gc=true&sc=false&f=AD%201%202014%20INIT>

GENERAL EU POSITION, Ministerial meeting opening the Intergovernmental Conference on the Accession of Montenegro to the European Union, Brussels, 29 June 2012,
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/st20002_05_mn_framedoc_en.pdf

EUROPEAN COMMISSION, COMMUNICATION FROM THE COMMISSION TO THE COUNCIL on Operational Conclusions EU Stabilisation and Association process for countries of South-Eastern Europe Bosnia and Herzegovina, Croatia, Federal Republic of Yugoslavia, former Yugoslav Republic of Macedonia and Albania, 2 March 2000, COM (2000) 49/2

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52000DC0049&from=EN>

EUROPEAN COMMISSION, COMMUNICATION FROM THE COMMISSION - The Western Balkans on the road to the EU: consolidating stability and raising prosperity, Brussels, 27.1.2006, COM(2006) 27 final,

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2006:0027:FIN:EN:PDF>.

Ligji për fshehtësinë e të dhënave të Republikës së Serbisë („G. Zyrtare RS”, Nr. 104/2009)

Raporti për shqyrtimin analitik të përputhshmërisë së legjislacionit për Malin e Zi për Kapitullin 23, <http://www.eu.me/mn/23/23-dokumenti> (6. 5. 2015).

[Odluka o osnivanju Koordinacionog tela za proces pristupanja Republike Srbije Evropskoj uniji](#) („Gazeta zyrtare RS”, nr. 84/2013, 86/2013, 31/2014 e 79/2014).

Vendimi i Këshilli për integrimet evropiane të Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë për procedurën e shqyrtimit të propozimit të pozitës negociuese në procesin e negociatave për aderimin e Republikës së Serbisë në Bashkim Evropian (Vendimi nr. 02-1864/14 nga 4. qershor të vitit 2014.)

Vendimi për arsimin e ekipit negociues për udhëheqjen e negociatave për aderimin e Republikës së Serbisë në Bashkimin Evropian („Gazeta zyrtare RS” nr. 78/2013 nga 3 shtator të vitit 2013; Vendimi ka hyrë në fuqi me 3 shtator të vitit 2013).

Baza për udhëheqjen e negociatave dhe lidhja e marrëveshjes për aderimin e Republikës së Serbisë në Bashkim Evropian, me propozimin e përfundimit, Qeveria e Republikës së Serbisë, Beograd, shtator të vitit 2013.

Opinion of the European Economic and Social Committee on Enhancing the transparency and inclusiveness of the EU accession process REX/401, 2014 <http://www.eesc.europa.eu/?i=portal.en.rex-opinions.30766>

Pozita negociuese e Malit të Zi për konferencën ndërqeveritare për aderimin e Malit të Zi në Bashkimin Evropian për Kapitullin 23 – Gjqësori dhe të drejtat themelore, tetori 2013; Pozita negociuese është në dispozicion në faqen e internetit: <http://www.eu.me/mn/23/23-dokumenti> (6. 5. 2015).

Rekomandimi R (81) 19 të Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare për qasjen në informacione në posedimin e autoritetit publik
 Rekomandimi nr. R (2002) 2 të Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare për qasje në dokumentet zyrtare

REGULATION (EC) NO 45/2001 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 18 December 2000 on the protection of individuals with regard to the processing of personal data by the Community institutions and bodies and on the free movement of such data,
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2001:008:0001:0022:en:PDF>

REGULATION (EC) No 1049/2001 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 30 May 2001 regarding public access to European Parliament, Council and Commission documents,
http://www.europarl.europa.eu/RegData/PDF/r1049_en.pdf.

Rezoluta për rolin e Kuvendit Popullor dhe parime në negociata për aderimin e Republikës së Serbisë në Bashkim Evropian („Gazeta zyrtare RS”, nr. 112/2013 nga 17 dhjetor të vitit 2013).

Vendimi për emërtimin e shefit të Ekipit negociues për udhëheqjen e negociatave për aderimin e Republikës së Serbisë në Bashkim Evropian,
<http://www.slglasnik.info/sr/78-03-09-2013/15824-reenje-o-imenovnju-ef-pre-govrkog-tim-z-voenje-pregovor-o-pristupnju-republike-srbije-evropskoj-uniji.html>.

Këshilli Evropian, Konventa për të drejtat njerëzore,
http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SRP.pdf

COMMISSION OF THE EUROPEAN COMMUNITIES, GREEN PAPER Public Access to Documents held by institutions of the European Community, A review, COM(2007) 185 final, Brussels, 2007.

Council of Europe, *Access to Official Documents. Recommendation Rec (2002) 2 adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on February 2002 and explanatory memorandum*,
[http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/H-Inf\(2003\)003_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/H-Inf(2003)003_en.pdf)

Council of Europe Convention on Access to Official Documents (CETS No: 205),
<http://conventions.coe.int/Treaty/Commun/QueVoulezVous.asp?NT=205&CL=ENG>

Council of the European Union, The General Negotiating Framework, 12338/97/ELARG 24, Brussels, 1997,
http://www.europarl.europa.eu/enlargement/cu/agreements/pdf/101297c_en.pdf

Ueb faqe:**Serbia**

Fillo të flasësh për negociata:

eupregovori.bos.rs.

Zyra për Integrimet Evropiane të Republikës së Serbisë:

www.seio.gov.rs.

Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Serbisë, Sektori për Bashkimin Evropian:

www.mfa.gov.rs.

Mali i Zi

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integrimi Evropiane të Qeverisë së Republikës së Malit të Zi:

www.mvpei.gov.me.

Unë për Evropë, Evropa për mua:

www.eu.me.

Kroacia

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Qeverisë së Republikës së Kroacisë:

www.mvep.hr.

Bashkimi Evropian

Drejtoria e Përgjithshme e Bashkimit Evropian për Politikën e Fqinjësisë dhe Negociata për Zgjerim:

<http://ec.europa.eu/enlargement>

Këshilli i Bashkimit Evropian:

<http://www.consilium.europa.eu>

Regjistri i dokumenteve të Këshillit të Bashkimit Evropian:

<http://www.consilium.europa.eu/register/en/content/int/?typ=ADV>

Parlamenti Evropian:

<http://www.europarl.europa.eu/portal/en/>

Regjistri i dokumenteve të Parlamentit Evropian:

<http://www.europarl.europa.eu/registre/recherche/RechercheSimplifiee.cfm?langue=EN>

Observator legjislativ:

<http://www.europarl.europa.eu/oeil/>

Komisioni Evropian:

http://ec.europa.eu/index_en.htm

Regjistri i dokumenteve të Komisionit Evropian:

<http://ec.europa.eu/transparency/regdoc/registre.cfm?CL=en&testjs=1>

Regjistri i komitologjisë:

<http://ec.europa.eu/transparency/regcomitology/registre.cfm?CL=en>

Arkivi elektronik i legjislacionit të BE – EUR-LEX:

<http://eur-lex.europa.eu/homepage.html>

Legjislacioni i BE-së në përgatitje:

<http://ec.europa.eu/prelex/apcnet.cfm?CL=enEP>

Këshilli Evropian:

<http://www.consilium.europa.eu/en/european-council/>



Shkolla e Hapur e Beogradit

rr. Masarikova 5/16
11000 Beograd
Serbia

Tel: +381 11 30 65 800

+381 11 30 61 372

Fax: +381 11 36 13 112

Ueb: www.bos.rs

facebook.com/bos.cei | twitter.com/CEI_BOS